

**NDIKIMI I FAMILJES DHE FAKTORËVE FAMILJARË NË
SHFAQJEN E SJELLJEVE TË DHUNSHME TEK
ADOLOSHENTËT NË SHKOLLË**

(STUDIM KRAHASUES RURAL-URBAN)

Samire Bllaca-Balaj

**Dorëzuar
Universitetit Evropian të Tiranës
Shkollës Doktorale**

**Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
(Shkenca Sociale), me profil (Psikologji-Pedagogji), për marrjen e
gradës shkencore “Doktor”**

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Erleta Mato

Numri i fjalëve: 50,589

Tiranë 2018

DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklaroj se punimi është shkruar në mënyrë të pavarur dhe është tërësisht punim origjinal. Unë deklaroj me përgjegjësi të plotë se të gjitha informacionet në këtë punim janë marrë dhe paraqitur gjithnjë duke iu referuar rregullave akademike. Rezultatet e punimit mbështeten në të dhëna të sakta nga terreni. Ky punim nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe referuara.

ABSTRAKTI

Dhuna dhe sjelljet e dhunshme janë një dukuri, e cila sa vjen e shtohet edhe më shumë në shkollat e Kosovës. Shoqëria kosovare e sheh si preokupim dhunën në shkollë, ndaj janë bërë shumë hulumtime për dhunën dhe shkaktarët e dhunës tek nxënësit në shkollë.

Të gjeturat e hulumtimeve të mëhershme tregojnë për situatën e brishtë të sigurisë në shkollat e Prishtinës. Për më tepër, raporti i planit të veprimit (2014) për hartimin e “Platformës për Siguri në Shkolla 2015-2018”, ofron të dhëna të detajuara për situatën e sigurisë në shkollat Prishtinës, të cilat janë të vlefshme për hartimin e platformës për sigurinë në shkollat e kryeqytetit të vendit.

Qëllimi i hulumtimit është vlerësimi i perceptimit të respondentëve për ndikimin e faktorëve familjarë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme të nxënësve në shkollë si dhe hulumtimi i faktorëve të tillë, si: mosha, gjinia, punësimi i prindërve, vendbanimi, që janë të rëndësishëm për këtë hulumtim.

Numri i pjesëmarrësve në hulumtim është 497 nxënës, nga të cilët 245 ose 49.3% ishin të gjinisë femërore dhe 252 ose 50.7% prej tyre i takonin gjinisë mashkullore; kurse nga 112 mësimdhënës, 73 ose 65.2% ishin të gjinisë femërore dhe 39 ose 34.8% prej tyre i takonin gjinisë mashkullore.

Nga numri i përgjithshëm i prindërve, janë përzgjedhur për të qenë pjesë e këtij hulumtimi 365 prej tyre. Mbështetur në “The Research Advisors” (2006), mostra jonë e prindërve ka një interval të besimit 95%, me kufij të gabimit 0.05%. Nga 365 prindërit e përzgjedhur të kampionimit, 158 ose 43.3% ishin të gjinisë femërore dhe 207 ose 56.7 % prej tyre i takonin gjinisë mashkullore.

Në hulumtim janë përdorur tre pyetësorë, në pjesën e parë janë paraqitur të dhënat demografike, kurse në dy pjesët e tjera të pyetësorit është kërkuar që nxënësit, prindërit si dhe mësimdhënësit

të përgjigjen në pohimet e ofruara në shkallën Likert por edhe të përcaktojnë pohimin që prezanton qëndrimin e tyre.

Seksioni i dytë i pyetësit është shfrytëzuar dhe përfshin: Opinionin mbi shkaktarët e dhunës, e autores Mimoza Shahini (2013).

Konsistenca e brendshme me vlerat e fituara Cronbach alfa (α) ishte për pyetjet e pyetësit për nxënës (.897), mësimdhënës (.681) dhe prindër (.865) tregojnë që pyetësit mund të konsiderohen mjaft të besueshëm në vlerësimin e dhunës dhe ndikimet tek nxënësit në shkollë.

U hipotetizua se faktorët familjarë ndikojnë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek nxënësit adoleshentë në shkollë dhe mund të ketë dallime në sjellje ndërmjet nxënësve në zonat rurale dhe urbane, dallimet ndërmjet respondentëve rreth faktorëve familjarë si dhe dallimet gjinore në mes tyre.

Variabilet që u paraqitën në pyetësor ishin të shumta, disa prej tyre ishin variabla që matin perceptimin e faktorëve familjarë që tregojnë ndikimin në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme.

Nga opinionet e pjesëmarrësve dolën gjetjet se faktorët familjarë ndikojnë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme të nxënësve adoleshentë në shkollë. Krahas tyre treguan, gjithashtu, se nuk dolën dallime të vlefshme statistikore për krahasimin e sjelljeve të dhunshme të nxënësve në zonat rurale dhe urbane.

Po ashtu dallimet gjinore në mes të nxënësve u vërtetuan përmes opinionit të prindërve të tyre dhe qasjes së tyre në edukimin e fëmijëve se si ndiheshin gjinia femërore dhe mashkullore ndaj dhunës dhe atmosferës në familje. **Fjalë kyçe:** Dhunë, sjellje e dhunshme, faktorë, familje, nxënës, shkollë, adoleshencë, ndikim.

ABSTRACT

Violence and violent behaviour is a phenomenon, which is permanently increasing throughout the schools all over Kosovo. Kosovar society recognizes violence in schools as a concern because there were lots of studies conducted about this type of violence and its causes within the schools and their students.

Earlier research findings reveal the fragile situation of security and safety in Prishtina schools. Moreover, Action Plan report (2014) for drafting the "Safety Platform in Schools 2015-2018", provides thorough data about the safety situation in Prishtina schools, and these results are valuable for drafting the platform on safety in the schools of our capital city.

The purpose of this research is to explore the family factors which might increase the violent behaviour among adolescent students and the comparison of students' behaviour in rural-urban areas.

The number of participants in this research is 497 students, 245 or 49.3% were females and 252 or 50.7% of them were males; whereas out of 112 teachers, 73 or 65.2% were females, and 39 or 34.8% of them were males.

Out of the general number of parents, 365 of them were selected to be a part of this research. Based on "The Research Advisors" (2006), our sample of parents has an interval of trust 95% with error limits 0.05%. From 365 selected parents for sampling purposes, 158 or 43.3% were females and 207 or 56.7 % of them were males.

In the research there were three questionnaires used; in the first part there were demographic data introduced, whereas in two other parts of the questionnaire the students and the teachers were asked to answer in the provided statements in Likert scale but also to determine the statement

that introduces their attitude. The second section of the questionnaire has been used and it includes: The opinion on the causes of violence, of the author Mimoza Shahini (2013).

The Internal Consistence with the obtained values Cronbach alfa (α) was for the questions of the questionnaire for students (.897), teachers (.681) and parents (.865) and they reveal that the questionnaires may be considered quite reliable in the assessment of the violence and its impact on school students.

It was hypothesized that the family and family factors have an impact on the display of acts of violence among adolescent students in schools and there might be differences in behaviours among students in rural and urban areas, differences in their age as well as gender differences between them.

There were lots of variables that occurred in the questionnaire but through the factor analysis the family factors came into surface which clearly show the impact on the display of violent acts.

The results that derived from the participants' opinions prove that the family and family factors impact on the display of violent acts among adolescent students in schools, along the second hypothesis which did not reveal any significant statistical differences for the comparison of students' behaviour in rural and urban areas.

The gender differences among students was proven via the opinions of their parents and their approach towards the children education on how the females and males felt towards the violence and the atmosphere within the family.

Key words: Violence, violent behavior, factor, family, students, school, adolescence, impact.

DEDIKIMI

Këtë punim ia dedikoj bashkëshortit tim Hasan dhe fëmijëve të mi Dorëartës,

Dalmatit dhe Janinës

të cilët janë ulerat e jetës sime!!!

FALENDERIME

Me shumë kënaqësi shpreh falënderimet e mia të sinqerta për të gjithë ata që më ndihmuan dhe më mbështetën gjatë realizimit të kësaj teme disertacioni.

Së pari do të falënderoj Udhëheqësen Shkencore të kësaj teze, prof. dr. Erleta Mato, e cila me kontributin e saj shkencor, më ka përkrahur, pranuar, më ka këshilluar, ndihmuar gjatë gjithë periudhës së punës për realizimin e këtij punimi.

Dua të falënderoj nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit e shkollave të Prishtinës, të cilët morën pjesë në këtë studim pa përtesë në plotësimin e pyetësorëve.

Në mënyrë të veçantë falënderoj shoqen time znj. Merita Shala, e cila më ndihmoi me këshillat e saj, si dhe ndihmën në analizimin e të dhënave përmes pakos SPSS.

Falënderoj mundin dhe dëshirën e madhe të prindërve dhe vjehrrit tim, të cilët shkuan me dëshirën e madhe që unë të arrij këtu tek ky falënderim në mbrojtjen e gradës “Doktor”.

Falënderime të përzemërta meriton tezja ime Fatime Duriqi, e cila pas humbjes së prindërve të mi mbushi hendekun e zbrazët duke mu bërë nënë për përkujdesjen ndaj fëmijëve të mi, ditën dhe natën.

Fjalët më të bukura për falënderime ia destinoj krahut tim të djathtë, bashkëshortit Hasanit, që më mbështeti në çdo sekondë të jetës në të gjitha mënyrat, si dhe fëmijëve të mi Dorëartës, Dalmatit dhe Janinës.

Mungesa e prezencës dhe vëmendjes time kanë qenë të shpeshta, por asnjëherë nuk u ndanë nga zemra dhe mendja ime vetëm e vetëm që këtë tezë për të cilën punova kaq shumë, ta finalizojmë për së mbari.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI I

1.Hyrje.....	19
1.1. Vështrim i përgjithshëm i problemit të studimit.....	19
1.2. Prezantimi i problemi.....	25
1.3. Fokusimi i hulumtimi.....	26
1.4. Qëllimi i hulumtimit dhe hipotezat	27
1.5 Rëndësia e hulumtimit	30
1.6. Kufizimet e hulumtimit	31
1.7. Përcaktimi i termave	32
1.8. Struktura e punimit.....	35

KAPITULLI II

2.0. Adoleshenca.....	38
2.1. Teoritë për dhunën	39
2.2.Rishikimi i literaturës.....	46
2.3.Faktorët e lidhur me dhunën.....	62
2.4. Dhuna në familje.....	64
2.5. Familja dhe tipologjitë e familjeve në edukimin e fëmijëve për sjellje sociale.....	64

2.6. Prindërimi dhe llojet e prindërimit në edukimin e fëmijëve për sjellje sociale.....	66
2.7. Disiplinimi i fëmijëve.....	68
2.8. Dhuna ndaj fëmijëve në familje.....	71
2.9. Dhuna ndaj adoleshentëve në familje.....	74
2.10. Marrëdhëniet në familje shans për rritjen e sjelljeve të dhunshme në shkollë.....	76
2.11. Modelet e përshkallëzimit të dhunës në familje.....	77
2.12. Faktorët e rrezikut që mund t'i kontribuojnë dhunës në familje.....	77
2.12. Faktorët që ndikojnë në rritjen e dhunës në shkollë.....	78

KAPITULLI III

3. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

3.1. Metodologjia e hulumtimit.....	80
3.2. Dizajni i hulumtimit.....	80
3.3. Popullata dhe mostrat e hulumtimit.....	81
3.4. Instrumentet e përdorura në hulumtim.....	92
3.5. Procesi i analizës së të dhënave.....	98
3.6. Aspekti etik.....	99

KAPITULLI IV

ANALIZA EMPIRIKE 1

PREZANTIMI I ANALIZAVE TE PYETESORIT PER NXENES

ANALIZIMI I TË DHËNAVE-REZULTATET E HULUMTIMIT.....100

4.1. Chronbah alfa për të vërtetuar besueshmërinë e tre pyetësorëve të përdorur në hulumtim

4.2. Analiza faktoriale eksploruese për të tre pyetësorët

4.3. Vlerat bazë përshkruese për faktorët e dalë nga analiza faktoriale (MA, DS)...

4.4. Mann – Witney U, për dallimet ndërmjet dy grupeve

4.5. Kruskall- Wallis H, për të vërtetuar dallimet ndërmjet më shumë se dy grupeve

4.6. Krostabulime për të vërtetuar korrelacionin ndërmjet faktorëve nga tre grupet e pjesëmarrësve në hulumtim.

KAPITULLI V: ANALIZA 2

PREZANTIMI I ANALIZAVE TE PYETËSORIT PËR PRINDËRIT.....126

KAPITULLI VI: ANALIZA 3

PREZANTIMI I ANALIZAVE TË PYETËSORIT PËR MËSIMDHËNËSIT.....145

KAPITULLI VII

DISKUTIMI.....149

7.1. Opinioni i nxënësve mbi ndikimin e familjes dhe faktorëve familjarë në shfaqjen e sjellje të dhunshme të nxënësve në shkollë.....149

7.2. Opinioni i mësimdhënësve mbi ndikimin e familjes dhe faktorëve familjarë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme të nxënësve në shkollë.....160

7.3. Opinioni i prindërve mbi ndikimin e familjes dhe faktorëve familjarë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme të nxënësve në shkollë.....162

KAPITULLI VIII

PËRMBLEDHJE DHE REKOMANDIME.....167

BIOGRAFI.....171

SHTOJCAT-A

Pyetësorët për prindër.....181

Pyetësorët për mësimdhënës.....185

Pyetësorët për nxënës.....190

SHTOJCAT –B

Tabelat e analizimit të pyetësorëve për nxënës, prindër dhe mësimdhënës.....194

Punimet e botuara me pjesë të të dhënave nga punimi i doktoratës.....203

Leja për zhvillimin e hulumtimit nga MASHT

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: *Të dhënat sipas gjinisë, moshës dhe vendbanimit për nxënësit*

Tabela 2: *Të dhënat për familjet e nxënësve*

Tabela 3: *Niveli i arsimimit të prindërve sipas nxënësve*

Tabela 4: *Të dhënat për numrin e nxënësve në klasë dhe numrin e nxënësve të shkëlqyer dhe të dobët*

Tabela 5: *Të dhënat për kohën e kaluar në familje, me shoqëri, duke parë TV dhe në internet*

Tabela 6: *Të dhënat sipas gjinisë, moshës dhe vendbanimit për mësimdhënësit*

Tabela 7: *Të dhënat sipas gjinisë, moshës, dhe vendbanimit për prindërit*

Tabela 8: *Të dhënat për familjet e prindërve pjesëmarrës në hulumtim*

Tabela 9: *Niveli i arsimimit të prindërve*

Tabela 10: *Të dhënat për kohën e kaluar të fëmijëve të tyre në familje, me shoqëri, duke parë TV dhe në internet sipas mendimit të prindërve*

Tabela 11: *Konsistenca e brendshme (Cronbach α) e raportuar nga nxënësit*

Tabela 12: *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas gjinisë – Pyetësi për nxënës*

Tabela 13: *Dallimet e faktorëve tek nxënësit sipas gjinisë*

Tabela 14: *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas vendbanimit– Pyetësi për nxënës*

Tabela 15: *Dallimet e faktorëve tek nxënësit që jetojnë në fshat dhe qytet*

Tabela 16: *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas moshës - Pyetësi për nxënës*

Tabela 17: *Dallimet sipas moshës së nxënësve*

Tabela 18: *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas numrit të anëtarëve të familjes - Pyetësi për nxënës*

Tabela 19: *Dallimet sipas numrit të anëtarëve të familjes*

Tabela 20: *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas llojit të familjes - Pyetësi për nxënës*

Tabela 21: *Dallimet sipas llojit të familjes*

Tabela 22: *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas punësimit të nënës - Pyetësi për nxënës*

Tabela 23: *Dallimet sipas punësimit të nënës*

Tabela 24: *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas punësimit të babait - Pyetësi për nxënës*

Tabela 25: *Dallimet sipas punësimit të babait*

Tabela 26: *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas nivelit të arsimimit të nënës - Pyetësi për nxënës*

Tabela 27: *Dallimet sipas nivelit të arsimimit të nënës*

Tabela 28: *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas nivelit të arsimimit të babait - Pyetësi për nxënës*

Tabela 29: *Dallimet sipas nivelit të arsimimit të babait*

Tabela 30: *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas kohës që kalojnë në internet - Pyetësi për nxënës*

Tabela 31: *Dallimet sipas kohës që kalojnë në internet*

Tabela 32: *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas kohës që kalojnë duke parë televizor - Pyetësi për nxënës*

Tabela 33: *Dallimet sipas kohës që kalojnë duke parë televizor*

Tabela 34: *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas kohës që kalojnë me shokë/shoqe jashtë mësimi - Pyetësi për nxënës*

Tabela 35: *Dallimet sipas kohës që kalojnë me shokë/shoqe jashtë mësimi*

Tabela 36: *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas kohës që kalojnë me familjen në ditë - Pyetësi për nxënës*

Tabela 37: *Dallimet sipas kohës që kalojnë me familjen në ditë*

Tabela 38: *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas gjinisë- Pyetësi për prindër*

Tabela 39: *Dallimet e faktorëve tek prindërit sipas gjinisë*

Tabela 40: *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas moshës- Pyetësi për prindër*

Tabela 41: *Dallimet sipas moshës së prindërve*

Tabela 42: *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas vendbanimit– Pyetësi për prindër*

Tabela 43: *Dallimet e faktorëve tek prindërit që jetojnë në fshat dhe qytet*

Tabela 44: *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas numrit të anëtarëve të familjes - Pyetësi për prindër*

Tabela 45: *Dallimet sipas prindërve për numrin e anëtarëve të familjes*

Tabela 46: *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas llojit të familjes - Pyetësi për prindër*

Tabela 47: *Dallimet e faktorëve tek familjet që jetojnë së bashku dhe të ndarë, sipas prindërve*

Tabela 48: *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas punësimit - Pyetësi për prindër*

Tabela 49: *Dallimet e faktorëve tek prindërit sipas punësimit*

Tabela 50: *Dallimet sipas nivelit të arsimimit të nënës*

Tabela 51: *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas nivelit të arsimimit të babait - Pyetësi për prindër*

Tabela 52: *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas kohës që nxënësit kalojnë në internet - Pyetësi për prindër*

Tabela 53: *Dallimet sipas kohës që kalojnë në internet, sipas prindërve*

Tabela 54: *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas kohës që nxënësit kalojnë duke parë televizor - Pyetësi për prindër*

Tabela 55: *Dallimet sipas kohës që kalojnë duke parë televizor, sipas prindërve*

Tabela 56: *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas kohës që nxënësit kalojnë me shokë dhe shoqe jashtë mësimi - Pyetësi për prindër*

Tabela 57: *Dallimet sipas kohës që kalojnë me shokë/ shoqe jashtë mësimi, sipas prindërve*

Tabela 58: *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas kohës që nxënësit kalojnë me familjen në ditë - Pyetësi për prindër*

Tabela 59: *Dallimet sipas kohës që kalojnë nxënësit me familjen në ditë, sipas prindërve*

Tabela 60: *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas gjinisë– Pyetësi për mësimdhënës*

Tabela 61: *Dallimet e faktorëve tek mësimdhënësit sipas gjinisë*

Tabela 62: *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas vendit – Pyetësi për mësimdhënës*

Tabela 63: *Dallimet e faktorëve tek mësimdhënësit që jetojnë në fshat dhe qytet*

Tabela 64: *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas nivelit të arsimimit – Pyetësi për mësimdhënës*

Tabela 65: *Dallimet sipas nivelit të arsimimit të mësimdhënësve*

Tabela 66: *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas moshës – Pyetësi për mësimdhënës*

Tabela 67: *Dallimet sipas moshës së mësimdhënësve*

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

CRCA -Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri

DKA – Drejtoria Komunale e Arsimit.

IRCCRA-Qendrën e Informacionit dhe Kërkimeve për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri

MASHT – Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

QKSS - Qendra Kombëtare për Studime Sociale

SPSS 19 - Paketë Statistikore për Shkencat Sociale/Versioni 19.

(Statistikal Package for Social Sciences/Versioni 19)

SHLP- Shkolla e Lartë Pedagogjike

UNICEF – Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara

(The United Nations Children’s Fund)

WHO – Organizata Botërore e Shëndetësisë

(World Health Organization)

KAPITULLI I:

HYRJE

1. Vështrim i përgjithshëm i problemit të studimit

Shkolla me trupën e saj, përveç detyrave edukative-arsimore, ka për qëllim t'i përgatisë nxënësit me vlera demokratike dhe të tolerancës, sepse misioni i saj është që shoqëria të ndryshojë krahas ndryshimeve që bën ajo.

Krahas ndryshimeve që bën, shkolla po ballafaqohet edhe me probleme të shumta. Dukuria e dhunës është bërë problem shkollor, kombëtar si dhe global. Dhuna është ajo që e pengon atmosferën në shkollë dhe misionin e saj edukativo-arsimor.

Shkolla është institucion që siguron zhvillimin e shoqërisë por në këto mjedise edukative-arsimore, sjelljet e dhunshme në mes të nxënësve kanë filluar të bëhen mjaft shqetësuese për shoqërinë kosovare.

“Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e sanksionon dhunën në institucionet arsimore me infrastrukturë ligjore, bazuar në instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës/njeriut, por edhe kurrikulat dhe politikat arsimore që promovojnë ambiente miqësive, të shëndetshme dhe të sigurta për të gjithë brenda institucioneve arsimore ,prapë se prapë shkollat tona dhe realiteti ynë po përballet me probleme që bien ndesh me synimet tona për t'i arritur standardet për një shoqëri me vlera të qytetërimit demokratik” (MASHT-Doracak Për Parandalimin e Dukurive Negative në Shkolla të Mesme të Larta, 2014)

Organizata Botërore e Shëndetësisë e përkufizon dhunën si:

“Përdorim të qëllimshëm të forcës fizike ose të fuqisë, të kërcënimit ose të përdorimit të saj real, kundër vetes, një personi tjetër ose kundër një grupi a komuniteti, forcë e cila çon ose ka mundësi të çojë në plagosje, vdekje, dëmtim psikologjik, keq zhvillim ose privim” (G. Krug, L. Dahlberg, A. Mercy, B. Zwi and Lozano, 2002:29).

Institucionet arsimore shtetërore kombëtare hartojnë politika mbi arsimimin e nxënësve si dhe inovacionet në mësim, por gjithnjë duhet fokusuar edhe në hartimin e politikave dhe përmbajtjeve mësimore në tekste se si të edukohen nxënësit për sjellje sociale. Një hap i tillë do

t' ia lehtësojë jetën familjeve, po ashtu edhe organizimit të procesit edukativo-mësimor, ngase shoqëria në fokus ka shkollën dhe familjen, pa të cilat as që mund të funksionojë.

Rezultatet e hulumtimeve të shumta, të bëra në dekadën e fundit nga institucione të ndryshme dhe nga organizata jo-qeveritare, tregojnë një trend në rritje të dhunës në familje, dhe sidomos dhunë mes fëmijëve dhe të rinjve të moshës së njëjtë. Këto rezultate tregojnë se dhuna edhe në mesin e nxënësve në shkolla është në rritje.

Për ta trajtuar më mirë problematikën e sjelljeve të dhunshme të nxënësve ndihet e nevojshme të identifikohen faktorët që shkaktojnë shfaqje të sjelljeve të dhunshme të nxënësve në shkollë.

Dhuna dhe sjelljet e dhunshme të nxënësve mund të kryhen brenda shkollës, por faktorët për rritjen e sjelljeve të dhunshme mund të jenë të shumtë.

Duke u mbështetur në hulumtime, rezultate të projekteve të shumta dhe realitetit që e ndiejmë në çdo hap rezulton, se faktorët që ndikojnë në dhunën dhe pasigurinë që vërehet në shkolla janë si në vijim:

“Faktorët individualë (dija, qëndrimet, mendimet për dhunën dhe mangësitë e aftësive (aftësitë e kufizuara të komunikimit, përdorimi i drogës dhe alkoolit, qenia dëshmitar i dhunës apo të qenit viktimë e dhunës ndër personale, qasja ndaj armëve të zjarrit dhe armëve të tjera.);

Faktorët që rrjedhin nga familja (mungesa e dashurisë dhe e mbështetjes prindërore; përvoja me dhunën në shtëpi; dënimi fizik dhe keqtrajtimi i fëmijëve; prindërit dhe vëllezërit e motrat të përfshirë në sjellje kriminale.);

Faktorët shoqërorë (pabarazia shoqërore-ekonomike, urbanizmi dhe mbipopullimi; tranzicioni, shoqëruar me nivel të lartë të papunësisë në mesin e të rinjve; ndikimet e mjeteve të informimit publik; normat shoqërore që përkrahin sjellje të dhunshme; disponueshmëria e armëve; situata e pasluftës në Kosovë). Ndërkaq, në mënyrë të veçantë, sa i përket faktorit shkollë janë evidentuar mangësi në respektimin e ligjit, rregullave shkollore, kodit të mirësjelljes, udhëzimeve administrative që e rregullojnë funksionimin e sistemit të arsimit dhe krijimin e raporteve të shëndosha në relacionin nxënës-arsimtar, nxënës-nxënës, udhëheqës-arsimtar dhe prind- arsimtar.

Sa i përket faktorit ekonomik, janë relevante për t'u trajtuar edhe shifrat e numrit të nxënësve që vijnë nga familjet me asistencë sociale, por edhe ata pa prindër, sepse mund të jenë në predispozitë për të rënë pre e rreziqeve nga dukuritë e ndryshme. Duke mos e pasur përkujdesjen e duhur familjare dhe të ndikuar nga rrethanat socio-ekonomike, shumë fëmijëve u imponohet të kërkojnë punë për ta mbajtur veten dhe familjet e tyre, ashtu që rrezikohen të përfshihen në rrjete dhe rrethana të pasigurta dhe të pafavorshme për zhvillimin e tyre fizik dhe intelektual. Mirëpo, nga këto rrethana nuk përjashtohen edhe rastet e fëmijëve e të rinjve me pozita të larta ekonomike, por që nuk e kanë kujdesin e mjaftueshëm prindëror” (MASHT-Doracak për parandalimin e dukurive negative në shkolla të mesme të larta, 2014).

Meqë edukimi i fëmijëve fillon në familje dhe, si vazhdimësi ata në të njëjtën kohë janë pjesëtarë të komunitetit të lagjes, komunitetit shkollor, thënë në nivelin më të gjerë edhe të shoqërisë në përgjithësi, ne duhet t'i japim rëndësi edukimit të fëmijës sepse në një të ardhme ai mund t'i ndryshojë rrethanat në shoqëri.

Duke mos i mënjanuar asnjë nga faktorët e mundshëm për sjellje të dhunshme, e rëndësishme në punim është identifikimi i ndikimit të faktorëve familjarë që mund të rrisin shanset për sjellje të dhunshme në shkollë.

Duhet vënë theks i veçantë mbi rolin e familjes në edukimin e fëmijës për sjellje sociale, sepse faktorët që ndikojnë në formimin e fëmijëve, prindërit konsiderohen faktori i parë, ngase shtëpia e prindërve është shkolla e parë, ndërsa prindërit janë mësuesit e parë.

Nga literatura shumë sociologë, psikologë, dhe profesionistë që merren me problematikën e dhunës si dukuri sociale, për të cilën konsiderojnë se një nga faktorët për sjelljet të dhunshme është ekspozimi i hershëm i fëmijës ndaj dhunës. Nga ekspozimi i dhunës në moshë të re në familje ose edhe duke qenë dëshmitar i grindjeve familjare dhe brutaliteteve në familje, ndodh që fëmijët të edukohen me modele të tilla, saqë kur të rriten ata bëhen të dhunshëm sipas modeleve në familje. (www.kosova.com-artikulli 68591-QIK)

Në bazë të statistikave, nga hulumtimi i kryer në shkolla (2007), fëmijët të cilët marrin pjesë në kacafytje, kanë më shumë gjasa që në ardhmen të bëhen kriminelë. Shumë fëmijë që shfaqin sjellje të dhunshme në shkollë zakonisht janë të ekspozuar ndaj dhunës në shtëpi ose diku tjetër. (http://www.fiq-fci.org/repository/docs/siguria_ne_shkolla_shqip.pdf, parë 13 mars 2015).

Atmosfera që mbretëron në shtëpi mund të ndikojë në paraqitjen e sjelljeve të dhunshme tek të rinjtë. Atmosfera në familje dhe marrëdhëniet në mes të anëtarëve të familjes janë faktorë stabiliteti që e ndihmojnë zhvillimin e fëmijës për sjellje sociale në rrethin ku jeton.

Disa prej faktorëve kryesor familjarë të lidhura me dhunën adoleshente mund të jenë: “Mbikëqyrje e dobët e fëmijëve nga ana e prindërve dhe dënime të rënda fizike për disiplinimin e tyre, konflikte në mes të prindërve në fëmijërinë e hershme, nivel i ulët i besnikërisë në mes fëmijës dhe prindit, nënë, e cila e ka lindur fëmijën e parë në moshë të re, përjetim i përçarjes ose ndarjes së prindërve në moshë të hershme, nivel i ulët i kohezionit familjar, status i ulët socio – ekonomik i familjes (UNICEF).

“Faktorët socialë, politikë dhe kulturorë, niveli i ulët i kohezionit social në shoqëri lidhet me hapa më të larta të dhunës rinore, kualiteti i qeverisjes me shtetin, ligjet e saja si dhe shkalla në të cilën ato zbatohen dhe politika e mbrojtjes sociale kanë një efekt të rëndësishëm mbi dhunën. Faktorët si të ardhurat jo të barabarta, ndryshimet e shpejta demografike tek popullata e re dhe urbanizimi, të gjitha këto pozitivisht lidhen me dhunën rinore. Kulturat të cilat nuk japin alternativa jo të dhunshme për zgjidhjen e konflikteve duket së kanë shkallë më të lartë të dhunës rinore.”(http://www.who.int/violence_injury_prevention/violence/world_report/factsheets/en/youth_alb.pdf, parë 8 mars 2016).

Faktori tjetër është mungesa e vëmendjes së prindërve ndaj fëmijës, respektivisht fëmijëve. Shpeshherë, kjo dukuri arsyetohet me gjendjen ekonomike të një familjeje. Nuk duhet të pajtohemi me një arsyetim të tillë sepse të gjithë e dimë se ka pasur shumë njerëz të varfër, të cilët kanë dhënë shumë për familjet e tyre, shoqërinë, shtetin por edhe mbarë njerëzimin. Është zgjedhja që vetë prindërit bëjnë që t'i kushtojnë apo të mos t'i kushtojnë vëmendjen e duhur fëmijës të vet, në çfarëdo rrethanash. Prindërit janë ata të cilët e kanë fuqinë të ndërhyjnë dhe të udhëheqin sjelljen dhe qëllimet e fëmijëve të vet. Prindërit duhet ta kuptojnë se ata janë udhërrëfyesit e fëmijëve të tyre, pa marrë parasysh gjendjen ekonomike apo sociale. Fëmijët kanë nevojë të rriten me besimin se çfarëdo që do t'ju sjellë jeta, ata do të jenë të gatshëm ta përballojnë. Faktori tjetër që mund të ndikojë në natyrën e dhunshme të një të riu është edhe vetëdija

adoleshentit.

Sipas hulumtimit të Qendrës Kosovare për Studime Gjinore të dhënat raportojnë se ushtrohet dhunë në familje dhe se meshkujt janë ata që ushtrojnë më shumë dhunë. Në shumicën e rasteve, femrat janë viktimat të dhunës.

Fatkeqësisht, programet shkollore nuk ofrojnë njohuri të duhura që do të synonin përmirësimin e të kuptuarit të dhunës në një marrëdhënie. Një numër i kufizuar (13%) i respondentëve kanë përfituar nga programet shkollore (punëtori, fushata) që merren me parandalimin e dhunës në një marrëdhënie (<http://www.unfpakos.org/Prevalence-of-violence-alb-Prania> e dhunës në marrëdhëniet e adoleshentëve, 8 janar 2016).

Shkaqet e dhunës në shkolla janë të shumta, mirëpo ndër to ne në fokus kemi faktorët që rrjedhin nga familja, ku njëri ndër faktorët mund të jetë situata socio-ekonomike dhe varfëria më me ndikim sa i përket shkaqeve të dhunës. Përveç këtyre faktorëve, vendet e dala nga lufta, siç është rasti i Kosovës, kanë një tendencë për rritje të dhunës në përgjithësi. Duke shtuar këtu faktin se adoleshentët e sotëm kanë lindur para, pas ose gjatë luftës në Kosovë (1999), si rezultat i janë ekspozuar situatave të rënda konfliktuale ose pas-konfliktuale. Përveç kësaj, faktor tjetër që ndikon në rritjen e dhunës janë edhe mediat. Dhuna në media është një faktor tjetër madhor, problematik dhe i rrezikshëm i shtimit të dhunës së nxënësve në ditët e sotme, sikurse me të njëjtin intensitet ndikojnë edhe interneti dhe ekspozimi ndaj lojërave të ndryshme kompjuterike. Të gjithë këta faktorë, duke mos përjashtuar edhe të tjerë, janë elementë ndikues në zhvillimin e sjelljeve të dhunshme të nxënësit (<http://www.indeksonline.net>- Shkolla vend i ndërtimit të marrëdhënieve të bazuara në besim dhe tolerancë e jo dhunë (Shkolla, vend i ndërtimit të marrëdhënieve të bazuara në besim dhe tolerancë e jo dhunë-artikulli 86830, parë 15 shkurt 2013).

Familja është një ndër faktorët e parë për paraqitjen e dhunës në shkollë. Pa hyrë në detaje në shpjegimin e llojeve të familjeve, do të themi se ndryshimi i strukturës së familjes me përqafimin

e koncepteve të reja, më shumë shkon në vënien e fëmijëve në rrezik se sa në rrugë të drejtë. “Tashmë shumë prindër përdorin dënime të rënda fizike për disiplinimin e fëmijëve. Po ashtu edhe pabarazia shoqërore-ekonomike, urbanizmi dhe mbipopullimi; zhvillimi i shpejtë ekonomik, i shoqëruar me nivel të lartë të papunësisë në mesin e të rinjve, pastaj ndikimet e mjeteve të informimit publik, normat shoqërore që përkrahin sjellje të dhunshme, disponimi i armëve, etj., janë faktorët themelorë që të rinjtë të futen lehtë në konflikte dhe në dhunë me pasoja tejet të rënda. Të gjithë këta faktorë, sidomos atmosfera në shtëpi, është çelësi i zhvillimit të sjelljes së dhunshme te të rinjtë. Manifestimet e llojeve të ndryshme të dhunës janë të lidhura me dhunën si rezultat i familjes. (<http://koha.mk/opinion/4631-dhuna-ne-shkolle-eshteproblemsocial.html>, 5 mars 2016, citon të dhënat zyrtare).

Të dhënat e studimit nga Raporti i UNICEF-it “Dhuna ndaj Fëmijëve në Shqipëri” (2006), nxjerrin në pah tre qëndrime themelore lidhur me përdorimin e dhunës fizike dhe psikologjike. Qëndrimi i parë, që shfaqet në një masë relativisht të kufizuar prindërisht (kryesisht baballarësh), madje edhe mësuesish, e sheh dhunën fizike, në mënyrë absolute, si mjetin më efektiv në disiplinimin e fëmijëve. Bartësit e këtij qëndrimi nisen nga përvoja vetjake me prindërit e tyre, (të cilat ata i konsiderojnë të suksesshme), për të shprehur në mënyrë kategorike rëndësinë e dhunës.

Disiplinimi i fëmijëve përmes përdorimit të ndëshkimeve është një realitet i njohur jo vetëm në jetën e përditshme por edhe në kërkimet shkencore. Më së shumti dhuna përdoret kundër mosbindjes, rrëmujës, ecurisë jo të mirë në mësim, shkeljes së rregullave, etj.

Modeli i reagimit me dhunë ndaj gjërave që nuk pëlqehen është një model shumë i përhapur. Ai është një model të cilin fëmijët e shohin të përdoret mbi ta, një model të cilin fëmijët e përdorin mbi njëri tjetrin. Ky model pritet të përdoret nga po të njëjtët njerëz edhe kur këta të rriten e të bëhen prindër e mësues.

Përvetësimi i modelit të sjelljes së dhunshme përbën, kështu njërin nga pasojat e dukshme të efektit psikik të dhunës së të rriturve. Të rriturit vënë re se sjelljet e dhunshme të fëmijëve të tyre janë shumë të ngjashme me sjelljet e dhunshme që ata vetë kanë përdorur ndaj tyre. Modelimi psikik i të dhunuarve rezulton i ngjashëm me modelin psikik të dhunuesve të tyre. “Pasoja e modelimit psikik agresiv nuk është një pasojë që vjen menjëherë pas një përdorimi të caktuar dhune. Ajo, më shumë se kaq, është një rezultante e shumë akteve të përdorimit të dhunës dhe, kështu ajo përbën një pasojë të ngulitur fort në psikikën e fëmijës. Kjo do të thotë se çrrënjësja e kësaj sjelljeje dhunuese nuk është e lehtë. Një pasojë më e menjëhershme, pra që shoqëron aktet e dhunës mbi fëmijët është ajo e rebelimeve, sidomos të djemve, ndaj dhunës së përdorur mbi ta. Subjektet e studimit tonë na treguan episode të dhunës ndaj fëmijëve në Shqipëri. Është fjala për akte të rebelimit të vullshëm të fëmijëve, sidomos kur këta janë adoleshentë (TAMO & KARAJ, Tiranë, 2006).

Krahas faktorëve socialë familja dhe faktorët familjarë mund të tregojnë shanse për shfaqje të sjelljeve të dhunshme dhe secili nga hulumtimet e kryera për dhunën tek fëmijët, funksionin e familjes dhe faktorëve familjarë, si në nivelin lokal ashtu edhe ndërkombëtar, e shohin si jetik edukimin e fëmijës për një të ardhme kur ata do të rriten.

1.2. Prezantimi i problemit

Një ndër preokupimet dhe problemet që i paraqiten shkollës me stafin e saj, është dhuna dhe sjelljet e dhunshme tek nxënësit si dukuri mjaft shqetësuese. Kjo dukuri i dëmton nxënësit, familjen dhe shoqërinë, por që edhe e prish imazhin e shkollës si institucion edukativo-arsimor. Sjelljet e dhunshme kanë kosto të lartë për shoqërinë, si në nivelin emocional ashtu edhe financiar, ngase ato mund të barten nga një hallkë në tjetrën duke dëmtuar edhe shoqërinë në tërësi.

Nëse i referohemi të dhënave të fundit mbi Platformën e Sigurisë (2015-2018) në shkollat e Prishtinës, ajo tregon përmes planit të veprimit se gjendja në shkollat tona është mjaft shqetësuese nga sjelljet e dhunshme që nxënësit shfaqin në shkollë.

Paraqitja e këtij problemi në mënyrën sa më të mirë, do të krijojë hapësirë dhe mundësi që nëpërmjet rekomandimeve sa më konstruktive dhe të mbështetura në fakte shkencore, të ofrohen zgjidhje që do të ndikojnë në identifikimin e faktorëve familjarë që mund të rrisin shanset që edhe dhuna të rritet tek nxënësit në shkollë.

1.3. Fokusimi i hulumtimit

Ky hulumtim do të fokusohet në:

1. Përfshirjen e nxënësve të klasave të teta dhe të nënta në hulumtim, periudhë kjo e adoleshencës, e cila çdo herë paraqitet si periudha më kritike për prindërit dhe mësimdhënësit. Në hulumtim janë përfshirë nxënësit me fokus në shkollat e mesme të ulëta të Prishtinës, duke përfshirë edhe nxënësit e shkollave të rrethinës-fshatrat rreth Prishtinës, sepse në fokus është krahasimi rural-urban krahas sjelljeve të dhunshme të nxënësve në shkollë.
2. Në hulumtim janë përfshirë prindërit e fëmijëve, po të të njëjtëve fëmijë që janë anketuar, për të marrë opinionin e tyre në lidhje me perceptimin e tyre për faktorët familjarë.
3. Mësimdhënësit janë përfshirë për të paraqitur opinionin e tyre në lidhje me perceptimin që kanë. Edhe ata janë përzgjedhur nga po të njëjtat shkolla ku janë anketuar nxënësit.

1.4. Qëllimi i hulumtimit dhe hipotezat

Qëllimi i hulumtimit ishte vlerësimi i perceptimit të respondentëve rreth ndikimit të faktorëve familjarë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme të nxënësve në shkollë si dhe hulumtimi i faktorëve të tillë, si: mosha, gjinia, punësimi i prindërve, vendbanimi që janë faktorë të rëndësishëm për këtë hulumtim.

Meqenëse ky studim është i dizajnuar me metodat vlerësuese-krahasuese, nga ky qëllim i studimit dalin tri objektiva themelore:

Objektiva e parë: Të vlerësohen perceptimet e respondentëve rreth ndikimit të faktorëve familjarë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek nxënësit në shkollë si dhe të gjenden krahasimet e opinionëve midis respondentëve;

Objektiva e dytë: Të bëhet krahasimi i ndikimit të faktorëve familjarë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek nxënësit në vendet rurale dhe ato urbane;

Objektiva e tretë: Të bëhen krahasimet midis variableve demografike dhe faktorëve familjarë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek nxënësit në shkollat e qytetit dhe të fshatit.

Pyetjet kërkimore

1.A mund të ndikojnë faktorët familjarë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek nxënësit në shkollë?

2.A kanë dallime perceptimet e respondentëve rreth faktorëve familjarë që mund të ndikojnë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek nxënësit në shkollat e fshatit dhe qytetit?

3. A ka dallime ndikimi i faktorëve familjarë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme ndërmjet gjinive në shkollat e fshatit dhe qytetit?

4.A mund të kenë ndikim variabellet demografike në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek nxënësit në fshat dhe në qytet?

Hipoteza 1: Faktorët familjarë kanë ndikim në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek nxënësit në shkollë.

1.1. Perceptimi i mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve vlerëson se faktorët familjarë ndikojnë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme të nxënësve në shkollë;

1.2. Ka dallime në perceptimin e tyre rreth faktorëve familjarë që mund të ndikojnë në sjelljet e dhunshme të nxënësit në shkollë;

1.3. Marrëdhëniet jo të qëndrueshme në familje dhe gjendja ekonomike ndikojnë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek nxënësit në shkollë;

1.4. Prezenca e dhunës në familje nga prindërit dhe vëllezërit më të mëdhenj ndikon në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme të nxënësit në shkollë;

1.5. Qëndrimi ndëshkues i familjes ndaj fëmijëve ndikon në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme në shkollë;

1.6. Mbikqyrja e familjes ndikon në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme të nxënësve në shkollë;

1.7. Frika nga prindërit në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme të nxënësve në shkollë.

Hipoteza 2: Perceptimet e respondentëve rreth faktorëve familjarë dallojnë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek nxënësit nga fshati dhe qyteti

2.1. Ka dallime rreth perceptimit të ndikimit të faktorëve familjarë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme në shkollë;

2.2. Ka dallime në perceptimin e faktorëve familjarë tek prindërit, mësimdhënësit dhe nxënësit;

2.3. Lojërat e dhunshme dhe interneti ndikojnë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme të nxënësve në shkollat e fshatit dhe qytetit;

2.4. Atmosfera në familje ndikon në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek nxënësit në shkollë;

2.5. Nuk ka dallime në mes të nxënësve në fshat dhe qytet rreth faktorëve familjarë që mund të ndikojnë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme në shkollë;

2.6. Nuk ka dallime në mes të mësimdhënësve që punojnë në fshat nga ato në qytet rreth perceptimit të tyre për faktorët familjarë që kanë ndikim në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme të nxënësve në shkollë.

Hipoteza 3: Ka dallime gjinore në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek nxënësit në fshat dhe qytet.

3.1. Nuk ka dallime gjinore në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme të nxënësve në shkollat e fshatit dhe qytetit.

Hipoteza 4: Shfaqja e sjelljeve të dhunshme ndikohet nga variablet demografike

4.1. Perceptimi i faktorëve familjarë dallon për nga punësimi i prindërve shfaqjen e sjelljeve të dhunshme të nxënësve në shkollë;

4.2. Numri i anëtarëve të familjeve ndikon në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme të nxënësve në shkollë;

4.3. Fëmijët me prindër të ndarë kanë gjasa më të mëdha të shfaqin sjellje të dhunshme në shkollë, duke u ndikuar nga lojërat e dhunshme dhe interneti;

4.4. Koha se sa qëndrojnë fëmijët në internet, televizion dhe jashtë familjes ndikon në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme në shkollë.

1.5. Rëndësia e hulumtimit

Meqë familja është qeliza më e vogël brenda një shoqërie, ajo duhet të funksionojë e organizuar mjaft mirë në edukimin e fëmijëve sepse, në të kundërtën, nga një mos funksionim i mirë i saj në edukim, pasojat reflektohen edhe në shkollë dhe në shoqëri në përgjithësi. Studime të shumta janë bërë për hulumtimin e dhunës dhe sjelljeve të dhunshme të nxënësve në shkollë, por çdo studim po thuajse mbështetet vetëm në faktorët shoqërorë të kësaj periudhe të adoleshencës së fëmijëve, duke mos i vënë theks të veçantë anës empirike për faktorët familjarë dhe të kaluarës së edukimit të fëmijës. Për t'i identifikuar këta faktorë familjarë si dhe mënyrën e edukimit të fëmijëve, janë bërë hulumtime të shumta se si trajtohen fëmijët në familje dhe dhuna nga familjarët. Andaj është e rëndësishme që studimi të nxjerrë në pah rëndësinë e familjes dhe faktorëve familjarë, që mund të rrisin shanset për shfaqjen e sjelljeve të dhunshme në periudhën e adoleshencës. Sjelljet e dhunshme të nxënësve në shkollë, paraqesin një problem madhor shqetësues në nivel botëror dhe, në këtë aspekt, shkollat tona nuk mund të bëjnë përjashtim. Në këtë pikëpamje, identifikimi i faktorëve për sjelljet e dhunshme të nxënësve në shkollë duket shumë e rëndësishme, sepse kjo do të ndihmonte prindërit, mësuesit dhe drejtuesit e shkollave për përmirësimin e këtyre sjelljeve. Shkolla si institucion edukativo-arsimor nuk ka si funksion vetëm pajisjen e nxënësve me njohuri, por edhe pajisjen e tyre me vlera dhe qëndrime, që sigurojnë funksionimin normal të shoqërisë. Ndaj shkollat dhe institucionet udhëheqëse duhet të hartojnë politika të veçanta, duke përfshirë edhe familjen për edukimin e brezit të ri. Në këtë pikëpamje, kuptimi dhe identifikimi i faktorëve që rrisin shanset për paraqitjen e sjelljeve të dhunshme të nxënësve në shkollë, shërbejnë, në një kuptim më të gjerë dhe afatgjatë, për të mirën e shoqërisë, shkollës, familjes dhe vetë brezave të rinj.

Rëndësia e faktorëve familjarë nga të gjitha teoritë paraqet vlera teorike mbi edukimin e fëmijëve, prandaj identifikimi dhe njohja e faktorëve që rrjedhin nga familja mund të paraqesin

shqetësim për shkollën dhe shoqërinë në përgjithësi dhe mund të marrin përmasa më të mëdha. Identifikimi i këtyre faktorëve shkaktarë më të rëndësishëm të sjelljes së dhunshme të nxënësve në shkollë mund t' i shërbejë si gjetje dhe mbështetje empirike institucioneve që hartojnë lëndë dhe politika për edukimin e brezave të rinj. Përveç këtij aspekti praktik, mendoj se ky studim ka edhe një vlerë tjetër. Shkolla me trupën e saj çdo herë goditet se është faktor kryesor që edukon nxënësit për sjellje të dhunshme, andaj në mënyrë indirekte nxënësit kanë dhënë opinionin e tyre mbi faktorët familjarë se si ndikohen nga familja për sjelljet e tyre.

1.6. Kufizimet e hulumtimit

Hulumtimi “Ndikimi i faktorëve familjarë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek adoleshentët në shkollë”, mund të ketë kufizimet si në vijim:

Meqenëse studimi ka përfshirë vetëm nxënësit e klasave të teta dhe të nënta në Komunën e Prishtinës të dhënat mund të gjykohen si të kufizuara, ndaj nuk mund të përgjithësohen edhe për të rinjtë e vendeve të tjera të rajonit.

Prindërit mund të mos jenë të sinqertë në dhënien e opinionit të tyre rreth perceptimit për faktorët familjarë tek fëmijët e tyre. Prindërit zakonisht janë subjektivë në vlerësimin e sjelljeve të fëmijëve të tyre.

Meqë dukuria e dhunës është paksa problematike për t'u raportuar, andaj fëmijët, prindërit dhe mësimdhënësit edhe pse mund të jenë vetë raportues të saj të drejtpërdrejtë, ata mund ta fshehin opinionin e tyre brenda pyetësorëve në lidhje me faktorët familjarë. Gjithashtu, instrumentet që matin perceptimet e nxënësve dhe prindërve janë parë si të nevojshëm, meqë dukuria e cila ka të bëjë me faktorët familjarë është e ndërlikuar për studim. Nxënësit dhe prindërit mund të hezitojnë për të dhënë opinione mbi jetën e tyre direkt në familje.

Po ashtu, studimi mund të jetë i kufizuar nga mungesa e përdorimit të ndonjë metode cilësore në kombinim me instrumentet që janë përdorur, të cilat kryesisht kanë qenë matje vetë raportuese sasiore.

1.7. Përcaktimi i termave

Nocionet themelore me të cilat trajtohet tema janë të rëndësishme të shpjegohen për t'u kuptuar sa më mirë tematika që është studiuar.

Në këtë punim, termat e përcaktuara për të përcjellë kontekstin janë: Dhunë, sjellje e dhunshme, faktorë, familje, shkollë, nxënës, ndikim, identifikim, eksplorim.

Dhuna është nocioni kryesor dhe trajtohet si problemi kyç në këtë hulumtim. Në fjalorin e gjuhës shqipe, kemi disa sinonime për nocionin dhunë. Dhuna si nocion ka domethënien e:

“Përdorimit të forcës, detyrimit, keqtrajtimit, teprimit, përdhunimit, vrazhdësisë, egërsisë, abuzimit, etj. (Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe, 2005: 234-235).

Nocioni dhunë, në fjalorët psikologjikë shpjegohet si:

“Veprim i qëllimshëm për ta detyruar tjetrin, me mjete fizike a psikike t'u nënshtrohet interesave, synimeve e dëshirave të dikujt” (Nushi. P, 1987:53).

Organizata Botërore e Shëndetësisë e përkufizon dhunën si:

"Përdorimin e qëllimshëm të forcës ose të fuqisë fizike, të kërcënuar ose të vërtetë, kundër vetvetes, një personi tjetër, ose kundër një grupi ose komuniteti, që ose rezulton ose ka një gjasë të madhe për të shkaktuar lëndime, dëmtimi psikologjik, keqpërdorimi ose privimi " (WHO, 2000: 29).

Sipas studimit Dhuna me Bazë Gjinore 2008:

“Dhunë është çdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik (Dhuna me Bazë Gjinore, Tiranë 2008:28).

Prof. Afërdita Zuna thotë se “dhuna mund të shpjegohet me fjalët:

Keqtrajtim, forcë, përdhunë, përdhunim, shtrëngim, detyrim, abuzim, teprim, shpërdorim etj. (Zuna, A.2008).

Sipas Bregut (2005), *dhunë konsiderohet çdo sjellje apo qëndrim që dëmton mirëqenien fizike, emocionale dhe seksuale të një apo disa personave dhe që ndikon në ndërprerjen e zhvillimit normal të individit (Dhuna me Bazë Gjinore, 2005).*

Federata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhunën e përkufizon si:

“Përdorimi forcës apo pushtetit, ose si një veprim a mosveprim në çdo mjedis, i kërcënuar, apo perceptimi real kundër vetes, ndaj një personi tjetër apo një grupi, një komuniteti që ka gjasa, ose çon, ose ka gjasa të larta të rezultojë në vdekje, dëmtim fizik, psikologjik apo emocional, zhvillim ose privim”(Zuna A, 2008:2).

Koncepti i dhunës shkollore përfshinë dëmtimin fizik, psikologjik dhe atë të pasurisë por, gjithashtu, përfshin edhe shantazhimin, kërcënimin verbal dhe poshtërimin (Olweus, 1993, Olweus et al, 1999), vandalizmin, dëmtimin trupor nga arsimtarët apo stafi tjetër (Benbenisty et al, 2000), përdhunimin (Page, 1997), krimet pasionale dhe vrasjen (Anderson et al, 2001).

Sipas Anica Mikush-Kos:

“Dhuna është çfarë do formë e sjelljes e cila ka për qëllim shkaktimin e qëllimshëm të dhimbjes fizike ose psikike të tjetrit” (Mikush-Kos, 2007:5).

Përkufizimi i dhunës në shkollë përfshin edhe presionin psikologjik, kërcënimet dhe sjelljet, me qëllim të frikësimit të viktimës (Loeber dhe Stouthamer-Loeber 1998), si dhe format indirekte të agresionit, të tilla, si thashethemet dhe përjashtimet, injorimet, shmangiet (Crick dhe Bigbee, 1998, Smith dhe Sharp 1994).

Ka tashmë disa përkufizime për këtë term. Termi “dhunë në shkollë” nënkupton praninë e dhunës në ndërtesën e shkollës, në shkollë ose në autobusin e shkollës. (Henry, 2000); Furlong dhe Morrison (2000) e përcaktojnë këtë term kur një dhunë e tillë ndodh në shkollë, në mjediset e shkollës, në rrugën drejt ose nga shkolla, ose gjatë ngjarjeve të organizuara të shkollës.

Në Kosovë, përkufizimi i termit "dhunë në shkollë" përdoret në raportin e Qendrës së Kosovës për Studime Gjinore, "Përhapja e dhunës në marrëdhëniet e adoleshentëve" (2012), sipas të cilit: "Dhuna në shkollë, llojet e incidenteve të dhunshme që ndodhin brenda ndërtesës së shkollës, në oborrin e shkollës dhe në afërsi të tij. Përvojat e dhunës që përfshijnë dhunën e nxënësve ndaj nxënësve, nxënësve dhe mësuesve tek mësuesit tek nxënësit "(f.11).

Në fjalorin sinonimik të gjuhës shqipe nocioni familje përkufizohet si:

“Njësi e vogël e organizimit të jetës shoqërore” (Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe, 2005:255).

Në “Fjalorin e Psikologjisë”, familja përkufizohet si:

“Bashkësi e vogël individësh e formuar në bazë të martesës së burrit dhe gruas të caktuar. Burri e gruaja me anën e institucionit të martesës të kurorëzimit kanë vënë marrëdhënie psikologjike, morale dhe juridike ndërmjet tyre” (Fjalor i psikologjisë 1987:65).

Sipas Riza Bradës:

Familja është *”grup njerëzish-prindër me fëmijë që jetojnë bashkë”* (Brada, 2012:61).

Sipas Afërdita Zuna:

“Familje e ngushtë përkufizohet bashkësi e individëve të gjinive të ndryshme që lidhin martesë dhe krijojnë fëmijët e tyre” (Zuna, 2008:4).

I referohemi nocionit familje sepse në rrethanat tona, në të shumtën mund të jenë edhe anëtarë të tjerë, duke përfshirë prindërit, motrat, vëllezërit, gjyshërit, xhaxhallarët, hallat që mund të jetojnë në një shtëpi .

“Familja rurale që jeton në vendet rurale e që zakonisht edhe i mban disa karakteristika më tipike, si: Familja e madhe”, por familja rurale më me vështirësi i pranon raportet bashkëshortore dhe prindërore demokratike, që do të thotë e ruan frymën e patriarkalitetit (Zuna&bashkautorët 2009:24).

“Familja urbane zhvillon jetën në qytet dhe karakterizohet si familje që pranon më lehtë ndryshimet e raporteve, shprejnë në favor të anëtarëve të saj “ (Zuna&bashkautorët 2009:24).

Në “Fjalorin e pedagogjisë”, gjejmë shpjegimin se nocioni *“shkollë në latinisht schola, nga greq. e vjetër – fjalë për fjalë, lexim, shpjegim i veprave shkencore”*(Osmani,1983:647)

Në “Fjalor i psikologjisë” shkolla si nocion shpjegohet si,

“institucion edukativo arsimor, në të cilin organizohet veprimtaria e edukimit dhe arsimit të brezit të ri sipas planit dhe programit të caktuar në bazë të bashkëveprimit të arsimtarëve dhe nxënësve” (Fjalor i psikologjisë, 1987:285).

“Shkolla është institucion me organizim të veçantë, detyra themelore e së cilës është realizimi i qëllimeve dhe detyrave të procesit të edukimit” (Pedagooski leksikon, 1996:567).

Nxënës është ai që ndjek mësimet, idetë e pikëpamjet e dikujt, ai që përfiton nga përvoja e dituritë e dikujt.

Sipas shumë fjalorëve shqip *“ndikimi është autoriteti që ka dikush mbi dikë, forca e pushtetit”*

Adoleshencë konsiderohet, *“periudha e zhvillimit fizik dhe psikologjik, që manifestohet me një numër të madh ndryshimesh të natyrës; biologjike, emocionale, konjitive dhe sociale. Fillon rreth moshës 11-13 vjeç ,me shfaqjen e karakteristikave seksuale dytësore dhe përfundon me pjekurinë e plotë seksuale (rreth moshës 18-19 vjeç)”*(Lala, 2010:11).

1.8. Struktura e punimit

Punimi është strukturuar në tetë kapituj.

Kapitulli i parë paraqet situatën aktuale të dhunës dhe sjelljeve të dhunshme të nxënësve në shkollat e mesme të ulëta publike në Prishtinë. Më pastaj kapitulli përshkruan qëllimet e punimit, hipotezën e pyetjet kërkimore, fokusimin e hulumtimit, rëndësinë dhe kufizimet e hulumtimit.

Kapitulli i dytë përmban shqyrtimin e literaturës lidhur me teoritë mbi adoleshencën, adoloshenca, faktorët e lidhur me dhunën, duke filluar nga dhuna në familje, tipologjitë e familjes që i kontribuojnë shfaqjes së sjelljeve të dhunshme, disiplinimi i fëmijëve, dhuna ndaj fëmijëve në familje, dhuna ndaj adoleshentëve në familje, modelet e përshkallëzimit të dhunës, faktorët e rrezikut personal dhe numri i anëtarëve në familje që mund të i kontribuojë shfaqjes së sjelljeve të dhunshme.

Në kapitullin e tretë paraqiten metodologjia e hulumtimit. Në këtë kapitull përshkruhet dizajni i hulumtimit, popullata, instrumentet e përdorura në hulumtim, procesi i analizës dhe aspekti etik i hulumtimit.

Në kapitullin e katërt, pestë dhe të gjashtë paraqiten rezultatet e hulumtimit, të dhënat që janë arritur të grumbullohen. Këta kapituj përmbajnë analizën e të dhënave, përpunimin e tyre me anë të pyetësorëve të përdorur. Në këta kapituj prezantohen rezultatet kryesore mbi analizën faktoriale të faktorëve të paraqitur në pyetësorin e nxënësve, prindërve dhe mësimdhënësve.

Në kapitullin e shtatë janë opinionet e nxënësve, prindërve dhe mësimdhënësve në lidhje me faktorët familjarë që shfaqin sjelljet e dhunshme të nxënësve në shkollë, ku krahas të dhënëve të dala nga hulumtimi ato krahasohen në nivelin e regjionit se si flasin hulumtimet po ashtu në nivelin botëror.

Në kapitullin e tetë paraqiten përmbledhja dhe rekomandimet që dalin nga hulumtimi për MASHT-in dhe DKA-në si dhe propozimet për vazhdim të studimeve të mëtutjeshme. Ky kapitull përmban instrumentet e hulumtimit (pyetësorët) si dhe bibliografia që ka të bëjë në të gjithë listën e materialeve dhe uebfaqeve të lexuara, cituara për nevojat e hulumtimit të kryer.

Në shtojcë janë paraqitur pyetësorë e përdorur në hulumtim, tabelat e analizave të dala dhe punimet e publikuara, që janë pjesë të shkoqitura nga ky punim, po ashtu në këtë kapitull është e paraqitur edhe leja nga MASHT-ti dhe DKA-ja për hulumtimin e temës.

KAPITULLI II

2.0. Adoleshenca

Adoleshenca është një periudhë ndryshimesh të mëdha si për fëmijën ashtu edhe për prindërit, të cilat ndryshime jo të gjithë i kuptojnë dhe i mirëpresin. Fëmijët, gjatë kalimit nga fëmijëria në moshën e rritur, i nënshtrohen ndryshimeve të shumta fizike, emocionale dhe në fushën e sjelljes. Kjo periudhë është e karakterizuar nga sfida të papritura dhe është e shoqëruar, gjithashtu, nga ankthe e probleme, si p.sh.: të ndihesh i pranuar, të arrish rezultate të larta në shkollë, të kesh raporte të mira me familjen, të kalosh vështirësitë dhe të marrësh vendime të rëndësishme për të ardhmen.

Pjesa më e madhe e këtyre anktheve është e pa mënjnueshme dhe të ndihesh i shqetësuar është diçka normale. Rreth periudhës së adoleshencës flasin shumë psikologë si periudhë e tranzicioni që përcillet me ndryshime fizike, biologjike dhe psikike tek fëmijët. Organizata Botërore e Shëndetësisë e identifikon adoleshencën si *“periudhë në rritje dhe zhvillim njerëzor, që ndodh pas fëmijërisë dhe para moshës madhore nga moshat 11 deri 19 vjeç”* (http://www.who.int/maternal_child_adoloscent/topisc/adolescence/dev/en/shfrytëzuar)

Termi adoleshent vjen nga latinishtja “adolescere” që do të thotë “rritem, “maturohem”, piqem. Adoleshenca është një moshë shumë delikate dhe prindërit duhet të bëjnë shumë kujdes me fëmijët e tyre për t’i ndihmuar ata në këtë proces zhvillimi.

“Adoleshenca është periudha e jetës, e cila përfshin vitet ndërmjet fëmijërisë dhe moshës së rritur”. Ajo përbëhet apo kalon në tri faza apo pjesë, të cilat janë: para adoleshenca, adoleshenca e hershme dhe adoleshenca e vonë.

Gjatë adoleshencës kalohet nëpër një seri momentesh të rëndësishme fizike, e që më i dukshmi është vrulli i rritjes (Morris & Maisto, 2008:331). Krahas ndryshimeve fizike, këtë periudhë e

përcjellin edhe ndryshime biologjike, sociale, psikologjike, të cilat bëjnë që kjo periudhë të jetë e vështirë për prindërit që të gjenden përballë këtyre ndryshimeve që ndodhin tek fëmijët e tyre.

Në etapën e parë, para adoleshencës, që lidhet me rindërtimin e organizmit, zhvillimi fizik dhe fiziologjik ndryshon dhe shfaqen dyzime e lëkundje në karakter, të rinjtë dashurojnë vrullshëm dhe urrejnë papritmas, binden, nënshtrohen, por edhe rebelohen (Kaza, 2006:13). Është e rëndësishme se ata manifestojnë gjendje të ngritur emocionale dhe pa u kuptuar shndërrohen në kokëfortë, jo rrallë hutohen, përfshihen nga ndjenja e të qenit i pavlefshëm (kjo ndikon të mbyllet në vetvete). Në këtë moshë *zhvillohet të menduarit teorik reflektiv. Shkallë-shkallë ngrihen në një nivel më të lartë veprimet mendore: analiza, sinteza, klasifikimi, përgjithësimi* (Kaza N, 2006:14).

Në fazën e adoleshencës së hershme fëmijët fillojnë të ndjejnë sensacione të reja trupore. Në dukje është e rëndësishme se vërehen ndryshime të shumta fizike dhe, që fëmijët në adoleshencën e hershme fillojnë të mendojnë për domethënien e jetës, kalimin e kohës, natyrën e vdekjes dhe ndryshime të tjera të rëndësishme. Vetën dhe prindërit i sheh në mënyrë tjetër. Marrëdhëniet me bashkëmoshatarët e gjinisë së njëjtë kanë një rëndësi të madhe në adoleshencën e hershme.

Adoleshencës e vonë është periudha ku shumë njohës të zhvillimit dhe psikologë japin ide dhe mendime madje se ajo mund të shkojë deri në moshën 22-25 vjeç, varësisht zhvillimeve individuale.

2.1. Teoritë e lidhura me dhunën

Shumë praktikantë, hulumtues, teoricienë të fushave të ndryshme të psikologjisë, sociologjisë, pedagogjisë dhe biologjisë kanë kontribuar në një rang të gjerë të teorive që shpjegojnë shkaqet e sjelljeve të dhunshme të nxënësve nëpër shkolla.

Një arsye e rëndësishme për studimin e fëmijës është se ngjarjet dhe përjetimet e viteve të hershme kanë treguar të jenë me efekte tepër të fuqishme për zhvillimin e mëvonshëm të individit. Teoritë psikologjike sugjerojnë se sjellja jonë kur jemi të rritur ndikohet shumë nga zhvillimi dhe përjetimet tona të fëmijërisë (Vasta, Haith, Miller 2007:23).

Shikuar nga konteksti historik i edukimit të fëmijës nëpër kohë të ndryshme edhe edukimi ka ndryshuar. Nëse analizojmë edukimin në Greqinë dhe Romën e Lashtë, atëherë ndëshkimet e ashpra ndaj fëmijëve nuk konsideroheshin si të gabuara dhe të ndaluara me ligj por si forma edukimi.

Gjatë Mesjetës kisha ndërmori një qëndrim kundër vrasjes së fëmijëve, gjë që në këtë kohë pati ndryshime dhe këndvështrimi mbi fëmijën vazhdoi të përparonte. Mirëpo pavarësisht nga kjo abuzimi dhe shfrytëzimi i fëmijëve mbeti një dukuri e zakonshme gjatë gjithë jetës (Vasta, Haith, Miller, 2007:26).

Në autobiografinë e Shën Agustinit (354-430) ai përshkruan ngjarjet e fëmijërisë, të cilat duhen kuptuar se shumë nga gjurmët e para tek të rriturit mund t'i kenë rrënjët te fëmijëria (Vasta, Haith, Miller 2007:26).

Rëndësinë dhe rolin e edukimit të prindërve si mundësi dhe detyrim për t'i edukuar fëmijët e arsyeton edhe Xhon Kalvin, i cili besonte se fëmijët kanë kapacitet të madh për të mësuar në një moshë të hershme dhe se prindërit kanë mundësi dhe detyrim për t'i edukuar si duhet ata (Vasta, Haith, Miller 2007:27).

Teoritë biologjike mbi edukatën theksojnë rolin e vetive të trashëguara (Brada,1995) , ku sjelljet e dhunshme tregojnë se kanë bazë gjenetike.

Biologu britanik Çarls Darwin me teorinë e tij të evolucionit dha mundësinë se shumë sjellje njerëzore e kanë origjinën e tyre në të kaluarën. Xhon Loku, Zhan Zhak Ruso dhe Çarls Darvini paraqitën teorinë mbi sjelljen njerëzore dhe janë paraardhësit direkt të tri traditave teorike që e karakterizojnë shkencën e psikologjisë së fëmijës edhe në kohët tona. Këto tri tradita moderne përfshijnë një model që përqendrohet në ndikimin e mjedisit ndaj fëmijës, një tjetër e dytë që nënvizon rolin e zhvillimit njohës të fëmijës dhe e treta e lidhur me origjinën evolucioniste të sjelljes (Vasta, Haith, Miller 2007:28).

Sipas ithtarëve të drejtimit biologjik, E. Kreçmerit, S. Hollit, C. Lombrosos, rrethi shoqëror, edukata dhe aktiviteti i individit janë të pafuqishme që të ndikojnë në ndryshimin e natyrës së lindur të njeriut (Brada, 2012:74).

Stenli Holl (1846-1924) ishte i interesuar për studimin e periudhës së adoleshencës. Psikologu Edmond Dragoti në librin e tij” Adoleshenti” thekson se autori Stenli Hall flet për teorinë biologjike dhe fazat e zhvillimit evolutiv të organizmit njerëzor (Dragoti, 2005). Arnold Gesëll (1880-1961) besonte se zhvillimi priret para se gjithash nga proceset gjenetike (Vasta, Haith, Miller, 2007:37), e veçanërisht ai arrin në përfundim se pjekuria e adoleshencës është pasojë e ndikimit të gjeneve, koha është ajo që i rregullon sjelljet e adoleshentëve (Dragoti, 2005).

Sipas teorisë biofizike faktorë të sjelljeve të papërshtatshme janë faktorët gjenetikë, temperamentit dhe faktorët biokimikë (Zabeli, 2008:27).

Periudha e adoleshencës karakterizohet me ndryshime nga varësia drejt pavarësisë, prandaj këto ndryshime që lidhen edhe me bazën gjenetike të agresivitetit në adoleshencë, mund të jenë për shkak të lidhjes së hormonit seksual mashkullor-testosteronit, i cili tregon rritje në adoleshencë,

ku ndikimet biokimike nga kimia e gjakut nga eksperimentet e bëra tregojnë edhe se sjelljet tek meshkujt mund të ndryshojnë dhe të jenë të dhunshme. Tek adoleshentët ndikimi gjenetik me kalimin e kohës mund të rritet, ndërsa ndikimi familjar pakësohet (Myers, 2003:350). Shoqata psikologjike Amerikane dhe Këshilli Ndërkombëtar i Psikologëve përkrah idenë se është e gabuar të thuhet se lufta dhe sjelljet e dhunshme janë të programuara gjenetikisht në natyrën tonë njerëzore (Myers, 2003:350).

Teoritë e agresionit dhe ideatorët mbi sjelljet e dhunshme të fëmijëve, veçanërisht adoleshentëve kanë hapur debate se ato mund të jenë të lindura por edhe të fituara.

Zhan Zhak Ruso fajëson shoqërinë për të keqën shoqërore dhe jo natyrën njerëzore, kurse Xhon Loku dha idenë se fëmijët ishin produkt i mjedisit dhe rritjes që edhe sot një ide e tillë mbahet si ide teorike ajo mjedisore. Loku besonte se mjedisi i një personi dhe përvoja e tij janë çelësat e të kuptuarit e sjelljes njerëzore (Vasta, Haith, Miller, 2007:52).

Teoria psikodinamike e Sigmund Frojd argumentoi një model ndërveprues në të cilin shtrihen të dy proceset, si ai i lindur dhe i mjedisit, që kontribuojnë fuqishëm në zhvillimin e fëmijës. Ai sugjeroi se përvoja e hershme mund të japë efekte të rëndësishme në sjelljen e mëvonshme të tij. Frojdi nuk e vlerësoi deri në fund rëndësinë e faktorëve konstitutivë dhe gjenetikë për formimin e karakterit të fëmijës (From, 2009:77). Shumica e frojdistëve besonin se familja dhe përjetimet e fëmijës në familje janë të rëndësishme për zhvillimin e fëmijës. Kjo vajti deri aq larg sa që psikoanalistët mendonin që fëmija i keq ose fatkeq ka prindër të cilët e kanë sjellë në atë gjendje ose përkundrazi (From, 2009:77).

Frojdi zhvillimin e fëmijës dhe të karakterit e lidhi edhe me çështjen e edukimit në fëmijërinë e hershme, 0-8 muajsh, me rastet kur nëna është e dhunshme dhe nuk dëshiron dhënien e gjirit, atëherë mund të zhvillohet një karakter oral pasiv. Si rrjedhim këta fëmijë në të ardhmen priren që të jenë agresivë (Boeree, 2004).

Ana Frojd u fokusua në analizat e fëmijëve e, sidomos adoleshentëve ku, sipas saj, fëmijët i kanë emocionet e çastit dhe emocionet e tyre janë bihevisoriste të mësuara.

Biheviorizmi mbështetet në kontrollin e sjelljes, që sipas Skinner (1904-1990) sjellja udhëhiqet nga shpërblimi dhe ndëshkimi. Nga eksperimentet e bëra, Skinner tregon se prindërit kanë rëndësi në zhvillimin e fëmijës e veçanërisht të sjelljes së tij. Në raste të tilla nëna nuk duhet t'i kushtojë vëmendje kur fëmija sillet jo mirë, sepse ashtu mund ta bëj përforsimin pozitiv edhe më shumë, por përkundër kësaj prindërit do të ishte mirë t'i përgjigjen pozitivisht dhe me dashuri sjelljeve të pranueshme të fëmijës, sepse ato do të përforsohen edhe më shumë (Skinner, 1961:419).

Teoria e të nxënës tregon rëndësinë e të nxënës gjatë përvijës. Skinneri mendonte se e tërë sjellja është rezultat i veprimt të mjedisit, atëherë çelësi i kuptimit të sjelljes është analiza e llojeve të përvijave të mëparshme të personit (Juniku,1997).

Schneider (1988), shprehet se “fëmija përvetëson normat prindërore” dhe se devijanca shkaktohet kur “procesi i socializimit dështon” (Schneider , 1987:528).

Erik Erikson theksoi se e rëndësishme është cilësia e marrëdhënieve prind-fëmijë, sepse familja formon kontaktin e parë të fëmijës me shoqërinë (Morris & Maisto, 2008:362).

Studiuesi Nye (1958) përpunoi teorinë e tij të kontrollit social, duke theksuar rolin e familjes si një nga burimet e sjelljes devijante. Sipas Nye ekzistojnë tre lloje të kontrollit: (i) kontrolli i brendshëm “i ushtruar prej, brenda dhe nëpërmjet ndërgjegjes”; (ii) kontrolli direkt “i imponuar nga jashtë nëpërmjet kufizimeve dhe dënimeve” dhe (iii) kontrolli indirekt, i cili mundësohet prej një “identifikimi emocional me prindërit apo persona të tjerë jo devijantë”, të cilët shërbejnë si shembuj apo modele për t'u ndjekur (Nye, 1958, f. 5-6). Teoria e të mësuarit social e vlerëson

agresivitetin si një formë të sjelljes së mësuar sociale. Agresiviteti mësohet nëpërmjet vëzhgimit dhe imitimit të njerëzve të tjerë dhe ruhet nëpërmjet përforcimit pozitiv.

Sipas Karen Hornit faktorët mjedisorë dhe socialë kanë ndikim më të madh në formimin e personalitetit dhe thelbësore janë marrëdhëniet njerëzore që përjetojmë kur jemi fëmijë (Morris & Maisto :2008361).

Patterson (1997) mendon se modelet luajnë rol të rëndësishëm në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme. Ai supozon se fëmijët që rriten në familje me ndëshkime të ashpra dhe me dhunë familjare kanë më shumë gjasa të përdorin agresionin për të zgjidhur problemet e tyre.

Përkundër mendimeve të tjera Anika Wolfolk thekson se modelet e agresionit janë programet televizive që përmbajnë një shkallë të lartë dhune, sipas saj në Shtetet e Bashkuara të Amerikës rreth 82% e programeve televizive përmbajnë dhunë, të paktën në një shkallë të caktuar (Woolfolk, 2011).

Albert Bandura zhvilloi një sërë eksperimentesh mbi agresivitetin, ai mbështetet në atë se fëmijët modelojnë sjelljet e të rriturve nga vëzhgimi, duke i imituar sjelljet e tyre. Sipas Bandurës jeta e përditshme na ekspozon modele agresive në familje dhe këtë e mbështetet në modelimin ngase ata që kanë prindër ndëshkues priren për t'u sjellë dhunshëm me të tjerët. Nga hulumtimet e bëra, ai pajtohet me mendimin se sjelljet janë të mësuara në bazë të vëzhgimit dhe modelimit.

Ndër teoritë sociologjike dallohet teoria e Dyrkemit, me idetë pozitiviste mbi edukimin e fëmijës. Ai konsideron se socializimi është proces i ndërlikuar i formimit të personalitetit të ri, si proces i zhvillimit të aftësive të fëmijës për adaptim në shoqëri.

Lev Vygotski (1896-1934) besonte se zhvillimi i fëmijëve fillon nga lindja, nga ndërveprimi i faktorëve shoqërorë dhe të mësuarit social. Teoria social-kulturore e Vygotskit ishte e përqendruar në atë se si kultura, vlerat, besimet, zakonet dhe shkathtësitë e një grupi social,

transmetohen në gjeneratën tjetër. Vygotski pajtohet me Piazhën në atë se zhvillimi është proces i ndërmjetësimit social, i varur nga mbështetja e të rriturve edhe nga pjekuria që ata fitojnë në të provuarit e detyrave të reja (Berk, 2001).

Social-psikologu amerikan Stanley Milgram studioi reagimet e njerëzve ndaj autoritetit të fuqishëm. Eksperimenti i tij kryesor ka të bëjë me shkallën e përshtatshmërisë së bindjes në procesin e të mësuarit për shkak të dënimit apo detyrimit (Dragoti, 2000).

Po ashtu, një grup studiuesish nga Universiteti Yale publikuan të dhëna që sugjerojnë se agresiviteti shkaktohet nga frustracioni (Dragoti, 2000).

David.G Myers thekson rolin kryesor mbi familjen, sub-kulturën dhe masmediat në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek fëmijët (Myers, 2003).

Urie Bronfenbrenner (1917-2003) përmes teorisë së sistemeve ekologjike, besonte se fëmijët zhvillohen brenda një sistemi kompleks të ndarë në katër sisteme që ndikojnë në zhvillimin e fëmijës:

Mikrosistemi, që përfshin ata që janë pjesë e mjedisit të parë të fëmijës, përfshirë prindërit e fëmijës dhe kujdestarët e tjerë. Ndërveprimet në mes të fëmijëve dhe të rriturve, ndikojnë në zhvillimin dhe sjelljet e fëmijëve.

Mezosistemi përfshin ato sisteme që bashkëveprojnë me individët në mikrosistem, duke përfshirë kështu programet e kujdesit të fëmijëve dhe institucionet e ndryshme edukative.

Ekosistemet janë vendet në të cilat fëmijët nuk kalojnë vetëm kohën, por që indirekt veprojnë në zhvillimin dhe sjelljet e fëmijëve, duke përfshirë p.sh politikat e punës së prindërve.

Makrosistemi përbëhet prej vlerave, ligjeve, zakoneve dhe burimeve të një kulture të veçantë (Berk, 2000:29).

Shumë teoricienë theksojnë rolin dhe funksionimin e familjes. Neki Juniku vë në dukje, se fëmijët që janë rritur me modele prindërisht agresivë, zakonisht janë të prirur të shfaqin sjellje të dhunshme si një formë e reagimit të tyre kundërshtues (Juniku, 1994).

Sipas Afërdita Zunës rëndësia e familjes së plotë dhe të harmonishme në krijimin e personalitetit të fëmijës është e veçantë. Kur prindërit ofrojnë dashuri ndaj fëmijëve ose në rastet kur marrëdhëniet ndërmjet prindërve janë të shëndosha (Zuna, 2003), fëmijët imitojnë dhe mësojnë sjelljet e tyre ose në të kundërtën reflektojnë sjellje asociale.

Naser Zabeli thekson se shkaktar i agresivitetit të nxënësve konsiderohet të jetë edukimi i tyre, kulturat dhe kushtet në të cilat janë zhvilluar dhe zhvillohen. Ndërkaq ai potencon se në kuadër të rrethanave jetësore, në të cilat zhvillohet fëmija, duhen theksuar dy aspekte të përgjithshme në familje, traumat në familje, çrregullimi i raporteve, përkatësisht konfliktet e shpeshta dhe përdorimi i dhunës brenda familjes dhe, e dyta, përvoja e vet fëmijës (Zabeli, 2008).

Teoria Rudolf Dreikurs në thelb përbëhet nga katër hapat, ndër to e rëndësishme është se kjo teori tregon të kundërtën e asaj "zjarri me zjarr", si duhet vepruar për t'i eliminuar këto sjellje të dhunshme (Zabeli, 2008).

Anthony Giddens pohon se jo të gjithë fëmijët gëzojnë dashuri dhe kujdes nga prindërit, ose të rriturit. Po ashtu, konsideron se abuzimi fizik dhe seksual tek fëmijët është tipar i rëndomtë i jetës familjare, e që abuzime të tilla kanë dalë në pah kohët e fundit (Giddens, 2007:90). Sipas Giddens gjinia femërore është në shkallë më të vogël e përfshirë në rastet e dhunës sesa gjinia mashkullore (Giddens, 2007:146).

"Studimet e Campbellit dhe të Carlenit tregojnë se dhuna nuk është ekskluzivisht karakteristike e kriminalitetit të meshkujve, por që gratë janë shumë më pak të prirura se burrat për të marrë pjesë në krimin e dhunshëm." (Giddens 2007:148).

“Janë djemtë ata që krijojnë alarm me veprimet e tyre të papritura kundër normave e kundër autoriteteve në familje, në shkollë e bashkësi. Situata e vuajtjeve të djemve shprehet nëpërmjet veprimeve, kundërshtimeve dhe aksioneve të përditshme. Vajzat vuajnë në heshtje e vetmi, fshihen në dhimbjet e tyre”(KAZA N, 200: 22).

Teoritë psikologjike e trajtojnë mjaft mirë agresionin, për sjelljet e dhunshme janë bërë eksperimente, vëzhgime dhe shumë studime të rastit por aktualiteti i kësaj çështjeje vazhdon të marrë jehona edhe më të gjëra në tërë vendet e zhvilluara duke iu mbështetur faktorëve socialë.

2.2. Rishikim i literaturës

Dhuna në familje mund të shpjegohet si një ndikim ndërveprues i faktorëve të ndryshëm, të cilët mund të ndahen në tri kategori: individuale, familjare, dhe socio-kulturore. Dhuna vazhdon të shihet gjithnjë e më shumë si një shqetësim, duke iu referuar faktit se kjo ndikon kryesisht tek fëmijët dhe të rinjtë dhe se pasojat e saj negative dëmtojnë qëllimet kryesore të arsimit (CDCP, 2004).

Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO) raporton se në mesin e fëmijëve të moshës shkollore në shumë pjesë të botës, rreth një e treta e tyre kanë raportuar të jenë përfshirë në dhunë fizike, ndërsa meshkujt kanë dy ose tre herë më shumë gjasa sesa femrat që kanë qenë të dhunshëm.

Studime nga shumë vende në të gjitha rajonet e botës vënë në dukje se 80 deri në 98 % e fëmijëve vuajnë ndëshkimin fizik në shtëpitë e tyre, prej nga një e treta ose më shumë përjetojnë ndëshkime fizike të rënda, që rrjedhin nga përdorimi i mjeteve të ndryshme (Dhuna ndaj fëmijëve në Shqipëri 2007:9).

Nga një studim i kryer nga Instituti Kombëtar i Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara, është konstatuar se n.q.s. një fëmijë është abuzuar ose keqtrajtuar, ka një mundësi më të lartë (53% më shumë se një fëmijë normal) të arrestohet si adoleshent, dhe 38% më shumë si i rritur për t’u përfshirë në një krim të dhunshëm. Fëmijët që kanë qenë dëshmitarë të dhunës në familje,

zakonisht ushtrojnë sjellje agresive dhe jo-shoqërore, të frikësuar, të dëshpëruar (Qendra “Aleanca Gjimore për Zhvillim” 2005:12)

Në një studim të vitit 2012, me qëllim të identifikimit të ndikimit të familjes dhe të moshatarëve në sjelljen devijante, u anketuan 1.526 të rinj prej dy qyteteve turke: Ankarasë dhe Stambollit. Studiuesit İçli dhe Çoban (2012) evidentuan se familja nuk luante rol parësor, për sa i përket ndikimit tek sjellja devijante e të rinjve. Rolin kryesor, sipas gjetjeve të studimit të tyre, e luante grupi i moshatarëve devijantë, me të cilin adoleshenti/-ja shoqërohej. Ky rol sipas autorëve turq, bëhet edhe më domethënës për ata të rinj, të cilët janë larguar prej familjes që në moshë të herët dhe jetojnë në rrugë apo ndajnë një vendbanim me shokët/shoqet e tyre, për arsye se kjo lloj jetese/bashkëjetese e “bën më të lehtë të mësuarit për të kryer krimin” (İçli dhe Çoban, 2012, f. 71).

Nga raporti i veçantë për dhunën ndaj grave dhe veprimtarinë e avokatit të popullit në korrik të vitit 2012 u vërtetua dhe konstatua se prej 146 fëmijëve që kishin qenë të pranishëm në akte dhune në familje, vetëm 23.6% i kanë thënë dikujt për këtë dhunë. Nga raporti doli se fëmijët e zonave rurale 66.4 % kishin më shumë gjasa të goditeshin me shuplakë, grusht ose shkelma nga një anëtar i familjes, krahasuar me fëmijët në zonat urbane 50.4%. Nga ky raport doli që në dhunën e fëmijëve u vunë re edhe dallimet gjinore, ku djemtë kishin gjasa më shumë se vajzat të përjetonin dhunën fizike në familje. (www.avokati i popullit.com, 2012).

Faktorët që çojnë në rritjen e sjelljeve të dhunshme tregojnë edhe rritje të dukurisë së dhunës. Këta faktorë që mund ndikojnë tek fëmijët për t’u bërë të dhunshëm e për të kryer krime janë shumëdimensionalë: faktorë ekonomikë, faktorë që lidhen me familjen, faktorë që lidhen me shkollën, faktorë socialë, faktorë psikologjikë. Të gjithë faktorët e lartpërmendur janë të lidhur në mes tyre, por në veçanti faktorët familjarë, ku tek fëmijët që ushtrohet dhunë evidentohen vuajtje më të shumta nga probleme të sjelljes dhe janë më pak të aftë për të vepruar në shoqëri, në

krahasim me fëmijët që vijnë nga familjet ku nuk ka dhunë. Origjina e dhunës i ka rrënjët në strukturat shoqërore të ndërlikuara vlerash, traditash, zakonesh dhe besimesh që lidhen me të, (Dr. Skënder Damaliaj, 08 Janar 1:05).

Sipas hulumtimit "Parandalimi i dhunës në shkollë" i kryer nga MASHT dhe realitetin që e ndjejmë në çdo hap, rezulton, se faktorët që ndikojnë në dhunën në shkollë janë si në vijim:

Faktorët individualë (dija, qëndrimet, mendimet për dhunën dhe mangësitë e aftësive (aftësitë e kufizuara të komunikimit, përdorimi i drogës dhe alkoolit, qenia dëshmitar i dhunës apo të qenit viktimë e dhunës ndër personale, qasja ndaj armëve të zjarrit dhe armëve të tjera);

Faktorët që rrjedhin nga familja (mungesa e dashurisë dhe e mbështetjes prindërore; eksperiencat me dhunën në shtëpi; dënimi fizik dhe keqtrajtimi i fëmijëve; prindërit dhe vëllezërit e motrat, të përfshirë në sjellje kriminale.);

Faktorët shoqërorë (pabarazia shoqërore-ekonomike, urbanizmi dhe mbipopullimi; zhvillimi i shpejtë ekonomik, shoqëruar me nivel të lartë të papunësisë në mesin e të rinjve; ndikimet e mjeteve të informimit publik; normat shoqërore që përkrahin sjellje të dhunshme; disponueshmëria e armëve; situata pas konfliktit.

(http://www.mashtgov.net/advCms/documents/Parandalimi_i_dhunes_ne_shkolla.pdf, parë 9 maj 2014)

Faktorët familjarë mund t'i rrisin rreziqet për zhvillimin e sjelljeve të dhunshme; konfliktet dhe dhuna në mesin e anëtarëve të familjes (Elliot et al., 1998) veçanërisht në mes të prindërve, është identifikuar si një ndikim në zhvillimin e sjelljeve të dhunshme të fëmijëve. Elliot (1994) gjithashtu ka gjetur se individët që janë të ekspozuar ndaj niveleve të larta të dhunës në mes të prindërve të tyre ishin më të dhunshëm kur u rritën.

Faktorët e historisë familjare zakonisht janë zbuluar të jenë shumë të rëndësishëm në nxitjen e dhunës (Olweus 1993), me prindërit të cilët janë vetë të dhunshëm. Mungesë të ngrohtësisë prindërore dhe monitorim të dobët të sjelljes së fëmijës, është më e ngjarë të kenë fëmijë të cilët shfaqin sjellje të dhunshme, agresive në shkollë.

Një ekip studimesh në Amerikë realizoi një studim në vitin 2000 me 380 fëmijë, i cili vërtetoi se çrregullimet depressive tek fëmijët dhe adoleshentët ishin më të shpeshta nëse prindërit e tyre ishin depresivë. Një nga aftësitë bazë të tyre që në vogëli është imitimi i modeleve, siç janë prindërit, familja dhe komuniteti (<http://rvistapsikologji.com/ti-mësojmë-fëmijëve-optimizmin>, parë 2 mars 2016).

Edmond Dragoti arsyeton se kultura familjare është model shumë i rëndësishëm, por në këtë moshë adoleshenti shkëputet nga familja, madje i kundërvihet asaj. Sipas tij, bashkëmoshatarët dhe rrethi social kanë dominancë më të madhe tek adoleshentët (<http://www.arkivalajmeve.com/Dhuna-ne-shkolla-forum-me-dy-psikologe-e-dy-sociologe.1046959354>, parë janar 2016)

Mungesa e mbikëqyrjes së familjes është një nga përcaktuesit e fortë të kriminalitetit (Farrington, 1995; Loeber & Stouthamer-Loeber, 1986, Olweus, 1980) dhe dhunës tek fëmijët.

Anila Sulstarova pohon se dhuna te fëmijët është pasqyra e asaj që ndodh në shoqëri. Por sidomos aty ku mungon një familje e shëndoshë, sepse së pari model për fëmijët është familja. (<http://www.arkivalajmeve.com/Dhuna-ne-shkolla-forum-me-dy-psikologe-e-dy-sociologe.1046959354>/ E premte, 03 dhjetor 2010).

Disa studime kanë evidentuar se individët, të cilët raportojnë se kanë një marrëdhënie negative me prindërit e tyre, kanë më shumë gjasa të jenë të përfshirë në sjellje delikuede. Fëmijët duke qenë të ekspozuar ndaj niveleve të larta të konfliktit familjar mund të rrisin gjasat për të ardhmen e dhunshme. Fëmijët që perceptojnë situata negative dhe mosmarrëveshje në mes të prindërve,

mund të ndjehen më pak të mbështetur nga prindërit e tyre dhe do të mund të jenë më të rrezikuar për t'u bërë viktimë e krimit personal. Dhuna si cikël është një veçori tjetër e familjeve që përjetojnë dhunë. Zakonisht në familjet ku ushtrohet dhunë edhe fëmijët janë viktima të dhunës. Fëmijët e abuzuar kur rriten shndërrohen në abuzues". Shumë hulumtime argumentojnë faktin se të përjetuarit e dhunës në familje gjatë fëmijërisë paraqet potencial që fëmijët në të ardhmen të shndërrohen në abuzues.

Nga hulumtimi në Britaninë e Madhe i kryer me adoleshentë 10 -16 vjeç dolën të dhëna të rëndësishme se familja dhe e kaluara e fëmijërisë kanë ndikim në sjelljet e adoleshentëve, ku 20% e fëmijëve raportuan se kanë kryer krime, kurse 59% kishin kryer vepra të dhunshme. Ky hulumtim nxori ndërveprimet e faktorëve të rrezikut në nivel të familjes, shkollës dhe komunitetit, që janë të lidhura me përfshirjen e sjelljeve të dhunshme në adoleshencë. Variablet e familjes përfshijnë cilësinë e marrëdhënieve fëmijë-prind, aftësitë prindërore si dhe komunikimin familjar. (Estévez, Emler and Woo)

Gjithashtu, në përputhje me literaturën, vëmë re ndryshimet në përputhje me mbizotërimin e dhunës në familje. Në pyetësor kishim tregues të shumtë për nxënësit që kanë përjetuar dhunë në familje. Përveç kësaj, gjendja social-ekonomike e prindërve të nxënësve, gjithashtu, ndikon në shkallën e dhunës së fëmijëve të tyre. Nxënësit, prindërit e të cilëve janë të papunë (babai dhe / ose nëna) janë dukshëm më të dhunshëm në krahasim me nxënësit e tjerë (.13; $p < 0.01$). Edhe pse, papunësia është vetëm një masë e parë e situatës social-ekonomike në familje. Fëmijët e prindërve të papunë dhe fëmijëve që përjetojnë dhunë në familje kanë shkallë më të lartë të përhapjes së dhunës në shkolla (FUCHS, M 2008).

Hulumtimi për gjendjen e dhunës në shkollat fillore në Maqedoni në vitin shkollor 2008/2009, bëri një analizë rrënjësore të gjendjes aktuale nëpër shkolla, duke identifikuar format e ndryshme të dhunës nëpër shkolla, prevalencën e formave të dhunës, frekuencën, kohën, vendndodhjen e

sjelljes së dhunshme, shkaqet e sjelljes së dhunshme dhe relacionet ku ndodhin sjelljet e dhunshme arsimtar-nxënës, djalë-vajzë, dhuna ndër etnike, etj. Ne hulumtimin ishin përfshirë gjithsej 1240 nxënës të tetëvjeçares të shkollave fillore. Fëmijët treguan se dhuna është rezultat i dallimeve dhe pozicioneve jo të barabarta të fuqisë-më të moshuarit i keqtrajtojnë më të vegjlit, më të fuqishmit më të dobët, djemtë-vajzat, arsimtarët-nxënësit (UNICEF, Studim për gjendjen initiale me dhunën në shkollat fillore në Maqedoni, 2008-2009:10).

Nëse krahasohen të dhënat me nivelin botëror mbi dhunën ndaj fëmijëve, atëherë lidhur me dhunën të fëmijët shqiptarë, raportohet se 58% e fëmijëve rrihen nga një anëtar i familjes, si dhe një numër i lartë prej 86% e fëmijëve bëhen dëshmitarë të dhunës në familje, 43% e fëmijëve hasin vështirësi në shkollë, 31% e fëmijëve jetojnë me frikë për shkak të dhunës në familje, 6% e fëmijëve largohen nga shtëpia për të jetuar me të afërmit.

Në bazë të këtij studimi, rezulton se burrat me arsim të mesëm ose të ulët kanë më shumë gjasa të jenë më të dhunshëm në familje sesa ata me arsim universitar (info@gazeta-shqip.com) – parë më 11mars 2017 Artemisa Hoxha, Dhuna ndaj fëmijëve në Shqipëri).

Të dhënat e dala nga raporti i manualit "Si të kërkojmë mbrojtje nga dhuna në familje" (OSBE 2013), raportohet se fëmijët që janë dëshmitarë të dhunës në shtëpitë e tyre mund të kenë vështirësi serioze emocionale, zhvilluese edhe në sjellje. Këta fëmijë kanë më shumë mundësi që të bëhen adoleshentë dhe të rritur emocionalisht të paqëndrueshëm, agresivë dhe të dhunshëm (Manuali "Si të kërkojmë mbrojtje nga dhuna në familje, OSBE, 2013)

Bazuar në totalin e të anketuarve, 41.6% e tyre kanë përjetuar abuzim emocional, 16.9% abuzim psikologjik, 6.2% dhunë fizike dhe vetëm 0.4% dhunë seksuale. E thënë ndryshe, duke u bazuar vetëm tek të anketuarit që kanë deklaruar se kanë përjetuar të paktën një formë të dhunës në familje (n=254): 93.3% e tyre kanë përjetuar abuzim emocional, 38.2% abuzim psikologjik,

14.2% dhunë fizike dhe vetëm 0.8% dhunë seksuale. Pra, shohim se dhuna pësohet në disa forma. Viktimat e dhunës në familje kanë përjetuar mesatarisht 1.5 forma të dhunës në familje.

Rreth 40 % e shqiptarëve në fshat dhe 30 % në qytet e justifikojnë dhunën! Rezultati në fjalë del nga një raport që titullohet “Studimi bazë mbi dhunën në familje dhe policinë e shtetit (2012)” dhe nxjerr zbuluar disa nga problemet kryesore, qoftë të institucioneve që duhet të merren me parandalimin e dhunës, por qoftë dhe probleme që lidhen direkt me nivelin e njohurisë dhe të kulturës në 5 qarqe të vendit, në zona urbane dhe në ato rurale.

Prevalenca e dhunës në familje rritet me rritjen e numrit të anëtarëve të familjes dhe sipas vendbanimit vend rural-urban prevalenca e dhunës në familje në mjediset rurale është më e lartë edhe për burrat edhe për gratë (Dhuna në Maqedoni Hulumtim Nacional 2012- 2015).

Në Kosovë sipas Sektorit të Shërbimit Investigativ për dhunën në familje dhe abuzimin e fëmijëve, janë regjistruar 3300 raste të raportuara të dhunës në familje deri në qershor 2007. Numri më i lartë i rasteve u regjistrua në vitin 2006 (1,371) ndërkohë që rajoni më i prekur ishte Prishtina me 989 raste të raportuara. (Zotërimi i armëve të zjarrit dhe dhuna në familje-SEESAC 2007).

Ndikimet nga faktorët rrethues dhe shtimin e sjelljeve të dhunshme tek fëmijët në krye të elementeve të mjedisit në fjalë vjen familja pastaj shkolla dhe shokët –miqtë (Prof. Dr .Zhydi Dervishi, Dok. Genti Kruja, Zani i Naltë, nr.2, 2013).

Nga hulumtimi i kryer nga Darina Çoni (Kacollja) doli një nga faktorët që ndikon në dhunën ndaj fëmijëve , që është mendësia e prindërve që besojnë se dhuna ka ndikim edukativ tek fëmijët. Kjo del nga të dhënat, ku rreth 8.0 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se prindërit mendojnë që dhuna ka ndikim edukativ.

Edukimi i nxënësve që në fëmijëri ka pasur probleme për shkak të mjedisit patriarkal, ku janë rritur. Ky mjedis nuk i vlerësonte fëmijët dhe adoleshentët; atyre nuk u dëgjohej mendimi. Një faktor tjetër që ndikon në këtë dhunë është mosbindja e fëmijëve ndaj prindërve. Nga të dhënat e anketimit del se 9,5 për qind e të anketuarve deklarojnë se faktor për dhunën ndaj tyre është mosbindja ndaj prindërve. Në shoqëritë tradicionale bindja e fëmijëve ndaj prindërve ose ndaj të rriturve, ishte normë që nuk shkelej (Darina Çoni (Kacollja), 2015:183).

Hulumtimet e kryera në vende të ndryshme të botës kanë raportuar se ngacmimi i nxënësve në shkollat fillore varion nga 11.3% në 49.8% (O'Moore dhe Kirkham, 2001, Pellegrini dhe të tjerët, 2001, Karatzias dhe të tjerët, 2002).

Hulumtimi në Evropë identifikon një numër të rritur të iniciativave nacionale dhe lokale për të ndaluar problemet e dhunës dhe për të siguruar mbështetje për shkollat.

Një shembull i mirë i punës aktuale në Britaninë e Madhe–Programi për Reduktim të dhunës në shkolla (Violence Reduction in schools Programme-Viris) në kuadër të departamentit të arsimit të njohurive në Angli merret me studimin që pretendojnë të kenë zgjidhje që ta identifikojnë dhunën në institucionet e tyre (Gittins, 2006)

Një hulumtim i kryer nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe UNICEF-i (2013-2014) tregon se, krahasuar me vende të tjera të rajonit dhe në botë, gratë dhe vajzat e Kosovës kanë tolerancë mjaft të lartë ndaj dhunës fizike, duke lënë pas në mënyrë të ndjeshme Malin e Zi dhe Serbinë, madje edhe Malauin në Afrikë dhe Vietnamin në Azi, ku 42 për qind e grave të pyetura nëse kanë qëndrim pranues ndaj dhunës në familje në rrethana të caktuara, kanë thënë “Po”.

Sipas tyre shkak i parë i dhunës në familje është shkalla e lartë e papunësisë. (<http://www.albinfo.ch/mbi-42-te-grave-ne-kosove-pranojne-dhunen-ne-familje/>, parë 5 prill 2015). Nga hulumtimi i USAID-it (Fondacioni i Iniciativës Qytetare) për sigurinë në shkolla dhe problemet në shkolla potencohet se sjelljet e dhunshme, në të shumtën e rasteve janë të bartura

nga problemet familjare (Siguria në shkollë-Sfidë për komunitetin-USAID, 2007). Mjedisi familjar është parë jashtëzakonisht i rëndësishëm në formësimin e fëmijëve. “Dhuna familjare është një model i sjelljes abuzive, kërcënuese, ndëshkuese që mësohet përmes vëzhgimit sesi sillen më të mëdhenjtë dhe mbështetjes (ku shoqëria e përkrah dhe e konsideron diçka të zakonshme e morale) brenda familjes dhe në shoqëri” (Kosta, 2007).

Konteksti familjar është një kontribuues i fuqishëm i shqetësimit emocional, angazhimit në shkollë dhe marrëdhënieve të përbashkëta si dhe sjelljeve të dhunshme (Banyard et al., 2006, Harachi et al., 2006). Një shqyrtim meta-analitik nga Gershoff (2002) konfirmoi se ndëshkimi trupor prindëror ishte i lidhur me sjelljet agresive të fëmijës. Në të kundërt, komunikimi i hapur dhe i rrjedhshëm ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, i karakterizuar nga respekti dhe ndikimi, kishte një efekt mbrojtës kundër zhvillimit të sjelljeve delikuede të adoleshentëve (Connell, et al., 2011).

Bazuar në studimin e MASHT-it dhe UNICEF-it në Kosovë, mbi dhunën ndaj fëmijëve në shkollë doli se shumë nga fëmijët kanë deklaruar se ushtrues të dhunës janë njerëzit e afërt. Shumë prej tyre thanë se djemtë janë më të rrezikuar nga dhuna fizike, kurse vajzat janë më të rrezikuara nga keqpërdorimi verbal (STRATEGJIA PËR SHKOLLAT PROMOVUESE TË SHËNDETIT NË KOSOVË 2009 – 2018, parë në 10 tetor 2013).

Zhvillimi i problemeve të sjelljes kushtëzohet nga disa faktorë, ku prindërimi konsiderohet si një prej faktorëve që ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin e fëmijës (Patterson, Reid & Dishion, 1992; Stormshak, Bierman, Mc Mahon & Lengua, 2000).

Konfliktet e hershme martesore në çifte mund të lënë efekte afatgjata psikologjike për të miturit dhe të vazhdojnë në moshën madhore (<http://yvj.sagepub.com>, 2 february, 2009, The Risk and Protective Factors of Violent, Youth Violence and Juvenile).

Ka disa shenja se kujdesi i tepruar prindëror, në të kundërtën, mund të parashohë rrezikun që fëmija të bëhet viktimë e dhunës (Gittins, 2006:15).

Në një analizë, duke përfshirë variable të veçanta të nivelit të identifikuar, gjinia, moshë, papunësia e prindërve dhe dhunës në familje, si faktorë shpjegues, doli se nxënësit meshkuj, të mitur të moshës 14 deri 17, fëmijët e prindërve të papunë dhe fëmijët që përjetojnë dhunë në familje dhanë shkallë më të lartë të përhapjes së dhunës në shkolla (FUCHS M, 2008)

Gjetjet nga hulumtimi në Kenia tregojnë se 90.5% e mësuesve meshkuj, perceptuan nivel të ulët të mbikëqyrjes në shtëpi, si një nga faktorët që kontribuojnë në shtëpi për sjellje të dhunshme, ndërsa 5.2% nuk pajtohen me deklaratën. Nga ana tjetër, 92.8% e femrave mësuese u pajtua me deklaratën përkundrejt 6.2% që ishin kundër. Gjithashtu, 93.9% e mësuesve meshkuj u pajtuan se marrëdhëniet e dobëta në mes të prindërve dhe fëmijëve të tyre çon në dhunë, përkundrejt 6.2% që e kundërshtuan këtë ide. Për sa i përket femrave mësuese 86.1% ishin dakord, përkundrejt 2.1% që ishin në kundërshtim me deklaratën. Mënyra e fëmijëve për disiplinimin në shtëpi u mbështet nga 91.4% e mësuesve meshkuj përkundrejt 3.4% që ishin kundër. Nga ana tjetër, 91.7% e femrave mësuese u pajtuan me thënien, përkundrejt 23.1% që pohuan se nuk ishin dakord. Meshkujt që mbështetën idenë e prindërve që ishin të dhunshëm përbënin 81.9%, përkundrejt 12.1% që nuk ishin dakord. Në mënyrë të ngjashme 76.3% e femrave u pajtuan me thënien, përkundrejt 19.6% që nuk ishin dakord (Moses Wesang'ula Poipoi; John O. Agak and Eric K. Kabuka, 2011).

Sipas studimit, i cili anketoi perceptimet e etikës së 3771 nxënës, mësues dhe prindër gjatë periudhës shtator-dhjetor 2016, përgjegjësia për këto sjellje bie mbi të gjithë aktorët në arsim.

Gjetjet e raportit të mbështetur nga fondacioni Mary Ward Loreto treguan se mësuesit, nxënësit dhe prindërit ishin të vetëdijshëm për sjelljet e tyre jo etike, por ata ia hidhnin fajin njëri-tjetrit,

model ky i nxitur sipas studiuesve nga mungesa e komunikimit mes tre hallkave kryesore të arsimit.

Rezultatet treguan se sjelljet jo etike të mësuesve, të raportuara nga nxënësit dhe prindërit – ishin përdorimi i autoritetit si mjet ndëshkimi, komunikimi i papërshtatshëm përmes fjalëve fyese, gjuha sarkastike apo përdorimi i nofkave fyese, si dhe favorizimi i nxënësve në kuadër të preferencave personale. (www.reporter.al/studimi-dhuna-verbale-dhe-fizike-perdoret-si-mjet-edukimi-ne-shkollat-shqiptare/)

Faktorët kryesorë në shtëpi që janë identifikuar nga të anketuarit në ishin si më poshtë: Marrëdhënia e dobët në mes të prindërve dhe fëmijëve; mënyra e disiplinimit të fëmijëve në shtëpi; prindërit dhunën; ekspozimi ndaj filmave të dhunshme dhe niveli i ulët i mbikëqyrjes në shtëpi. Të tjerë të përfshirë që vijnë nga familje të thyera (Journal of Emerging Trends in Educational Research and Policy Studies (JETERAPS) 2(1):30-40 (ISSN:2141-6990)

Farrington (1995) gjeti korrelacionin e moderuar në mes të konfliktit prindëror dhe vetë-raportimit të dhunës në adoleshencë. Të rinjtë në të gjitha grupet ranë dakord së familja siguron një ndikim kryesor social nëpër të gjitha fazat e jetës së tyre. Kur të rinjtë përballen me sfida, ata e shohin familjen si burim veçanërisht të rëndësishëm të këshillave dhe udhëzimeve si dhe për sjellje të duhura dhe formim të karakterit (Hulumtimi M Përmbledhje e MPV-së), hulumtimi i dimensioneve të maskulitetit, feminitetit dhe dhunës me të rinjtë dhe të rejtat e Kosovës (Anne K. Eckman Christine Ricardo Ereblir Kadriu Olivera Stula John Crownover Besnik Leka-2012-Prishtinë)

Duke parë rëndësinë e familjes dhe të anëtarëve të saj, konsiderohet se familjet me një prind kanë më shumë të ngjarë që të kenë fëmijë me probleme në sjellje sesa familjet me të dy prindërit (Weintraub & Gringlas, 1995), sikurse edhe kur ka mosmarrëveshje ndërmjet partnerëve

(Webstar-Stratton, 1989) dhe marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve konsiderohen si faktorë që ndikojnë në sjellje (Patterson e të tjerë, 1992).

Qendra e Trajtimit Multidisiplinor për Problemet e Keqtrajtimit të Fëmijëve gjatë vitit 2003, konstaton se shumë prindër dhe mësues në Shqipëri akoma mendojnë se disiplinimi fizik bën pjesë në “rritjen dhe edukimin” e fëmijëve të tyre. Rreth 75.08% e prindërve dhe 71.6% e mësuesve, konfirmojnë se disiplina fizike është një dukuri e zakonshme në Shqipëri. Rreth 31.84% e prindërve dhe 39.9% e mësuesve të intervistuar, ishin të mendimit se disiplinimi fizik gjatë fëmijërisë nuk i kishte dëmtuar fëmijët e tyre, por përkundrazi ata kishin mësuar ndryshimin mes së mirës dhe së keqes. Në këtë studim ishin përfshirë 1000 nxënës të moshave 6-12 vjeç dhe 13-18vjeç. Nga ky studim u konstatua se:

- ☐ 58.1% e fëmijëve të intervistuar të këtyre grup moshave kishin përjetuar dhunë emocionale në familjet e tyre.
- ☐ 40.7% e fëmijëve u shprehën se ishin nënat, të cilat abuzonin emocionalisht me ta dhe 17.4% u shprehën se ishin baballarët.
- ☐ 36% e fëmijëve konstatuan se nënat e tyre abuzonin me ta fizikisht, ndërsa 21.5% thanë se ishin baballarët.
- ☐ 22.9% e tyre u shprehën se baballarët e tyre përdornin alkool, gjë e cila rezulton në zënkat ndërmjet prindërve.
- ☐ 73.3% e fëmijëve vërtetuan prezencën e keqtrajtimit të fëmijëve nëpër shkolla.
- ☐ 11% e fëmijëve kishin pasur ngacmime seksuale dhe 4% e tyre i kishin përjetuar ato në ambientin familjar.
- ☐ 4% e fëmijëve pranuan përjetimin e dhunës seksuale” (Aleanca Gjimore për Zhvillim” 2005:13)

Nga hulumtimi doli se si djemtë ashtu edhe vajzat përafërsisht kanë qenë të dhunuar; por dallimi mes tyre është se djemtë kanë përjetuar më shumë dhunë fizike kundrejt vajzave që ishin abuzuar seksualisht.

Nga një hulumtim i kryer në Prishtinë në vitin 2012 doli se femrat e reja, duke analizuar karakteristikat e personalitetit të meshkujve të rinj, shprehen se dhuna është në natyrën e meshkujve, karakteristikë e personalitetit të tyre të lindur, "të qenit shumë nervoz ". Ekspozimi ndaj dhunës në familje, si dhe presionet që lidhen me stresin ekonomik, mund të rrisë tek disa meshkuj "nervozizmin" dhe "agresivitetin ".

Këto rezultate tregojnë rëndësinë e mbikëqyrjes, nga prindërit dhe nga të rriturit e tjerë pas shkollës. Siç është cekur nga Orpinas et al. (1999), sa më shumë të rriturit mbikëqyrin adoleshentët, gjasa më të vogla ka që të rinjtë të përfshihen me moshatarët me sjellje devijante dhe të angazhohen në sjellje të dhunshme.

Mungesa e mbikëqyrjes, disiplina e çrregullt dhe ndëshkuese, shkalla e lartë e ndërveprimeve neglizhente në fëmijëri mund të jenë faktorë që fëmijët në të ardhmen të shfaqin sjellje jo të mira (Reid & Patterson, 1991). Nëse prindërit janë të dhunshëm, fëmijët e tyre priren që në të ardhmen të sillen edhe ata dhunshëm (Hallahan & Kauffman, 2006; Rudo, Pauell & Dunlap, 1998).

Edhe pse një pjese e konsiderueshme e grave në të dyja zonat, si urbane, ashtu dhe rurale përjetojnë abuzim emocional dhe dhunë fizike, gratë nga zonat rurale kishin në mënyrë të theksuar më shumë gjasa që të përjetonin abuzim emocional dhe dhunë fizike nga bashkëshorti/partneri intim, krahasuar me gratë në zonat urbane. (INSTAT, 2013).

Nxënësit në shkollat rurale nuk ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga nxënësit në shkollat urbane në perceptimet e tyre mbi faktorët që kontribuojnë në shtëpi sjellje të dhunshme.

Të dhënat e dala nga hulumtimi i Dorina Çonit (2015) “Dhuna në Qarkun e Elbasanit”, tregojnë se fëmijët janë dëshmitarë të dhunës në familje kur ajo ndodh në mes të prindërve, e raportuar në 42.8%. Fëmijët kanë raportuar se kanë qenë të pranishëm kur prindërit janë grindur. Hulumtimi flet për shifra të larta, ku 59.9% kanë deklaruar se dhuna në familje ka pasur ndikim tek ata, dhe 24% kanë deklaruar se dhuna ka qenë e drejtuar ndaj grave dhe vajzave në familje.

Nëse i referohemi krahasimeve në mes të zonave rurale dhe atyre urbane për ushtrimin e dhunës, shifrat flasin për vlera më të larta për zonat rurale të ushtrimit të dhunës, sepse familjet janë më të shpeshta me mentalitet patriarkal dhe mbizotërues. Nëse i referohemi të dhënave të dala nga ky hulumtim shihet se rrethi patriarkal shihet si faktor i dhunës në familje nga 22.8% e të anketuarve.

Sipas Shpresa Zaplluzhës dhe të dhënave të dala nga hulumtimi “Viktimizimi i Adoloshentëve dhe Shkaqet e Pasigurisë tek Nxënësit e Shkollave të Mesme në Prizren sipas Raportimeve të Nxënësve dhe Mësimdhënësve”, nxënësit dhe mësimdhënësit, dhunën në familje dhe familjen e çorganizuar e shohin si shkaktarin më të shpeshtë për të shpjeguar sjelljet e dhunshme të nxënësve.

Raporti i nxjerrë nga “Manuali për punonjësit e shëndetësisë” tregon se gratë shqiptare të moshës 15-44 vjeç, prej tyre 11.5%, raportuan se kanë qenë dëshmitarë të abuzimit të prindërve të tyre, 27.2% raportuan se kanë qenë abuzuar gjatë fëmijërisë. Në të njëjtin studim, burrat shqiptarë me moshë nga 15-49 raportuan dukshëm nivele të larta për të dy treguesit, në krahasim me femrat. Në tërësi, 47.4% e burrave të intervistuar raportuan se kanë qenë dëshmitarë të dhunës së prindërve, ndërsa 66.8 e burrave raportuan se janë rrahur dhe keqtrajtuar fizikisht gjatë fëmijërisë së tyre (Entela Shehu, Anxhela Gramo “Dhuna me bazë gjinore”, Manual për punonjësit e shëndetësisë). Prevalenca ndërmjet këtyre dy treguesve ishte më e madhe ndërmjet banorëve që dhuna prindërore është identifikuar si nxitës të dhunës në shkollë. Ky korrelacion

është demonstruar ose për modele agresive mes prindërve (Benson & Fox, 2004) ose - edhe më e theksuar - për dhunën e prindërve ndaj fëmijëve të tyre (LOBER & Stouthamer Lober, 1998; Mansel 2001; Straus, 2001) që jetonin në zonat rurale, në krahasim me ata që jetonin në zonat urbane.

Hulumtimet kanë shqyrtuar traditën e ndikimit të nënës në përshtatjen e një fëmije, ndërsa studimet e fundit sugjerojnë se baballarët dhe nënat mund të kontribuojnë, pavarësisht në shpjegimin e disa problemeve të sjelljes së fëmijëve (Veneziano, 2000). Përgjatë kësaj rruge, disa autorë evidentojnë lidhjen e ngushtë dhe marrëdhëniet më pozitive midis babait dhe fëmijës dhe rregullimin psiko - social të adoleshentëve (Rohner & Veneziano, 2001).

Një vlerësim i rrezikut, i kryer për “Raporti botëror mbi dhunën dhe shëndetin”, 2002, tregoi që 8% e djemve dhe 25% e vajzave deri në moshën 18 vjeç përjetojnë ndonjë lloj abuzimi seksual (Dhuna ndaj fëmijëve në shkolla, 2007:9).

Pothuajse në çdo studim theksohet, se nxënësit meshkuj janë më të dhunshme, në krahasim me nxënëset femra (Moller, 2001; Fuchs & Luedtke, 2003, Felix & McMahon, 2007, Luedtke, 2008). Kjo është veçanërisht e vërtetë për dhunë fizike. Në rastin e agresionit verbal dallimi është më i vogël por ende e dukshme.

Gjetjet e studimit “Konstruksionet sociologjike të sjelljes devijante të nxënësve në klasë dhe ndikimi i saj në stresin profesional të mësuesve” i Stela Karaj i dhanë mbështetje hipotezës së ngritur në studim, se në klasë djemtë përfshihen më shumë se vajzat në sjellje devijante (Karaj, 2014:202).

Dallimet gjinore janë evidente në statistikat nga shumë shtete (Smith 2003). Sidomos kur marrim parasysh formën fizike të dhunës, djemtë kanë nivel më të lartë se vajzat. Në përgjithësi djemtë janë fizikisht më të fuqishëm se vajzat e moshës së njëjtë dhe fuqia fizike është një tregues i

rëndësishëm i statusit në grupet e djemve. Megjithatë, nëse përdorim përkufizim më të gjerë të dhunës, ne do të zbulomë se vajzat kanë rezultat më të lartë, relativisht, dhe nganjëherë edhe absolutisht, në matjet e dhunës relacionale, të tilla si përjashtimi social, përhapja e thashethemeve dhe dhuna verbale (Gittins, 2006:14).

Lidhur me dallimet gjinore, disa studime nënvizojnë se djemtë kanë më shumë gjasa të jenë autorë të dhunës në shkollë (Rigby, 2005). Literatura sugjeron se ndonëse djemtë dhe vajzat adoleshente mund të tregojnë dhunë në mënyra të ndryshme, ato priren të jenë reciprokisht të dhunshme ndaj njëri-tjetrit (Foshee, 1996). Adoleshentët femra kanë më shumë gjasa të godasin ose të shtyjnë, ndërsa adoleshentët meshkuj kanë më shumë gjasa të përdorin dhunën për të shkaktuar lëndime serioze siç janë goditjet (Swehn et al., 2000).

Një meta-analizë e fokusuar në programet e parandalimit të dhunës në vitet 1990 deri në vitin 2007, zbuloi se programet më të vogla, si psh., në nivel shkolle, etj. mund të çojnë në ndryshime në njohuritë dhe qëndrimet lidhur me sjelljen e dhunshme (Ting, 2009). Të dhënat ndërkombëtare ofrojnë disa statistika intriguese. Craig et al. (2009) tregoi se rendi i ngacmimeve që shkaktojnë dëmtime, si pjesë e sjelljes agresive, ndryshon midis vendeve, me vlerësime që variojnë nga 8.6 në 45.2% te djemtë dhe nga 4.8 në 35.8% te vajzat. Nga 53.249 pjesëmarrës gjithsej nga adoleshentë të 40 vendeve, 26% prej tyre raportuan se ishin të përfshirë në sjellje ngacmuese me qëllime dëmtimi.

FAKTORËT LIDHUR ME DHUNËN

2.3. Dhuna në familje

Koncepti i dhunës në familje tashmë është konsoliduar si përfshirës i të gjitha llojeve të dhunës. Dhuna në familje shihet si dhunë e ushtruar nga partneri intim apo dhe anëtarë të tjerë të familjes. Në përputhje me përkufizimin e OBSH, dhuna në vendin tonë në shkolla konsiderohet një fenomen shumë shqetësues (UNICEF, 2005).

Nëse i referohemi hulumtimeve për dhunën në familje dhe aktorëve, të cilët e shkaktojnë dhunën në familje, konstatohet se ajo mund të ushtrohet nga personat e rritur ndaj personave të tjerë, siç janë rastet: Dhuna ndaj gruas, dhuna e ushtruar ndaj fëmijëve, që mund të jetë e ushtruar nga nëna, babai, vëllezërit ose motrat më të mëdhenj ose edhe anëtarë të tjerë, si: gjyshi, gjyshja, etj.

Në hulumtimet e kryera në vend, në regjion, madje edhe në nivel global në botë, raportohet se dhuna është prezent si dukuri mjaft shqetësuese. Këtë e arsyetojnë edhe shifrat në përqindje nga OBSH mbi dhunën ndaj gruas, fëmijëve ose edhe anëtarëve të tjerë në familje.

Në një studim të kryer nga Qendra e Trajtimit Multidisiplinor për Problemet e Keqtrajtimit të Fëmijëve (2003), u paraqit situata për fëmijët e moshave 6-12 vjeç dhe 13-18 vjeç, ku u raportua se 11% e fëmijëve kishin pasur ngacmime seksuale dhe 4% e tyre i kishin përjetuar ato në mjedisin familjar; 4% e fëmijëve pranuan përjetimin e dhunës seksuale (Aleanca Gjinore për Zhvillim, 2005).

Hulumtimi i kryer me fëmijët shqiptarë nga Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA) me Qendrën e Informacionit dhe Kërkimeve për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri (IRCCRA), Olof Palme International and Defense for Children International, rezulton se 3% e fëmijëve të dhunuar të strehuar në Strehëzën e Tiranës, janë abuzuar seksualisht, përfshi këtu ngacmimet seksuale nga babai. Thuhet se 100% të fëmijëve të Strehëzës kanë përjetuar dhunë

emocionale, dhune ekonomike, si dhe privim nga të drejtat e tyre (Aleanca Gjinore për Zhvillim, 2005).

Bazuar në studime të besueshme të kryera në vende të ndryshme të botës, 10%-50% e grave raportojnë të kenë përjetuar gjatë jetës dhunë fizike nga partnerët e tyre intime (WHO, 2001). Studime me bazë popullsinë tregojnë se 12%-25% e grave kanë përjetuar, tentuar, ose kryer marrëdhënie seksuale të detyruara nga partnerët e tyre intimë ose nga ish-partnerët e tyre (WHO, 2001).

Nëse i analizojmë këto të dhëna vëmë re se ato flasin për një shqetësim mjaft të rrezikshëm për familjen, si bartësi kryesor i përgjegjësisë mbi edukimin për sjellje sociale të fëmijëve. Gjatë edukimit në fëmijëri është e rëndësishme që fëmijët të edukohen në frymën e demokracisë dhe tolerancës, ku krahas këtij edukimi pritet që në ardhmen ata të formësohen me sjellje sociale ndaj rrethit shoqëror, cilësi këto që do t'i ndihmojnë të krijojnë një shoqëri demokratike. Krahas vlerave pozitive që ka familja, po shihet se ajo në disa raste mund të çalojë në misionin e saj, derisa ia privon të drejtat fëmijëve të saj. Individit që kur lind, fillimin e identitetit të tij dhe më vonë të personalitetit, e nis me familjen, në një lidhje të ngushtë me nënën dhe pastaj me babanë dhe marrëdhëniet midis tyre formojnë një pjesë të personalitetit të individit (Kacollja, 2015:55).

Sa i përket familjeve ekzistuese në Kosovë, kemi disa tipologji, por ndër to duhet vënë theksi i veçantë për familjen patriarkale, që në shoqërinë tonë dominon ende, ku në pozicionin më të lartë familjar, në kuptimin e udhëheqjes së familjes, vendimmarrjes dhe vlerësimit, gjinia mashkullore dhe njeriu më i moshuar është ai që vendos për anëtarët e saj (Zuna & Bashkautorët, 2009:22).

Historikisht në shoqërinë patriarkale ka qenë mbizotërues mashkulli, i cili bënte ligjin në familje dhe në jetën shoqërore në përgjithësi. Djemtë në shoqëritë patriarkale edukohen se si të sillen me vajzat dhe gratë.

Sipas sociologut Zyhdi Dervishi në shoqërinë shqiptare konsiderohet si funksion i rëndësishëm i vëllezërve më të rritur përkujdesja ndaj motrave më të vogla, deri tek e drejta për të ushtruar dhunë ndaj tyre, nëse ato nuk i binden kodit të urdhrave të meshkujve të familjes.

Nëse analizojmë raportet midis gjinisë, atëherë gjinia mashkullore është ajo që ka përparësi në vendimmarrje dhe vlerësim gjatë edukimit të fëmijëve. Prindërit kanë tendenca tolerimi dhe mbivlerësimi ndaj gjinisë mashkullore, herë-herë mjaft skajshëm, ndërkaq edukimi i vajzave është represiv, në frymën e urdhërësive dhe ndalesave të prera (Zuna & Bashkautorët, 2009:22).

Një pjesë e mirë e këtyre arsyeve e kanë origjinën në disa raste në mbeturinat e natyrës patriarkale të shoqërisë shqiptare. Tipari patriarkal e ka favorizuar dhunën në familje, e cila mundëson “burrin e shtëpisë” të dominojë gruan, duke e nënshtruar atë (Miria & Sala, 1999), Dhuna me bazë gjinore 2005:21)

Përderisa dhuna ndaj gruas nis nga statusi i pabarabartë, tipar ky i shoqërisë patriarkale, gjithnjë e më shumë ajo po trajtohet sipas këndvështrimit “gjinor” (Shehu, Gramo, 2003)

2.4. Familja dhe tipologjitë e familjeve në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme

Në të gjitha kulturat familja është faktori kryesor i socializimit të fëmijës, ku më vonë gjatë zhvillimit të fëmijës mund të futen edhe faktorë të tjerë socialë.

Varësisht kulturës dhe vendit edhe familja mund të ndryshojë në edukimin e fëmijëve për një sjellje sociale. Ekzistojnë tipologji të ndryshme të familjeve të krijuara mbi bazën e kriterëve të ndryshme, ku në fokus do të jenë ato familje, të cilat ndikojnë si burim gjenerues i dhunës në shkollë. Edhe më herët është folur për tipin e familjes patriarkale pasi pothuajse një pjesë e madhe e familjeve shqiptare është e kësaj tipologjie. ”Familja patriarkale shquhet për pozitën hierarkie të anëtarëve të familjes, respektivisht me mentalitet të dominimit të prindërve ndaj

fëmijëve, deri tek e drejta për përdorim të dhunës së të rriturve, prindërve ndaj të rinjve, respektivisht edhe fëmijës” (Zuna, 2012:76).

Nëse i referohemi literaturës psiko-pedagogjike mbi ndërtimin e marrëdhënieve në mes të anëtarëve të këtij lloji të familjes, mund të thuhet se karakteristikë e familjes patriarkale është prestigji i meshkujve ndaj femrës, i burrit ndaj gruas, i babait ndaj bijës, i vëllait ndaj motrës (Zuna, 2012:76). E veçantë e familjes patriarkale mund të jetë ajo se fëmijët e gjinisë mashkullore dominojnë mbi gjininë femërore. Kjo tregon ose edhe krijon kushte për shfaqje të sjelljeve të dhunshme ndër brezore por edhe ndaj gjinisë femërore. Është e rëndësishme të nënvizohet se fëmijët qëndrojnë në shkallën më të ulët të hierarkisë familjare tek familjet patriarkale dhe ky raport i subordinuar gjinor e moshor manifestohet në të drejtat dhe obligimet familjare dhe jashtë familjare të gjeneratës së re. Citohej marrëdhëniet e tilla dhe lloji i familjes ngase po vërehen nga hulumtimet se ende dominojnë tipa të familjes patriarkale, derisa të dhënat flasin mbi hierarkinë dhe rolin gjinor në familje.

Studime të shumta nga lëmia e sociologjisë dhe psikologjisë vërtetojnë rolin e madh të familjes, gjegjësisht prindërve në edukimin e fëmijës. Autoriteti dominant vërehet si karakteristikë e familjeve të tilla. Shanset për edukimin e fëmijëve të tyre tregojnë që ata kur të rriten do të modelojnë sjelljet dhe frymën e edukatës që kanë në familje.

Në edukimin e fëmijëve për sjellje sociale rëndësi i kushtohet marrëdhënieve në familje ose edhe atyre në mes të anëtarëve të saj.

Sipas A. Zuna (2003) kushte themelore për formimin e qëndrimit të drejtë të prindërve ndaj fëmijëve janë: stabiliteti i personalitetit të prindërve, marrëdhëniet e shëndosha bashkëshortore, marrëdhëniet e kënaqshme me anëtarët e tjerë të familjes.

Tek familja dhe konteksti socio-kulturor paraqiten si faktor rreziku konflikti në mes të prindërve (Davies & Windle, 2001), normat kulturore lidhur me ashpërsinë e disiplinimit fizik të fëmijëve dhe ekspozimin në këto mënyra (Straus, 1994). Fokus është çdo herë marrëdhënia në mes të anëtarëve të familjes, përkatësisht prindërve në mes veti sepse, në të kundërtën, fëmijët modelohen nga një mosfunksionim i mirë i marrëdhënieve prindërore që dhe tek ai mund të ketë ndikim në aspektin emocional.

2.5. Prindërimi dhe llojet e prindërimit në edukimin e fëmijëve për sjellje sociale

Stilet e përkujdesit prindëror janë tregues edhe të sjelljeve të fëmijëve, ngase sjellja e hershme sociale ndikohet në mënyrë të konsiderueshme nga praktikat e prindërve në rritjen e fëmijëve, duke përfshirë mënyrën sesi prindërit realizojnë zbatimin e rregullave. Nëse i referohemi stileve të prindërimit, krahas shfaqjes së sjelljeve të dhunshme, janë prindërit autoritarë, të cilët janë tepër kërkues dhe ushtrojnë një kontroll të fortë mbi sjelljet e fëmijëve të tyre dhe i detyrojnë të zbatojnë kërkesat e tyre me kërcënime dhe ndëshkime (Vasta, Haith, Miller, 2007:455). Shumica e fëmijëve nuk i mirëpresin këto sjellje, ndaj ata bëhen më agresivë dhe me probleme të sjelljes. Prindërit autoritarë shihen nga qëndrimi i tyre, se ndaj fëmijëve ata ofrojnë pak dashuri dhe shumë kontroll. Ata paraqiten si të ftohtë dhe me kontroll ndaj ndërveprimeve të tyre, por që edhe ndëshkimet janë të rrepta. Ky stil i prindërimit preferon dhe përdor ndëshkimet si mjet edukimi. Meqë komunikimi i këtij stili të prindërimit është në gjuhën e urdhëresave dhe ndalesave, pritët që edukimi i tij të jetë i dhunshëm. Ngase gjatë fëmijërisë qasja dhe mënyra sesi komunikojmë me fëmijët e veçanërisht me adoleshentët është një tregues sesi do të jenë ata në të ardhmen.

Nga hulumtimi i kryer nga Save the Children në Shqipëri në vitin 2007 mbi dhunën ndaj fëmijëve, rezulton se qëndrimet kundrejt dhunës karakterizohen nga besimi i përgjithshëm që “kush të rreh të do”. Kështu, edhe pse kuptohet gjerësisht që dhuna ndaj fëmijëve ka një sërë pasojash negative, ajo shihen edhe si diçka që ka efekte pozitive në edukimin e fëmijës. Ndër faktorët që radhiten se ndikojnë në zhvillimin e problemeve emocionale, vijnë ata që kanë të bëjnë më mjedisin familjar dhe prindërimin. Konfliktet familjare, armiqësia prindërore, mungesa e ngrohtësisë prindërore, kujdesi dhe përkrahja jo adekuate shoqërohen me probleme në fëmijëri dhe adoleshencë (Zahn-Waxler, Klimes-Dougan, & Slaterry, 2000).

Garbiano, Kostelny & Dubrov (1991) raportuan se neglizhimi për fëmijët dhe abuzimi janë studiuar si faktorët e rrezikut për dhunë tek fëmijët, me supozimin se dhuna është shprehje e zemërimit dhe keqtrajtimit.

Prindërve neglizhues, që ofrojnë pak dashuri e pak kontroll, ka shumë të ngjarë që fëmijët e tyre në të ardhmen t’u bëhen të dhunshëm, si shprehje zemërimi ndaj tyre. Raporti i UNICEF-it zbuloi që: “Ky besim është thujtë tërësisht i pranuar si nga ushtruesit e dhunës (prindërit apo mësuesit), ashtu edhe nga vetë fëmijët, viktimat të dhunës”.

“Një raport i kohëve të fundit mbi qëndrimet e prindërve dhe mësuesve, lidhur me ndëshkimin fizik të fëmijëve e vërteton këtë konstatim.

- 27.7% e prindërve dhe 27.9% e mësuesve janë dakord me mendimin që ndëshkimi fizik është pjesë e rritjes dhe edukimit.
 - 74.8% e prindërve dhe 68.5% e mësuesve janë dakord me idenë që fëmijët mësojnë t’i respektojnë prindërit dhe mësuesit nëpërmjet shpullave.
 - 27.6% e prindërve dhe 34.3% e mësuesve mendojnë që trajtimi i ashpër i fëmijëve nga prindërit e tyre i përgatit ata për t’u përballur me situatat e vështira të jetës më vonë.
- ”Save the Children, 2007:20)”

Farrington (1989) gjeti se stili i prindërve autoritarë, mbikëqyrja e dobët e prindërve, disiplina e ashpër ndaj fëmijëve u raportua në dhunë të mëvonshme tek fëmijët. Patterson De Baryshe dhe Ramsey (1989) dhe Patterson et al., (1992) kanë hulumtuar praktikat prindërore në familjet antisociale ku djemtë kanë treguar sjellje të ngjashme me stilin e modelimit në fëmijërinë e hershme.

2.6. Disiplinimi i fëmijëve

Gjatë historisë, por edhe sot në kultura të ndryshme, ndëshkimi fizik ka qenë/është njëra nga mënyrat për disiplinimin dhe edukimin e fëmijëve, si në familje ashtu edhe në shkollë. Shikuar nga konteksti kohor, kjo formë e disiplinimit mbeti si pasojë e edukimit nëpër shoqëritë e ndryshme, nga shoqëritë e para njerëzore, edukimi në Mesjetë që fëmijët konsideroheshin si burra dhe gra të vegjël e, deri sot në kohën më bashkëkohore, ku dhuna shfrytëzohet si mjet për disiplinim të fëmijëve. Ata, të cilët zgjodhën dhunën fizike si mjet edukimi, zgjodhën rrugën e shkatërrimit të fëmijëve të tyre (Zuna, 2008:12), sepse këta fëmijë, kur të rriten do të modelojnë format e tyre të edukimit në fëmijëri, gjë që priren që ata të bëhen abuzues, agresivë, të dhunshëm, apo edhe hakmarrës.

Përdorimi i ndëshkimit trupor si një mjet ndihmës për disiplinimin e fëmijëve pranohet, nga pikëpamja kulturore dhe ligjore, në shumë vende të botës dhe është i përhapur kudo (Dhuna ndaj fëmijëve në Shqipëri, 2007).

Në kulturën e përgjithshme në familjet tona deri më tani, anëtarët e familjes, si forma të disiplinimit kanë përdorur: qortimin, mbjelljen e frikës nëse fëmija gabon, dhunën fizike dhe forma të tjera të dhunës. Literatura nëpër vende të ndryshme të botës tregon se ky fenomen mbi disiplinimin përdoret por kostoja e saj është më e lartë. Këto situata ata fëmijë i shohin dhe i

përrjetojnë, që do të thotë se ata në moshë të re modelojnë dhe më vonë edhe ata vetë do të bëhen dhunues të rinj.

Studime të kryera në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë zbuluar se 90% e të gjithë fëmijëve ndëshkohen fizikisht (“Fëmijët dhe dhuna“, Innocenti Digest, nr. 2, UNICEF, p. 6.).

Janë shumë subjekte, të cilët i nënshtrohen hulumtimeve të ndryshme, duke filluar nga gjyshi, gjyshja, nëna, babai, vëllezërit apo edhe motrat më të mëdha. Ata potencojnë se fëmijët dhunohen “sepse u bën mirë”. Diskutimet e thelluara zbuluan se abuzimi emocional dhe psikologjik shihen si format më të shpeshta dhe më të pranueshme të dhunës në familje, pasi pasojat e tyre janë më pak të dukshme. Dhuna në familje ndaj fëmijëve (e bërtitura, përdorimi i nofkave, shpullat, tërheqja e veshit, kërcënimet, etj.) konsiderohet përgjithësisht e pranueshme, duke argumentuar se kjo është në të mirë të fëmijës dhe edukuese për të.

<http://poradeci.com/porta/Portals/0/nositi/pdf/Edicion491.pmd.pdf>).

Nga hulumtimi i INSTAT –it, ” Dhuna në Familje në Shqipëri”(2013), rezulton se nga 991 fëmijë të anketuar, 57,7% raportuan se ishin rrahur fizikisht nga një anëtar i familjes dhe disa fëmijë kishin përjetuar njëkohësisht forma të ndryshme të dhunës fizike. Kishte disa ndryshime të theksuara në eksperiencat me dhunën në familje, bazuar në gjininë (djemtë kundrejt vajzave) dhe moshën. Gjithashtu, kishte ndryshime të theksuara, bazuar në ndarjen midis zonave urbane dhe rurale.

Statistikat flasin për një shkallë të lartë të dhunës që përdoret si formë disiplinimi, gjë që dëshmon se fëmijët shpesh dhunohen fizikisht nga prindërit e tyre, megjithatë, motrat dhe vëllezërit, gjyshërit dhe të afërm të tjerë mund të jenë, gjithashtu, dhunues. 45,1% e fëmijëve raportuan se ishin dhunuar fizikisht nga nëna/njerka e tyre, 29,3% ishin dhunuar nga babai/njerku i tyre dhe 24,4% ishin dhunuar nga motra dhe/ose vëllai i tyre. Është e rëndësishme të theksohet

se djemtë, në mënyrë të theksuar, kishin më shumë gjasa se sa vajzat që të dhunoheshin fizikisht nga babai/njerku; ndërsa vajzat kishin në mënyrë të theksuar më shumë gjasa sesa djemtë që të dhunoheshin fizikisht nga vëllai dhe/ose motra e tyre. Djemtë dhe vajzat kishin të njëjtat gjasa që të dhunoheshin fizikisht nga nëna/njerka e tyre.

Të dhënat flasin për rezultate të vërteta, që ndër brezash familjet shqiptare, formën e disiplinimit e konsiderojnë se vetëm atyre iu takon dhe se qëndrojnë në rregull me ligjin. Nëse i referohemi të drejtave të fëmijëve dhe ligjeve të fuqi, dhuna dënohet ashpër dhe përdorimi i saj sanksionohet me burg. Meqë në mënyrë tipike fëmijët kanë status të vogël brenda familjeve dhe dhuna fizike shpesh përdoret si një mjet disiplinimi për fëmijët, ata hezitojnë të flasin rreth dhunës në familje sepse, në të kundërtën, ata mund ta humbin përkujdesin prindëror. INSTAT (2013), raporton se një përqindje e konsiderueshme e fëmijëve kishin kërkuar ndihmë nga dikush për dhunën që ata përjetonin në familje. Shumica e fëmijëve kërkonin ndihmë nga një anëtar i familjes. Rrallëherë një fëmijë i ka treguar dikujt jashtë familjes së tyre rreth abuzimit ose dhunës. Gjithashtu, kishte ndryshime të theksuara ndërmjet djemve dhe vajzave dhe fëmijëve në zonat urbane dhe rurale dhe sjelljes në kërkimin e ndihmës. Së fundmi, vetëm 17,4% e fëmijëve raportuan se ishin të vetëdijshëm për dhunën në familje ndërmjet prindërve të tyre (INSTAT, 2013:60).

Disiplinimi dhe dënimi janë mënyrat më tradicionale në përballjen me sjelljen jo të dëshirueshme të fëmijët. Problematike me këto mënyra është se edhe vetë ata janë të dhunshëm dhe i bashkëngjiten rrethit: dhuna çdo herë lind dhunë (UNICEF 2008-2009:16, Studim për gjendjen initiale me dhunën në shkollat fillore në Maqedoni).

West dhe Farrington (1997) kanë gjetur se fëmijët e familjeve, të cilët kalojnë një kohë të gjatë të kohës së lirë me fëmijët e tyre, kanë më pak gjasa dhe rrezik më të ulët të shfaqjes së sjelljeve të dhunshme. Meqë ne e dimë se fëmijët mund të bëhen shpeshherë agresivë për shkak të pengesave dhe situatave frustuese që mund t'u ndodhin në familje, andaj meqë ai nuk mund t ia

kthejë të njëjtën sjellje, për shembull prindit ,i cili mund të sillet dhunshëm, ai reagimin e tij e drejton ndaj dikujt tjetër (Orhani, 2011:76).

Fëmijët që rriten në ambiente të dhunshme janë të prirë t'i kthehen dhunës, si metodë për zgjidhjen e problemeve, kur të arrijnë moshën madhore (UNWOMEN, 2011).

2.7. Dhuna ndaj fëmijëve në familje

Sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (1989), “fëmijë” konsiderohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç. (Shehu, Gramoz).

Nga studimi i faktorëve kulturorë, socialë, ekonomikë dhe personalë rezulton që familjet shqiptare janë të rrezikuara nga dhuna, gjë që në këtë rast më së rëndi e përjetojnë fëmijët në familje.

Mungesa e përkrahjes sociale dhe rrethanat familjare të pakëndshme, janë gjetur si faktorë kontekstualë, të lidhur me zhvillimin dhe përkrahjen e problemeve emocionale tek fëmijët dhe adoleshentët (Essox, Klein, Cho & Kraemer, 2003; Leech, Larkby Day, 2006; Ge, Natsuaki, & Conger, 2006; Shiner & Marmorstein,1998; Silberg.,1999).

Praktika të shumta tregojnë për një gjendje të tillë, saqë pothuajse çdo ditë nëpër mediat tona ofrohen fakte dhe imazhe dhune ndaj familjes e në veçanti ndaj fëmijëve.

Shumë njerëz mund të nxjerrin në pah ndjenjat e tyre agresive, ndoshta për shkaqe individuale “ *Që kanë të bëjnë me karakteristika dhe probleme të personalitetit, si: varësia emocionale; papjekuria; kontrolli i dobët i vetes; ndjenja e inferioritetit; xhelozia; impotenca seksuale; konkurrenca intelektuale, profesionale dhe arsimore; mungesa e apatisë; vështirësi në mbajtjen e përgjegjësisë për veten; etj;*” (Aleanca Gjinore për Zhvillim, 2008: 22).

Gjithashtu, për disa njerëz, dhuna kthehet në një mënyrë për të fituar fuqi dhe kontroll mbi anëtarët e tjerë të familjes. Për ta kjo mënyrë funksionon, prandaj dhe vazhdojnë të sillen në mënyrë të dhunshme. Stresi, shqetësimet në punë, paaftësia profesionale, problemet ekonomike,

marrëdhëniet problematike, shtatzënia e padëshiruar, mund të bëjnë që një person të ndjehet i tej ngarkuar nga ana emocionale dhe, kështu, mund të shpërthejë në sjellje të dhunshme. Abuzimi me alkoolin dhe drogën ndihmon në përkeqësimin e situatës. Gjithashtu, mund të përmendim të tjerë faktorë stresantë që ndikojnë në shtimin e dhunës në familje, si: numrin e madh të fëmijëve; bashkëjetesën në familje me disa kurora, ndërhyrjet në jetën e çiftit, prindërimi i vetëm, kufizimet në mundësitë për një jetë normale, sëmundje të zgjatura apo kronike, vdekja e ndonjë personi të afërt, etj. (Aleanca Gjimore për Zhvillim, 2008:22).

Studimet kanë treguar se shumë njerëz mësojnë të sillen në mënyrë të dhunshme me pjesëtarët e familjes gjatë rritjes së tyre, ndaj atyre ushtrohet dhunë, kështu që kur të rriten ata do të bëhen edhe vetë dhunues. Për shembull, fëmijët e abuzuar kur rriten, mund të manifestojnë dhunë ndaj bashkëmoshatarëve, shokëve dhe shoqeve, por edhe familjes. Në shoqërinë shqiptare, e kaluara e dhunshme e familjeve është një nga faktorët kryesore që ndikon në lindjen dhe shtimin e sjelljeve të dhunshme brenda familjeve të reja. Studimet e pakta shkencore në Shqipëri mbi dhunën ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve tregojnë se “Format më të shpeshta të dhunës fizike në shtëpi dhe në shkollë janë ato me goditje dhe, përkatësisht: një në dy fëmijë goditen në kokë e trup në shtëpi, ndërsa një në tre goditen edhe në shkollë. Kjo do të thotë se në shtëpi fëmijët përjetojnë më shumë akte të dhunës fizike sesa në shkollë (TAMO, KARAJ, 2006).

Të dhënat e dala nga Aleanca Gjimore për Zhvillim nxorën në pah shumë fakte që tregojnë shanse për rritjen e dhunës në familje. Me komunikimin nëpërmjet internetit, si dhe shfrytëzimin e tij në shoqërinë e sotme, shumë njerëz vuajnë pasojat e një izolimi social, pra humbin kontaktin emotiv me familjen dhe miqtë, të cilët janë burimet kryesore të mbështetjes emocionale për të cilën gjithkush nga ne ka nevojë. Këta njerëz mund të ndihen të vetmuar, pa ditur kujt t’i drejtohen për ndihmë dhe kjo mund të çojë në sjellje të dhunshme brenda familjes. Shoqëria e konsideron dhunën në përgjithësi edhe si reflektohet nga media, varfëria dhe papunësia, pabarazitë gjimore,

niveli i lartë i stresit, humbja e besimit në institucionet shtetërore, vështirësitë në zbatimin e ligjit mbi dhunën në familje, modelimi i sjelljeve agresive që shfaqen në sferën politike, mungesa e shërbimeve në mbështetje të familjeve, paqëndrueshmëria politike dhe ekonomike, varfëria, etj., janë faktorë që ndikojnë në shtimin e dhunës (Aleanca Gjinore për Zhvillim”, 2008:22).

Përveç kësaj, shpeshherë dhuna ndaj fëmijëve ushtrohet nga prindërit, motrat ose vëllezërit e mëdhenj dhe të afërm të tjerë më të mëdhenj, që kanë pushtet dhe kontroll mbi fëmijët më të vegjël.

Sipas teorisë së dhunës në familje, familja shihet si një arenë ku sjellja e dhunshme mësohet dhe transmetohet nëpër breza. (INSTAT, 2013:61)

Të dhënat nga INSTAT tregojnë se dhuna fizike ose ndëshkimi trupor përdoret shpesh për të kontrolluar dhe për të disiplinuar fëmijët; kështu që goditja me shuplakë, të gjuajturit dhe rrahja e fëmijës zakonisht nuk konsiderohet një formë dhune ndaj fëmijëve (INSTAT, 2013:55)

Garbiano, Kostelny & Dubrov (1991) raportuan se neglizhimi për fëmijët dhe abuzimi janë studiuar si faktorët e rrezikut për dhunë tek fëmijët, me supozimin se dhuna është shprehje e zemërimit dhe keqtrajtimit.

Fëmijët që janë dëshmitarë të dhunës në shtëpitë e tyre mund të kenë vështirësi serioze emocionale, zhvilluese edhe në sjellje. Për shembull, ka më shumë mundësi që ata të bëhen adoleshentë dhe të rritur emocionalisht të paqëndrueshëm, agresivë dhe të dhunshëm (Manual, OSCE, 2013)

Dhuna kundër fëmijëve në kulturën shqiptare shihet si një mjet për disiplinimin e tyre, përdorimi i formave të lehta dhe të moderuara të dhunës trupore dhe psikologjike është mjaft i përhapur. Shumë fëmijë u nënshtrohen formave të ashpra dhe degraduese të dhunës dhe të poshtërimit, si:

rrahja, incesti, abuzimi seksual, braktisja, shitja e fëmijëve për shfrytëzim dhe prostitucion, krime nderi e deri tek abortet selektive (Qendra Kombëtare për Studime Sociale, 2011).

2.8. Dhuna ndaj adoleshentëve në familje

Mosha e adoleshencës ka një potencial të madh për sjellje problematike në krahasim me periudhat e tjera të zhvillimit në çdo kulturë dhe në çdo kohë” (Arnet, 1992:339).

Në të shumtën e rasteve prindërit adoleshencën e paraqesin si rebelim të fëmijëve. Ka prindër që nuk kanë shume informacione mbi karakteristikat e kësaj periudhe të zhvillimit, e cila përcillet me ndryshime fizike, sociale dhe psikike. Sipas A. Zuna (2008), prindërit që nuk kanë informacione të shumta në lidhje me ndryshimet që ndodhin, mund ta pengojnë, gjykojnë dhe ndëshkojnë fëmijën në këtë fazë nga tendenca e mëvetësisë në vendimmarrje, dëshirave, imponojnë stilin e veshjes, ndrydhin interesat e tyre, imponojnë shokët dhe shoqet me kë të qëndrojnë, e shumë të tjera.

Supozohet se ndër shkaqet që çojnë deri tek dhuna ndaj adoleshentëve janë:

”Mosnjohje e ligjësive të zhvillimit të fëmijës, mungesa e kureshtjes pedagogjike të prindërve, mungesa e gatishmërisë së prindërve për t’i respektuar tiparet e kësaj moshe, personaliteti autoritar i prindërve, paragjykimi për gjeneratat dhe gjinitë, ku prindi i përcakton kahet e zhvillimit të fëmijës” (Zuna .A , 2008:78).

Në këtë moshë fëmijët mund të bëhen të dhunshëm ose edhe të ushtrohet dhunë nga familja mbi ta. (tek adoleshentët) Nga mos njohja e ligjësive të zhvillimit, mund të ketë pasoja, kështu raportet mund të jenë të çrregullta me prindërit, fëmija mund ta humbasë besimin te ta, fëmija ndihet i frustruar, i frikësuar, rebelohet ose edhe bëhet i dhunshëm në rrethin social (Zuna, 2008:79). Fëmijët e konceptojnë dhunën si të vetmen rrugë për të arritur atë që dëshirojnë dhe për të mbizotëruar apo fituar mbi të tjerët (Nositi-Enti botues Dija-Pogradeci, parë Nëntor, 2012).

Në shumicën e rasteve shkaqet e dhunës janë një kombinim në mes të faktorëve që lidhen me familjen, komunitetin dhe institucionin arsimor. Në shoqërinë rumune në fazën e adoleshencës rastet e sjelljeve të dhunshme rriten tri deri katër herë më shumë, në krahasim me moshat e tjera (Carmen Palaghia, 2013 fq. 47).

Shumë adoleshentë të dhunuar se që kanë jetuar në familje të dhunshme, kanë tendenca të ushtrojnë dhunë në marrëdhëniet e ardhshme me partnerin/en dhe njerëzit përreth (Aleanca për Zhvillim Gjinor, 2005).

Ka shumë studime, të cilat analizojnë lidhjen midis variableve familjare dhe sjelljes së dhunshme në shkollë. Ato nënvizojnë se një mjedis negativ familjar i karakterizuar nga problemet e komunikimit ndërmjet prindërve dhe fëmijëve është një rrezik i rëndësishëm, faktor për zhvillimin e problemeve të sjelljes në adoleshencë (Estevez, Musitu, & Herrero, 2005a). Lidhur me komunikimin me prindërit, studime të tjera theksojnë se cilësia e komunikimit është e lidhur ngushtë me sjelljen e adoleshentëve dhe përshtatjen psikologjike (Liu, 2003); Në veçanti, komunikimi negativ dhe fyes me prindërit mund të çojë në keqpërdorime në fëmijë (Lambert & Cashëell, 2003). Një ndryshore tjetër është vetë-koncepti i familjes. Një koncept negativ i familjes, i cili, për më tepër, është i lidhur fort me një stil komunikimi negativ të prindërve dhe adoleshentëve (Musitu & Cava, 2001, Musitu & Garcia, 2004), është lidhur me dhunën në adoleshencë (Estevez, Herrero, Martinez, Musitu, 2006).

2.9. Marrëdhëniet në familje shans i rritjes së sjelljeve të dhunshme në shkolla

Nga një hulumtim i kryer në Kenia, studiuesit nxorën, se ndër faktorët kryesorë që gjenerojnë pasoja, të perceptuar në shtëpi janë: Lidhja e dobët në mes të prindërve dhe fëmijëve, mënyra jo e përshtatshme e disiplinimit të fëmijëve në shtëpi, prindër të dhunshëm, ekspozim ndaj filmave të dhunshme dhe niveli i ulët i mbikëqyrjes në shtëpi (Moses Wesang'ula Poipoi; John O. Agak and Eric K. Kabuka, 2011).

Faktorët që krijojnë kushte për një adoleshencë të dhunshme janë të shumtë, por sipas A. Zuna (2008), ndër arsyetimet teorike më të rëndësishmet, janë: Familja e shthurur, marrëdhëniet e tendosura familjare, terapia jo përkatëse familjare gjatë manifestimit fillestar të agresivitetit të adoleshentëve, gjeneralizimi i marrëdhënieve të dhunshme në të gjitha relacionet familjare, pra edhe në relacionin adoleshent-prind.

Mungesa e komunikimit në familje për probleme të ndryshme që shqetësojnë adoleshentët në ditët e sotme bëhet burim i gjenerimit të dhunës në ambientet e shkollës dhe jashtë saj. Psikologët sqarojnë se dhe kur ndodh që situatat e tensionit ndërmjet nxënësve identifikohen në kohë dhe referohen nga mësuesit apo shokët e klasës, janë prindërit ata të cilët përpiqen të justifikojnë veprimet e fëmijëve të tyre. Nxënësit e shkollave, duke mos pranuar fenomenin të vetja thonë se shpesh herë kanë qenë dëshmitarë të rasteve kur janë fyer e rrahur bashkëmoshatarët e tyre (RTSH - Radio Televizioni Shqiptar 2017 - Dhuna në shkolla - Rezultat i mos komunikimit në familje, parë 24 Janar 2017)

Dhuna në familje dhe ndaj fëmijëve e vë brezin e ri në një rrezik të madh për t'u përfshirë në sjellje kriminele dhe traumatike dhe rezulton në një ulje të mundësive për të pasur një jetë normale brenda familjes dhe në komunitet (Aleanca Gjimore për Zhvillim, 2005:18).

2.10. Modelet e përshkallëzimit të dhunës në familje

Dhuna në familje mund të ndikojë që marrëdhëniet të jenë edhe më të acaruar ndërmjet anëtarëve në familje. Të ndikuar nga disiplina e ashpër dhe dhuna në familje, fëmijët mund të ushtrojnë edhe vetë dhunë në ambiente të tjera, ngase modeli me të cilën janë arritur qëllimet është mësuar në të njëjtën mënyrë. Dhuna zakonisht mund të zhvillohet në formë cikli. Herë pas here krijohen situata dhune në familje e, po ashtu, viktima të dhunës mund të jenë po të njëjtit anëtarë në familje. Strauss (1980), i cili pohoi se stili autoritar i disiplinës familjare mund të rezultojë që fëmija të bëhet armiqësor dhe agresiv. Ai vërejt se fëmijët, të cilët janë rritur në një mjedis me disiplinë të ashpër zhvillohen si njerëz të ashpër dhe përsërisin modelin e sjelljes që hasin në familje.

Disiplina e ashpër konsiderohet si faktor madhor në zhvillimin e sjelljeve devijante në adoleshencë (Glueck & Glueck, 1950; Patterson, Reid, & Dishion, 1992; Farrington & Hawkins, 1991; Mc Cord, 1991).

2.11. Faktorët e rrezikut që mund t'i kontribuojnë dhunës në familje

Sipas Armen Mustafës (2015) dhe raportimit të të dhënave nga KOMF “Mos ma mbyll derën, jam vetëm një fëmijë” raportet e çrregulluara në familje, dhuna në familje, divorcet në familje, familjet me njërin prind, por edhe mungesa e përkujdesit dhe shkathtësive prindërore, si dhe kushtet ekonomiko-sociale të familjeve shihen si faktorët kyç që qëndrojnë prapa fëmijëve në rrezik për të rënë në konflikt me ligjin ose në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale.

Më poshtë po rendisim disa faktorë të tjerë që mund ndikojnë në dhunën në familje dhe mund të klasifikohen në:

Faktorë të nivelit makro, ku përfshihen: ndikimi i kulturës, ekonomisë, politikës, lëvizjet e mëdha demografike, etj.

Faktorë të nivelit mikro (familjar ose mikro), ku mund të përfshihen: marrëdhëniet në familje, modelet me të cilat janë rritur, edukata e familjes, mënyra e rritjes së fëmijëve, etj.

Faktorë të nivelit personal, ku mund të përmendim: problemet e shëndetit mendor të individit, abuzimin me alkoolin, drogën, streset, nivelin kulturor, çrregullimet e ndryshme të personalitetit, përvojat personale në marrëdhëniet familjare, etj. (DHUNA NË FAMILJE, 2008)

Në nivelin familjar është statusi jo i favorshëm social-ekonomik, i bazuar në të ardhurat e pakta financiare, profesioni dhe edukimi i mangët i prindërve, që gjenden si faktorë të fuqishëm dhe të qëndrueshëm të rrezikut për problemet në sjellje e, më vonë, në fëmijëri dhe adoleshencë (Bradley & Corwyn, 2002).

2.12. Faktorët që ndikojnë në rritjen e dhunës në shkolla

Për t'ju shmangur sjelljeve të dhunshme dhe formave të ndryshme të devijimit, nxënësit duhet të edukohen brenda familjes në frymën e përgjegjësisë (Carmen Palaghia, 2013:53). Ka një numër studimesh (Mayer dhe Leone, 2007, Osher dhe të tjerë, 2004, 2006) që kanë treguar se dhuna është për shkak të një numri të faktorëve të rrezikut dhe proceseve sociale, si në aspektin individual, familjar, shkollor dhe kombëtar. Hulumtimet tregojnë se prania e dhunës në shkolla pengon ndjeshëm mësimin dhe edukimin (Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, 2004). Me arsyetim të ngjashëm supozojmë se përqindja e nxënësve në një klasë, që kanë përjetuar dhunë fizike nga prindërit e tyre ka një ndikim të rëndësishëm në dhunën individuale. Bazuar në teorinë e social-mësuarit ka qenë e dokumentuar se nxënësit që janë abuzuar dhunshëm nga prindërit e tyre kanë më shumë gjasa për të vepruar edhe vetë dhunshëm - sidomos kur nxënësit e tjerë iniciojnë provokime të dhunës të nivelit të ulët. Për shkak se kanë mësuar se sjellja agresive është një strategji legjitime për zgjidhjen e konfliktit, ata kanë më

shumë gjasa që të reagojnë me dhunë në përgjigje të nxënësve të tjerë, që tregojnë sjellje provokuese (FUCHS M, 2008:27).

Fëmijët që janë dëshmitarë të dhunës në shtëpinë e tyre shpesh vuajnë nga probleme fizike, shoqërore dhe zhvillimore (Dhuna në familje në Shqipëri, 2013).

Dhuna në shkolla kryesisht ka marrë vëmendje të konsiderueshme gjatë viteve të fundit. Shkollat, gjithashtu, janë identifikuar si vende kyçe për shpërndarjen e programeve të parandalimit të dhunës (Farrell, et al., 2001) dhe në fakt ka mbi 200 vlerësime të dokumentuara të këtyre programeve (Wilson, Lipsey & Derzon, 2003). Sidoqoftë, rishikimet meta-analitike të programeve të bazuara në shkolla për të parandaluar agresionin kanë vërejtur që nuk janë në përputhje me efektet e moderuara pozitive (Wilson et al., 2003).

KAPITULLI III

3.METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Hyrje

Ky kapitull prezanton një përshkrim të metodologjisë së përdorur në studim. Në kuadër të këtij kapitulli është përfshirë dizajni i hulumtimit, popullata dhe mostrat e hulumtimit, instrumentet e përdorura në hulumtim, procesi i mbledhjes së të dhënave, procesi i analizës së të dhënave si dhe aspekti etik.

Hulumtimi është kuantitativ dhe ka shfrytëzuar të dhënat sasiore të fituara nga tre pyetësorë për prindër, mësimdhënës dhe nxënës për ndikimin e faktorëve familjarë tek nxënësit që shfaqin sjellje të dhunshme në shkollë.

3.1.Dizajni i hulumtimit

Në punimin tonë përdorëm metoda sasiore. Arsyeja qëndron se në hulumtim kemi për njësi të kampionit nxënës, mësimdhënës dhe prindër.

Hulumtimi sasior – Si metodë kryesore të hulumtimit kemi përdorur metodën e hulumtimit sasior. Kemi përdorur këtë metodë me qëllim marrjen e perceptimeve dhe informacioneve nga mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit në lidhje me ndikimin e faktorëve familjarë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme në shkollë.

Megjithatë qëllimi i hulumtimit ishte vlerësimi i perceptimit të respondentëve rreth ndikimit të faktorëve familjarë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme të nxënësve në shkollë si dhe hulumtimi i faktorëve të tillë, si: mosha, gjinia, arsimimi i prindërve, punësimi i prindërve, numri i anëtarëve në familje, vendbanimi, që janë të rëndësishëm për të vlerësuar ndikimin e tyre për këtë studim.

Hulumtimi është dizajnuar në mënyrë që të vlerësojë ndikimin e faktorëve familjarë me qasje kuantitative, ku synohet që përmes opinionit/perceptimeve të nxënësve, mësimitdhënësve dhe prindërve të gjendet ndikimi i faktorëve familjarë që mund të rrisin shanset për sjellje të dhunshme, duke krahasuar nxënësit sipas moshës, gjinisë dhe vendit rural-urban në shkollat e Prishtinës dhe rrethinës. Sikundër përmendëm më lart janë përdorur tre pyetësorë, duke përfshirë nxënësit, prindërit dhe mësimitdhënësit për mbledhjen e të dhënave. Përmes opinionit të tyre janë nxjerrë të dhëna të rëndësishme për të bërë analiza dhe diskutime. Pyetësorët u përzgjedhën për të matur perceptimet e respondentëve, sepse dukuria është delikate, ngase ajo është e ndjeshme meqë flitet për faktorët familjarë dhe ndikimin e tyre. Prandaj është e vështirë që respondentët të japin opinione rreth familjes së tyre. Përmes këtyre pyetësorëve u është kërkuar vetëm të paraqesin opinionin e tyre, pa prekur privatësinë e tyre familjare.

3.2.Popullata dhe mostrat e hulumtimit

Popullata e këtij hulumtimi përfshin nxënësit e klasave të teta dhe të nënta në Komunën e Prishtinës në vitin shkollor 2013/2014; mësimitdhënësit dhe prindërit nga të cilat janë mbledhur të dhënat për analizë të mëtejme. Në hulumtim janë përfshirë nxënësit e klasave të teta dhe të nënta të tetë shkollave të mesme të ulëta të komunës së Prishtinës.

Për hulumtimin tonë është zgjedhur mostra e rastësishme. Kjo popullatë është numerikisht e caktuar, ku sipas të dhënave nga MASHT (2013), në këtë vit shkollor në klasat e teta dhe të nënta ishin të regjistruar 6818 nxënës.

Kampionimi është i përbërë nga tri kategoritë: Prindërit, mësimitdhënësit dhe nxënësit me arsyen se të gjithë këta e plotësojnë pjesën e hulumtimit, pasi janë aktorë të rëndësishëm për të dhënë opinionin se si e perceptojnë ndikimin e faktorëve familjarë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek nxënësit.

Numri i pjesëmarrësve në hulumtim është 497 nxënës, nga të cilët 245 ose 49.3% ishin të gjinisë femërore dhe 252 ose 50.7% e tyre i takonin gjinisë mashkullore. Mbështetur ne “The Research Advisors”(2006), kjo mostër ka një interval besimi 95%, me kufij të gabimit 0.05%.

Të dhënat për nxënësit pjesëmarrës në hulumtim sipas gjinisë, moshës, vendbanimit janë paraqitur në tabelën e mëposhtme

3.3.Analiza përshkruese

Prezantimi i të dhënave për nxënësit pjesëmarrës në hulumtim

Tabela 1

Të dhënat sipas gjinisë, moshës dhe vendbanimit për nxënësit

		<i>N</i>	<i>%</i>
Numri i nxënësve	Femra	245	49.3
	Meshkuj	252	50.7
	Gjithsej	497	100
Grup mosha	13 vjeç	150	30.2
	14 vjeç	231	46.5
	15 vjeç	116	23.3
Vendbanimi	Qytet	330	66.4
	Fshat	167	33.6

Në përputhje me pyetjen kërkimore dhe hipotezat e hulumtimit, për gjininë, moshën dhe vendbanimin u zhvillua testi i hi-katrorit. Vlerat e fituara përmes testit *chi-square*, $\chi^2(1)=.099$, $p=.754$, treguan që nuk ka dallime të vlefshme statistikore ndërmjet djemve dhe vajzave pjesëmarrës në hulumtim. Për moshën, vlerat e fituara të *chi-square*, $\chi^2(2)=42.137$, $p=.000$, treguan dallime të vlefshme statistikore në numrin e nxënësve 13, 14 dhe 15 vjeçarë.

Dallime të vlefshme statistikore kemi edhe për vendbanimin [$\chi^2(1)=53.459, p=.000$].

Tabela 2

Të dhënat për familjet e nxënësve

		<i>N</i>	<i>%</i>
Numri i anëtarëve në familje	3 anëtarë	60	12.1
	4-6 anëtarë	347	69.8
	Më shumë se 6 anëtarë	90	18.1
Prindërit jetojnë	Së bashku	466	93.8
	Të ndarë	31	6.2
Punësimi i nënës	Në punë	401	80.7
	Pa punë	96	19.3
Punësimi i babait	Në punë	214	43.1
	Pa punë	283	56.9

Tabela 3

Niveli i arsimimit të prindërve sipas nxënësve

		<i>N</i>	<i>%</i>
Niveli i arsimimit të nënës	Shkollë Filllore	62	12.5
	Shkollë e mesme	197	39.6
	ShLP	30	6.0
	Fakultet	144	29.0
	Magjistraturë	45	9.1

Niveli i arsimit të babait	Doktoraturë	19	3.8
	Shkollë Fillore	103	20.7
	Shkollë e mesme	203	40.8
	ShLP	44	8.9
	Fakultet	100	20.1
	Magjistraturë	31	6.2
	Doktoraturë	16	3.2

Tabela 4

Të dhënat për numrin e nxënësve në klasë, numrin e nxënësve të shkëlqyer dhe të dobët

				<i>N</i>	<i>%</i>
Numri i nxënësve në klasë	Deri në 25 nxënës			122	24.5
	Prej 25-30 nxënës			127	25.6
	Mbi 30 nxënës			248	49.9
Numri i nxënësve të shkëlqyer	1-5 nxënës			79	15.9
	6-10 nxënës			204	41.0
	11-15 nxënës			134	27.0
	16-20 nxënës			49	9.9
	Mbi 20 nxënës			31	6.2
Numri i nxënësve të dobët	1-5 nxënës			257	51.7

6-10 nxënës	132	26.6
11-15 nxënës	53	10.7
16-20 nxënës	26	5.2
Mbi 20 nxënës	29	5.8

Tabela 5

Të dhënat për kohën e kaluar në familje, me shoqëri, duke parë TV dhe në Internet

		<i>N</i>	<i>%</i>
Koha e kaluar me familjen në ditë	Më pak se një orë	34	6.8
	2-3 orë në ditë	64	12.9
	Më shumë se 3 orë në ditë	311	62.6
	Nuk e di	88	17.7
Koha e kaluar me shokë/ shoqe jashtë mësimit	Më pak se një orë	201	40.4
	2-3 orë në ditë	141	28.4
	Më shumë se 3 në ditë	70	14.1
	Nuk e di	85	17.1
Koha e kaluar duke parë TV	Më pak se një orë	137	27.6
	2-3 orë në ditë	206	41.4
	Më shumë se 3 në ditë	88	17.7
	Nuk e di	66	13.3
Koha e kaluar në internet në ditë	Më pak se një orë	161	32.4

2-3 orë në ditë	173	34.8
Më shumë se 3 në ditë	93	18.7
Nuk e di	70	14.1

Popullata e mësimdhënësve përbëhet nga gjithsej 1649 mësimdhënës, që japin mësim në shkollat e përzgjedhura në hulumtimin tonë. Nga numri i përgjithshëm i mësimdhënësve, janë përzgjedhur për të qenë pjesë e këtij hulumtimi 112 mësimdhënës, nga të cilët 73 ose 65.2% ishin të gjinisë femërore dhe 39 ose 34.8% prej tyre i takonin gjinisë mashkullore. Mbështetur në “The Research Advisors” (2006), mostra jonë e mësimdhënësve ka një interval të besimit 95% me kufij të gabimit 0.05%.

Karakteristikat e mësimdhënësve pjesëmarrës në hulumtim sipas gjinisë, vendbanimit, nivelit të arsimimit dhe moshës janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Prezantimi i të dhënave për mësimdhënësit pjesëmarrës në hulumtim

Tabela 6

Të dhënat sipas gjinisë, moshës dhe vendbanimit për mësimdhënësit

		<i>N</i>	<i>%</i>
Numri i mësimdhënësve	Femra	73	65.2
	Meshkuj	39	34.8
	Gjithsej	112	100
Vendbanimi	Qytet	74	66.1
	Fshat	38	33.9
Niveli i arsimimit	ShLP	23	20.5
	Fakultet	76	67.9

	Magjistraturë	12	10.7
	Doktoraturë	1	0.9
Mosha mesatare e mësimdhënësve		MA	DS
	Femra	43.67	11.87
	Meshkuj	45.56	11.84
	Gjithsej	44.33	11.84
Numri mesatar i nxënësve në shkollat e mësimdhënësve		1110	55.62

Edhe për pjesëmarrësit mësimdhënës në hulumtim, në përputhje me pyetjen kërkimore dhe hipotezat e hulumtimit, për gjininë, moshën dhe vendbanimin u zhvillua testi i hi-katrorit. Vlerat e fituara përmes testit *chi-square*, treguan që ka dallime të vlefshme statistikore ndërmjet mësimdhënësve femra dhe meshkuj [$\chi^2(1)=11.571, p=.000$], si edhe për nivelin e shkollimit [$\chi^2(3)=114.643, p=.000$], dhe vendbanimin [$\chi^2(1)=11.571, p=.000$].

Popullata e prindërve përbëhet nga gjithsej 6818 prindër në shkollat e përzgjedhura në hulumtimin tonë. Nga numri i përgjithshëm i prindërve, janë përzgjedhur për të qenë pjesë e këtij hulumtimi 365 prej tyre, nga të cilët 158 ose 43.3% ishin të gjinisë femërore dhe 207 ose 56.7 %, prej tyre i takonin gjinisë mashkullore.

Mbështetur në “The Research Advisors” (2006), mostra jonë e prindërve ka një interval të besimit 95% me kufij të gabimit 0.05%.

Karakteristikat e prindërve pjesëmarrës në hulumtim sipas gjinisë, vendbanimit, nivelit të arsimimit, moshës, punësimit dhe numrit të anëtarëve në familje janë paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Prezantimi i të dhënave për prindërit pjesëmarrës në hulumtim

Tabela 7

Të dhënat sipas gjinisë, moshës dhe vendbanimit për prindërit

		<i>N</i>	<i>%</i>
Numri i prindërve	Femra	158	43.3
	Meshkuj	207	56.7
	Gjithsej	365	100.0
Vendbanimi	Qytet	224	61.4
	Fshat	141	38.6
Mosha mesatare e prindërve		<i>MA</i>	<i>DS</i>
	Femra	43.34	5.86
	Meshkuj	44.08	5.89
	Gjithsej	43.76	5.88

[Shënim. MA = mesatarja aritmetike

DS = devijimi standard]

Tabela 8

Të dhënat për familjet e prindërve pjesëmarrës në hulumtim

		<i>N</i>	<i>%</i>
Numri i anëtarëve në familje	Deri në 3 anëtarë	14	3.8
	4-6 anëtarë	281	77.0

	Më shumë se 6 anëtarë	70	19.2
Jetojnë	Së bashku		
	Të ndarë		
Punësimi	Në punë	252	69.0
	Pa punë	113	31.0
Punësimi i bashkëshortit/es	Në punë		
	Pa punë		

Në përputhje me pyetjen kërkimore dhe hipotezat e hulumtimit për gjininë, vendbanimin, numrin e anëtarëve të familjes, punësimin u zhvillua testi i hi-katrorit. Vlerat e fituara përmes testit *chi-square*, në të gjitha rastet treguan që ka dallime të vlefshme statistikore ndërmjet nënave dhe baballarëve pjesëmarrës në hulumtim [$\chi^2(1)= 6.578, p =.010$], prindërve që jetojnë në fshat dhe në qytet [$\chi^2(1)= 254.158, p =.000$], ndërmjet familjeve me numër të ndryshëm të anëtarëve [$\chi^2(2)= 325.879, p =.000$], ndërmjet prindërve të punësuar dhe jo të punësuar [$\chi^2(1)= 52.934, p =.000$].

Tabela 9

Niveli i arsimimit të prindërve

		N	%
Niveli i arsimimit	Shkollë Fillore	39	10.7
	Shkollë e mesme	184	50.4
	ShLP	26	7.1
	Fakultet	99	27.1
	Magjistraturë	16	4.4

Niveli i arsimimit të bashkëshortit/es	Doktoraturë	1	0.3
	Shkollë Fillore	73	20.0
	Shkollë e mesme	178	48.8
	ShLP	24	6.6
	Fakultet	64	17.5
	Magjistraturë	20	5.5
	Doktoraturë	6	1.6

Tabela 10

Të dhënat për kohën e kaluar të fëmijëve të tyre në familje, me shoqëri, duke parë TV dhe në internet, sipas mendimit të prindërve

		<i>N</i>	<i>%</i>
Koha e kaluar me familjen në ditë	Më pak se një orë	18	4.9
	2-3 orë në ditë	38	10.4
	Më shumë se 3 orë në ditë	296	81.1
	Nuk e di	13	3.6
Koha e kaluar me shokë/shoqe jashtë mësimit	Më pak se një orë		
	2-3 orë në ditë		
	Më shumë se 3 në		

	ditë		
	Nuk e di		
Koha e kaluar duke parë TV	Më pak se një orë	89	24.4
	2-3 orë në ditë	205	56.2
	Më shumë se 3 në ditë	56	15.3
	Nuk e di	15	4.1
Koha e kaluar në internet në ditë	Më pak se një orë		
	2-3 orë në ditë		
	Më shumë se 3 në ditë		
	Nuk e di		

3.4. Instrumentet e përdorura në hulumtim

Të dhënat për realizimin e këtij hulumtimi u mbledhën përmes pyetësorëve që ishin të bazuar në vete raportimin e nxënësve, prindërve si dhe mësimeve mbi identifikimin e ndikimit të faktorëve familjarë tek nxënësit, që shfaqin sjelljeve të dhunshme në shkollë.

Në të tre pyetësorët në pjesën e parë janë paraqitur të dhënat demografike, kurse në dy pjesët e tjera të pyetësorit është kërkuar që nxënësit, prindërit si dhe mësimeve të përgjigjen në pohimet e ofruara në shkallën Likert, por edhe të përcaktojnë pohimin që prezanton qëndrimin e tyre. Seksioni i dytë i pyetësorit është shfrytëzuar, përfshinë: Opinioni mbi shkaktarët e dhunës, e autores Mimoza Shahini (2013).

Pyetësi për nxënës

Pyetësi për nxënësit është i bazuar në vetë raportimin e nxënësve, i cili është ndarë në tri pjesë, ku në pjesën e parë përfshihen pyetjet mbi të dhënat demografike të nxënësve, si: gjinia, mosha, vendbanimi, numri i anëtarëve në familje, punësimi i prindërve, niveli i arsimimit të prindërve, numri i nxënësve në klasë, koha e kaluar në familje, në shoqëri, duke parë televizion dhe në internet brenda ditës.

Në pjesën e dytë të pyetësorit janë përfshirë pohimet mbi jetën në shkollë, me shokët dhe shoqet, trajtimi i tyre nga mësimeve, nga drejtori i shkollës, marrëdhëniet mësimeve-prindër si dhe trajtimi i nxënësve nga prindërit. Çdo pohim i kësaj pjese është i përbërë nga këto përgjigje: 1=Pajtohem plotësisht; 2=Pajtohem; 3=Pajtohem pjesërisht; 4=Nuk pajtohem; 5=Nuk pajtohem fare.

Në pjesën e tretë të pyetësorit për nxënësit përfshihen pohimet për shkaktarët e sjelljeve të dhunshme në shkollë. Pohimet e tilla, që kanë të bëjnë me raportimin e nxënësve për shkaktarët e

sjelljeve të dhunshme në shkollë, duke të përfshirë: familjen, shkollën, lagjen, menaxherët e shkollës, mësimdhënësit.

Çdo pohim i kësaj pjese është i përbërë nga këto përgjigje: 1=Aspak nuk ndikon; 2=Pak ndikon; 3=Ndonjëherë ndikon; 4=Ndikon mesatarisht; 5=Shumë ndikon; 6=Gjithmonë ndikon.

Pyetësi për prindër

Pyetësi për prindërit është pyetësor vetë raportues, i cili është i ndarë në tri pjesë, ku në pjesën e parë përfshihen pyetjet mbi të dhënat demografike të prindërve, si: gjinia, mosha, vendbanimi, numri i anëtarëve në familje, punësimi, niveli i arsimit si dhe raportimi për fëmijët e tyre për kohën e kaluar të fëmijëve në familje, në shoqëri, duke parë televizion, në internet brenda ditës.

Në pjesën e dytë të pyetësit për prindërit përfshihen pohimet për atmosferën në familje, marrëdhëniet në çift, disiplinimi i fëmijëve. Çdo pohim i kësaj pjese është i përbërë nga këto përgjigje: 1=Pajtohem plotësisht; 2=Pajtohem; 3=Pajtohem pjesërisht; 4=Nuk pajtohem; 5=Nuk pajtohem fare.

Në pjesën e tretë të pyetësit për prindërit bëjnë pjesë pohimet mbi shkaktarët e shfaqjes së sjelljeve të dhunshme në shkollë, duke përfshirë: familjen, shkollën, lagjen. Çdo pohim i kësaj pjese është i përbërë nga këto përgjigje: 1=Aspak nuk ndikon; 2=Pak ndikon; 3=Ndonjëherë ndikon; 4=Ndikon mesatarisht; 5=Shumë ndikon; 6=Gjithmonë ndikon.

Pyetësi për mësimdhënësit

Pyetësi për mësimdhënësit është pyetësor vetë raportues, i cili është i ndarë në tri pjesë, ku në pjesën e parë përfshihen pyetjet mbi të dhënat demografike të mësimdhënësve, si: gjinia, mosha, vendbanimi, niveli i arsimimit si dhe numri i nxënësve në shkollë.

Në pjesën e dytë të pyetësit për mësimdhënësit përfshihen pohimet për atmosferën e punës në shkollë, mënyrat e disiplinimit në shkollë. Çdo pohim i kësaj pjese është i përbërë nga këto përgjigje: 1=Pajtohem plotësisht; 2=Pajtohem; 3=Pajtohem pjesërisht; 4=Nuk pajtohem; 5=Nuk pajtohem fare.

Në pjesën e tretë të pyetësit për prindër bëjnë pjesë pohimet mbi shkaktarët e shfaqjes së sjelljeve të dhunshme në shkollë, duke përfshirë: familjen, shkollën, lagjen. Çdo pohim i kësaj pjese është i përbërë nga këto përgjigje: 1=Aspak nuk ndikon; 2=Pak ndikon; 3=Ndonjëherë ndikon; 4=Ndikon mesatarisht; 5=Shumë ndikon; 6=Gjithmonë ndikon.

Analiza faktoriale e pyetësit për nxënësit

Pyetësi për nxënësit, ka përmbajtur gjithsej 13 variable që kanë prezantuar karakteristikat e grupit të mostrës sonë, dhe 58 variable (items), përmes të cilave janë mbledhur perceptimet e nxënësve mbi ndikimin e familjes në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek ta.

Me 58 variabelat u zhvillua analiza faktoriale eksploruese sipas metodës së Komponentëve Kryesore dhe rotacionit (ortogonal) VARIMAX [meqenëse të dhënat tona janë intervale]. Vlerat e testit KMO and Bartlett's Test [Kaiser-Meyer-Olkin Measure of Sampling Adequacy = .891; dhe Bartlett's Test of Sphericity Sig= .000], na treguan që analiza faktoriale është valide dhe eksploruese.

Përmes procedurës faktoriale variabellet manifeste janë kondensuar dhe si rrjedhim janë fituar 12 faktorë latentë. Në varësi të variableve që kanë përbërë secilin faktor, 12 faktorët/komponentët janë emëruar, si:

- Marrëdhëniet jo të qëndrueshme në familje dhe gjendja ekonomike
- Prezenca e dhunës në ambiente të shkollës
- Prezenca e dhunës në familje nga prindërit dhe vëllezërit më të mëdhenj
- Mbikëqyrja e familjes
- Mungesa e sigurisë në shkollë
- Qëndrimi kritikues i prindërve ndaj fëmijëve
- Frika ndaj prindërve
- Ngacmimet nga shokët dhe shoqet në shkollë
- Lagjja ku banojnë nxënësit
- Interneti dhe lojërat e dhunshme
- Komunikimi i rregullt shkollë-familje
- Qëndrimi ndëshkues i familjes kur nxënësi gabon

Analiza faktoriale e pyetësorit për prindër

Pyetësi për prindër ka përmbajtur gjithsej 12 variable. që kanë prezantuar karakteristikat e grupit të mostrës sonë, dhe 46 variable (items) përmes të cilave janë mbledhur perceptimet e prindërve mbi ndikimin e familjes në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek fëmijët e tyre, nxënës të klasave të teta dhe të nënta.

Me 46 variabellet u zhvillua analiza faktoriale eksploruese sipas metodës së Komponentëve Kryesore dhe rotacionit (ortogonal) VARIMAX [meqenëse të dhënat tona janë intervale]. Vlerat e testit KMO and Bartlett's Test [Kaiser-Meyer-Olkin Measure of Sampling Adequacy = .859;

dhe Bartlett's Test of Sphericity Sig= .000), na treguan që analiza faktoriale është valide dhe eksploruese.

Përmes procedurës faktoriale variablat manifeste janë kondensuar dhe si rrjedhim janë fituar 9 faktorë latentë. Në varësi të variablave që kanë përbërë secilin faktor, 9 faktorët/komponentët janë emëruar, si:

- Ballafaqimi me situata të dhunshme
- Mendimi që ndëshkimi fizik është i nevojshëm
- Mbikëqyrja e dobët e familjes
- Ndëshkimi fizik si formë disiplinimi
- Mbikëqyrja ndaj fëmijëve
- Lojërat e dhunshme dhe interneti
- Qëndrimi kritikues ndaj fëmijëve
- Komunikimi me prindërit
- Atmosfera në familje

Analiza faktoriale e pyetësorit për mësimdhënësit

Pyetësi për mësimdhënësit përmbajti gjithsej 4 variable, që prezantuan karakteristikat e grupit të mostrës sonë, dhe 40 variable (items), përmes të cilave janë mbledhur perceptimet e mësimdhënësve mbi ndikimin e familjes në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek nxënësit e klasave të teta dhe të nënta.

Me 40 variablet u zhvillua analiza faktoriale eksploruese sipas metodës së Komponentëve Kryesorë dhe rotacionit (ortogonal) VARIMAX [meqenëse të dhënat tona janë intervale]. Vlerat e testit KMO and Bartlett's Test [Kaiser-Meyer-Olkin Measure of Sampling Adequacy = .567;

dhe Bartlett's Test of Sphericity Sig= .000), na treguan që analiza faktoriale është valide dhe eksploruese.

Përmes procedurës faktoriale variablat manifeste janë kondensuar dhe si rrjedhim janë fituar 10 faktorë latentë. Në varësi të variableve që kanë përbërë secilin faktor, 10 faktorët/komponentët janë emëruar, si:

- Ballafaqimi me situata të dhunshme
- Mbikëqyrja e dobët e familjes
- Prezenca e dhunës në familje
- Gjendja ekonomike e familjes
- Lojërat e dhunshme dhe interneti

Besueshmëria e instrumentit

Rezultatet nga analiza e pyetësorëve

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur vlerat e fituara të Cronbach alfa (α) për pyetjet e pyetësorit për nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit. Siç shihet nga tabela, vlerat për pyetësorin për nxënësit janë në nivele të larta si për vajzat, për djemtë, ashtu edhe për të gjithë nxënësit e përfshirë në hulumtim. Edhe vlerat e fituara nga pyetësorët për mësimdhënësit dhe prindërit, tregojnë që pyetësorët mund të konsiderohen mjaft të besueshëm në vlerësimin e dhunës dhe ndikimet në të tek nxënësit e klasave 8 dhe 9.

Tabela 11

Konsistenca e brendshme (Cronbach α) e raportuar nga nxënësit

	Meshkuj	Femra	Gjithsej
	Cronbach α	Cronbach α	Cronbach α
Pyetësi i Nxënësve	.909	.867	.897
Pyetësi i Prindërve	.870	.858	.865
Pyetësi i Mësimdhënësve	.668	.696	.681

3.5. Procesi i analizës së të dhënave

Në procesin e mbledhjes së të dhënave janë angazhuar përveç autores edhe tri studentë nga departamenti i psikologjisë, që kishin përvojë në realizimin e pyetësorëve.

Procesi i mbledhjes së të dhënave është zhvilluar në periudhën maj 2014, ku fillimisht nëpër të gjitha shkollat janë mbledhur këshillat drejtues të shkollave për ta dhënë konfirmimin e shpërndarjes së fletë pëlqimeve për prindërit. Pas këtij procesi janë marrë lejet për hulumtim nga prindërit, DKA-ja dhe MASHT-i.

Pyetësorët nga nxënësit dhe mësimdhënësit janë plotësuar në prezencën tonë, ndërsa prindërit i kanë plotësuar pyetësorët në shtëpi dhe më pas i kanë kthyer në shkollë. Procesi i mbledhjes së të dhënave është zhvilluar shumë mirë dhe kënaqshëm.

3.6. Aspekti etik

Aspekti etik, të cilin kam pasur parasysh për këtë studim nuk ndryshon nga aspektet etike të studimeve të tjera. Për të pasur sigurinë që të gjitha standardet etike të realizoheshin në mënyrën e duhur gjatë gjithë procesit janë ndërmarrë disa hapa. Fillimisht është kërkuar aprovimi i institucioneve, të cilat janë përfshirë në studim. Leja për ta realizuar hulumtimin fillimisht është marrë nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë si dhe Drejtoria për Arsim në Komunën e Prishtinës. Nëpër shkollat në të cilat është planifikuar hulumtimi janë thirrur këshillat e prindërve për të marrë lejen për ta realizuar hulumtimin, po ashtu, më pas janë marrë fletë-pëlqimet nga prindërit e nxënësve për të marrë pjesë në hulumtim. Pjesëmarrësve që në fillim u është bërë i qartë qëllimi i studimit dhe natyra vullnetare e pjesëmarrjes në studim. Pjesëmarrësit mund të tërhiqeshin nga studimi nëse nuk kishin dëshirë të merrnin pjesë në të. Në studim nuk janë përdorur emrat e pjesëmarrësve, të cilët kanë kontribuar për mbledhjen e të dhënave të pjesës cilësore të studimit, në asnjë pjesë të këtij punimi.

KAPITULLI IV

ANALIZA EMPIRIKE 1

PREZANTIMI I ANALIZAVE TE PYETESORIT PER NXENES

Pyetësi për nxënësit, përmbajti gjithsej 13 variabël, që kanë prezantuar karakteristikat e grupit të mostrës sonë, dhe 58 variabël (items) përmes të cilave janë mbledhur perceptimet e nxënësve mbi ndikimin e familjes në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek ta.

Me 58 variabël u zhvillua analiza faktoriale eksploruese sipas metodës së Komponentëve Kryesore dhe rotacionit (ortogonal) VARIMAX [mëqenëse të dhënat tona janë intervale]. Vlerat e testit KMO and Bartlett's Test [Kaiser-Meyer-Olkin Measure of Sampling Adequacy = .891; dhe Bartlett's Test of Sphericity Sig= .000), na treguan që analiza faktoriale është valide dhe eksploruese.

Përmes procedurës faktoriale variabël manifeste janë kondensuar dhe si rrjedhim janë fituar 12 faktorë latentë. Në varësi të variabëlve që kanë përbërë secilin faktor, 12 faktorët/komponentët janë emëruar, si:

- Marrëdhëniet jo të qëndrueshme në familje dhe gjendja ekonomike
- Prezenca e dhunës në ambientet e shkollës
- Prezenca e dhunës në familje nga prindërit dhe vëllezërit më të mëdhenj
- Mbikëqyrja e familjes
- Mungesa e sigurisë në shkollë
- Qëndrimi kritikues i prindërve ndaj fëmijëve
- Frika ndaj prindërve
- Ngacmimet nga shokët dhe shoqet në shkollë
- Lagjja ku banojnë nxënësit

- Interneti dhe lojërat e dhunshme
- Komunikimi i rregullt shkollë-familje
- Qëndrimi ndëshkues i familjes kur nxënësi gabon

Duke pasur parasysh që tema e punimit është e lidhur drejtpërdrejt me familjen dhe ndikimin e saj në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek nxënësit e klasave të teta dhe nënta, në analizat e mëtejme janë përfshirë vetëm faktorët, të cilët na mundësojnë që të trajtojmë këtë temë më tej.

Këta faktorë janë:

1. Marrëdhëniet jo të qëndrueshme në familje dhe gjendja ekonomike;
2. Prezenca e dhunës në familje nga prindërit dhe vëllezërit më të mëdhenj
3. Mbikëqyrja e familjes
4. Qëndrimi kritikues i prindërve ndaj fëmijëve
5. Frika ndaj prindërve
6. Interneti dhe lojërat e dhunshme
7. Komunikimi i rregullt shkollë-familje
8. Qëndrimi ndëshkues i familjes kur nxënësi gabon

Me vlerat e faktorëve të përcaktuar nga analiza faktoriale eksploruese, për të gjitha ndryshoret (variablet) demografike, ne zhvilluam testin e vërtetimit të shpërndarjes normale të të dhënave, i cili edhe përcaktoi analizat e mëtejme. Testi Shapiro – Wilks ($p > .05$) (Shapiro & Wilk, 1965; Razali & Wah, 2011), konsiderohet si testi më i fuqishëm, vlerat e të cilit na tregojnë normalitetin e të dhënave tona. Për të gjithë faktorët dhe ndryshoret demografike, vlerat e fituara nga ky test, ishin më të vogla se .05. Për këtë arsye, analizat e përdorura janë analizat jo parametrike, testi Mann – Whitney U dhe Kruskal-Wallis test.

Testi Mann-Whitney. U është përdorur për të krahasuar dallimet midis dy grupeve të pavarura kur ndryshorja e varur është ose rendore ose e vazhdueshme, por nuk është e shpërndarë normalisht.

Testi Kruskal-Wallis H (nganjëherë i quajtur edhe "ANOVA e rendit") është një analizë joparametrike që mund të përdoret për të përcaktuar nëse ka ndryshime statistikisht domethënëse, të vlefshme në mes të dy ose më shumë grupeve në një variabël/ndryshore dhe të një ndryshore të pavarur me një ndryshore të vazhdueshme ose rendore. Ajo është konsideruar alternativë jo parametrike për një drejtim të ANOVA-s, dhe një zgjatje e testit Mann-Whitney U për të lejuar krahasimin e më shumë se dy grupeve të pavarura.

Në rastet kur kemi pasur vlera sinjifikante/të rëndësishme të probabilitetit, kemi zhvilluar post hoc analizën Tukey HSD. Meqenëse të dhënat tona janë të shpërndara jo normalisht, testi më i zakonshëm post hoc në këto raste është testi Games-Howell, por vlerat e fituara nga zhvillimi i këtij testi janë të njëjta me vlerat e fituara nga testi Tukey HSD, i cili nga shumica e metodistëve konsiderohet si një nga testet më të fuqishme në nxjerrjen e dallimeve statistikore ndërmjet disa nëngrupeve. Për këtë arsye, ne i referohemi rezultateve të këtij testi. Tabelat në vazhdim paraqesin vlerat e mesatares aritmetike dhe devijimit standard për secilin faktor sipas karakteristikave të nxënësve pjesëmarrës në hulumtim.

Tabela 12- *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas gjinisë – Pyetësori për nxënësit*, paraqet vlerat e mesatares aritmetike dhe të devijimit standard për faktorët që ndikojnë në sjelljet e dhunshme tek nxënësit sipas gjinisë. Siç shihet nga tabela, shumica e faktorëve kanë treguar vlera më të larta të mesatares aritmetike për vajzat dhe, në shumë pak prej tyre këto vlera janë më të larta për djemtë. Nëse i referohemi faktorëve, ata kanë treguar vlera të përafërta ndërmjet tyre.

Tabela 12.*Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas gjinisë – Pyetësi për nxënësit*

Faktorët	Gjinia					
	Femra		Meshkuj		Gjithsej	
	MA	DS	MA	DS	MA	DS
Marrëdhëniet jo të qëndrueshme në familje dhe gjendja ekonomike	2.59	0.57	2.46	0.67	2.52	0.63
Prezenca e dhunës në familje nga prindërit dhe vëllezërit më të mëdhenj	2.56	0.58	2.50	0.55	2.53	0.57
Mbikëqyrja e familjes	2.51	0.54	2.48	0.60	2.49	0.57
Qëndrimi kritikues i prindërve ndaj fëmijëve	2.50	0.54	2.53	0.59	2.52	0.57
Frika ndaj prindërve	2.47	0.55	2.55	0.57	2.51	0.56
Interneti dhe lojërat e dhunshme	2.59	0.54	2.52	0.60	2.56	0.57
Komunikimi i rregullt shkollë-familje	2.50	0.57	2.52	0.60	2.51	0.59
Qëndrimi ndëshkues i familjes kur nxënësi gabon	2.59	0.57	2.43	0.64	2.51	0.61

Për të parë dallimet ndërmjet nxënësve që jetojnë në fshat dhe qytet, me të dhënat tona u zhvillua analiza Mann - Whitney U, rezultatet e të cilës paraqiten në tabelën vijuese për të gjithë faktorët.

Tabela 13*Dallimet e faktorëve tek nxënësit sipas gjinisë*

Faktorët	Gjinia	Mean Rank	Mann-Whitney U	Sig.
Marrëdhëniet jo të qëndrueshme në familje dhe gjendja ekonomike	M	237.60	27997.500	.038
	F	260.72		
Prezenca e dhunës në familje nga prindërit dhe vëllezërit më të mëdhenj	M	240.51	28729.500	.127
	F	257.74		
Mbikëqyrja e familjes	M	246.11	30142.000	.606
	F	251.97		
Qëndrimi kritikues i prindërve ndaj fëmijëve	M	251.68	30193.500	.631
	F	246.24		
Frika ndaj prindërve	M	258.79	28403.000	.079
	F	238.93		
Interneti dhe lojërat e dhunshme	M	240.30	28678.000	.118
	F	257.95		
Komunikimi i rregullt shkollë-familje	M	250.87	30399.000	.739
	F	247.08		
Qëndrimi ndëshkues i familjes kur nxënësi gabon	M	234.06	27105.500	.008
	F	264.37		

Siç shihet nga tabela 13, dallimet janë të vlefshme statistikisht vetëm në faktorët: Marrëdhëniet jo të qëndrueshme në familje dhe gjendja ekonomike, e prezantuar me vlerën $p=.0381$ dhe Qëndrimi ndëshkues i familjes kur nxënësi gabon e shprehur me vlerën $p=.008$. Në të dy

faktorët, janë femrat ato që kanë treguar vlera më të larta se sa meshkujt. Të gjithë faktorët e tjerë nuk kanë treguar ndryshime të vlefshme statistikore.

Tabela 14- *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas llojit të familjes - Pyetësi për nxënësit*, paraqet vlerat e mesatares aritmetike dhe devijimit standard për faktorët që ndikojnë në sjelljet e dhunshme tek nxënësit sipas llojit të familjes. Siç shihet nga tabela, disa nga faktorët kanë treguar vlera më të larta të mesatares aritmetike për familjet që jetojnë bashkë dhe disa prej tyre kanë treguar vlera për familjet që jetojnë të ndarë.

Tabela 14

Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas llojit të familjes - Pyetësi për nxënësit

Faktorët	Së bashku		Të ndarë	
	MA	DS	MA	DS
Marrëdhëniet jo të qëndrueshme në familje dhe gjendja ekonomike	2.53	0.58	2.45	0.62
Prezenca e dhunës në familje nga prindërit dhe vëllezërit më të mëdhenj	2.50	0.57	2.45	0.57
Mbikëqyrja e familjes	2.52	0.56	2.32	0.59
Qëndrimi kritikues i prindërve ndaj fëmijëve	2.53	0.56	2.23	0.56
Frika ndaj prindërve	2.51	0.59	2.71	0.46
Interneti dhe lojërat e dhunshme	2.50	0.59	2.55	0.57
Komunikimi i rregullt shkollë-familje	2.51	0.61	2.55	0.62
Qëndrimi ndëshkues i familjes kur nxënësi gabon	2.51	0.61	2.55	0.62

Tabela 15*Dallimet sipas llojit të familjes*

Faktorët	Prindërit jetojnë:	Mean Rank	Mann- Whitney U	Sig.
Marrëdhëniet jo të qëndrueshme në familje dhe gjendja ekonomike	Së bashku	247.69	6613.500	.364
	Të ndarë	268.66		
Prezenca e dhunës në familje nga prindërit dhe vëllezërit më të mëdhenj	Së bashku	252.93	5392.000	.007
	Të ndarë	189.94		
Mbikëqyrja e familjes	Së bashku	249.52	6980.500	.722
	Të ndarë	241.18		
Qëndrimi kritikues i prindërve ndaj fëmijëve	Së bashku	249.89	6808.000	.542
	Të ndarë	235.61		
Frika ndaj prindërve	Së bashku	253.17	5278.500	.004
	Të ndarë	186.27		
Interneti dhe lojërat e dhunshme	Së bashku	249.69	6900.500	.635
	Të ndarë	238.60		
Komunikimi i rregullt shkollë-familje	Së bashku	248.42	6953.000	.693
	Të ndarë	257.71		
Qëndrimi ndëshkues i familjes kur nxënësi gabon	Së bashku	248.46	6972.500	.716
	Të ndarë	257.08		

Siç shihet nga tabela 15, dallimet janë të vlefshme statistikisht vetëm për faktorët: Prezenca e dhunës në familje nga prindërit dhe vëllezërit më të mëdhenj, e prezantuar me vlerën $p=.007$

dhe frika ndaj prindërve $p=.004$. Në të dy faktorët, janë prindërit që jetojnë së bashku, ata që kanë treguar vlera signifikante. Të gjithë faktorët e tjerë nuk kanë treguar ndryshime të vlefshme statistikore.

Tabela 16- Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas punësimit të babait - Pyetësi për nxënësit paraqet vlerat e mesatares aritmetike dhe të devijimit standard për faktorët që ndikojnë në sjelljet e dhunshme tek nxënësit sipas punësimit të babait. Siç shihet nga tabela, shumica e faktorëve kanë treguar vlera më të larta të mesatares aritmetike për baballarët e punësuar dhe në shumë pak prej tyre për ata të pa punësuar. Nëse i referohemi faktorëve, ata kanë treguar vlera të përafërta ndërmjet tyre.

Tabela 16

Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas punësimit të babait - Pyetësi për nxënësit

Faktorët	Punësimi i babait			
	PO		JO	
	MA	DS	MA	DS
Marrëdhëniet jo të qëndrueshme në familje dhe gjendja ekonomike	2.52	0.65	2.53	0.61
Prezenca e dhunës në familje nga prindërit dhe vëllezërit më të mëdhenj	2.50	0.59	2.56	0.55
Mbikëqyrja e familjes	2.57	0.57	2.44	0.57
Qëndrimi kritikues i prindërve ndaj fëmijëve	2.55	0.55	2.49	0.58
Frika ndaj prindërve	2.58	0.55	2.45	0.56
Interneti dhe lojërat e dhunshme	2.57	0.58	2.55	0.57

Komunikimi i rregullt shkollë-familje	2.55	0.61	2.48	0.57
Qëndrimi ndëshkues i familjes kur nxënësi gabon	2.50	0.61	2.52	0.61

Tabela 17

Dallimet sipas punësimit së babait

Faktorët	Babai punon:	Mean Rank	Mann- Whitney U	Sig.
Marrëdhëniet jo të qëndrueshme në familje dhe gjendja ekonomike	Po	249.49	30175.500	.939
	Jo	248.63		
Prezenca e dhunës në familje nga prindërit dhe vëllezërit më të mëdhenj	Po	240.21	28400.000	.176
	Jo	255.65		
Mbikëqyrja e familjes	Po	264.68	26925.000	.016
	Jo	237.14		
Qëndrimi kritikues i prindërve ndaj fëmijëve	Po	254.64	29073.000	.386
	Jo	244.73		
Frika ndaj prindërve	Po	265.77	26692.500	.010
	Jo	236.32		
Interneti dhe lojërat e dhunshme	Po	250.44	29973.000	.825
	Jo	247.91		
Komunikimi i rregullt shkollë-familje	Po	258.21	28309.500	.159
	Jo	242.03		
Qëndrimi ndëshkues i familjes kur nxënësi gabon	Po	246.22	29687.000	.674
	Jo	251.10		

Siç shihet nga tabela 17, dallimet janë të vlefshme statistikisht vetëm për faktorët: Mbikëqyrja e familjes, e prezantuar me vlerën $p=.016$ dhe frika ndaj prindërve e shprehur me vlerën $p=.010$. Në të dy faktorët, janë treguar vlera signifikante kur babai punon. Të gjithë faktorët e tjerë nuk kanë treguar ndryshime të vlefshme statistikore.

Tabela 18- *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas nivelit të arsimimit të nënës - Pyetësi për nxënësit*, paraqet vlerat e mesatares aritmetike dhe devijimit standard për faktorët që ndikojnë në sjelljet e dhunshme tek nxënësit sipas nivelit të arsimimit të nënës. Siç shihet nga tabela, shumica e faktorëve kanë treguar vlera më të larta të mesatares aritmetike për nivelet e arsimimit më të lartë të nënës.

Tabela 18

Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas nivelit të arsimimit të nënës - Pyetësi për nxënësit

	Filllore	Mesme	ShLP	Fakulte t	Master	Doktora të
	MA (DS)	MA (DS)	MA (DS)	MA (DS)	MA (DS)	MA (DS)
Marrëdhëniet jo të qëndrueshme në familje dhe gjendja ekonomike	2.27 (0.70)	2.60 (0.59)	2.40 (0.62)	2.58 (0.57)	2.44 (0.69)	2.47 (0.77)
Prezenca e dhunës në familje nga prindërit dhe vëllezërit më të mëdhenj	2.42 (0.69)	2.55 (0.57)	2.50 (0.51)	2.61 (0.52)	2.42 (0.54)	2.42 (0.51)
Mbikëqyrja e familjes	2.47	2.50	2.57	2.47	2.56	2.53

	(0.59)	(0.53)	(0.57)	(0.59)	(0.69)	(0.51)
Qëndrimi kritikues i prindërve ndaj fëmijëve	2.42	2.49	2.53	2.60	2.49	2.53
	(0.61)	(0.58)	(0.51)	(0.56)	(0.51)	(0.61)
Frika ndaj prindërve	2.45	2.49	2.50	2.53	2.62	2.42
	(0.53)	(0.57)	(0.63)	(0.54)	(0.54)	(0.69)
Interneti dhe lojërat e dhunshme	2.47	2.56	2.50	2.58	2.60	2.58
	(0.59)	(0.57)	(0.51)	(0.59)	(0.54)	(0.61)
Komunikimi i rregullt shkollë-familje	2.52	2.46	2.40	2.53	2.51	2.95
	(0.69)	(0.59)	(0.50)	(0.53)	(0.51)	(0.71)
Qëndrimi dënues i familjes kur nxënësi gabon	2.56	2.54	2.67	2.46	2.42	2.32
	(0.59)	(0.63)	(0.61)	(0.59)	(0.58)	(0.67)

Tabela 19

Dallimet sipas nivelit të arsimimit të nënës

Faktorët	Niveli i Arsimimit të Nënës	Mean Rank	Chi-Square (df 5)	Sig.
Marrëdhëniet jo të qëndrueshme në familje dhe gjendja ekonomike	Shkollë Fillore	201.07	15.215	.009
	Mesme	264.32		
	ShLP	219.87		
	Fakultet	258.88		
	Magjistraturë	235.89		
	Doktoraturë	248.71		
Prezenca e dhunës në familje nga	Shkollë Fillore	227.23	7.721	.172

prindërit dhe vëllezërit më të	Mesme	252.91		
mëdhenj	ShLP	239.75		
	Fakultet	266.51		
	Magjistraturë	223.92		
	Doktoraturë	220.84		
Mbikëqyrja e familjes	Shkollë Fillore	246.90	1.198	.945
	Mesme	248.99		
	ShLP	268.80		
	Fakultet	243.15		
	Magjistraturë	254.77		
	Doktoraturë	255.29		
Qëndrimi kritikues i prindërve	Shkollë Fillore	231.84	4.295	.508
ndaj fëmijëve	Mesme	244.06		
	ShLP	251.23		
	Fakultet	265.99		
	Magjistraturë	240.59		
	Doktoraturë	243.87		
Frika ndaj prindërve	Shkollë Fillore	234.60	3.837	.573
	Mesme	245.63		
	ShLP	236.98		
	Fakultet	255.17		
	Magjistraturë	276.39		
	Doktoraturë	238.26		
Interneti dhe lojërat e dhunshme	Shkollë Fillore	233.30	1.926	.859
	Mesme	251.64		

	ShLP	234.75		
	Fakultet	251.31		
	Magjistraturë	261.47		
	Doktoraturë	248.34		
Komunikimi i rregullt shkollë-familje	Shkollë Fillore	251.58	10.715	.057
	Mesme	238.50		
	ShLP	226.30		
	Fakultet	254.97		
	Magjistraturë	252.63		
	Doktoraturë	331.50		
	Shkollë Fillore	262.52	6.510	.260
	Mesme	254.26		
Qëndrimi ndëshkues i familjes kur nxënësi gabon	ShLP	284.65		
	Fakultet	238.29		
	Magjistraturë	232.42		
	Doktoraturë	214.53		

Rezultatet nga tabela 19 tregojnë që vetëm për faktorin e parë, marrëdhëniet jo të qëndrueshme në familje dhe gjendja ekonomike, ekzistojnë dallime të vlefshme statistikore në nëngrupet që prezantojnë nivelin e arsimimit të nënës ($p = .009$). Për të përcaktuar se cilët prej grupeve dallojnë statistikisht mes tyre, u zhvillua analiza post hoc Tukey HSD, rezultatet e së cilës treguan që dallimet janë të vlefshme statistikisht vetëm në grupin e nënave me arsim fillor, të atyre me arsim të mesëm, ndërmjet nënave me arsim fillor dhe atyre me fakultet. Grupet e tjera nuk kishin dallime të vlefshme statistikore.

Tabela 20- *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas kohës që kalojnë në internet– Pyetësi për nxënës*, paraqet vlerat e mesatares aritmetike dhe devijimit standard për faktorët që ndikojnë në sjelljet e dhunshme tek nxënësit sipas kohës që kalojnë në internet. Siç shihet nga tabela, shumica e faktorëve kanë treguar vlera më të larta të mesatares aritmetike për nxënësit që kalojnë në internet 2-3 orë dhe më shumë se tri orë në ditë.

Tabela 20

Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas kohës që kalojnë në internet - Pyetësi për nxënësit

Faktorët	Më pak	2-3 orë	Më shumë se 3	Nuk e di
	se 1 orë		orë	
	<i>MA (DS)</i>	<i>MA(DS)</i>	<i>MA (DS)</i>	<i>MA (DS)</i>
Marrëdhëniet jo të qëndrueshme në familje dhe gjendja ekonomike	2.45 (0.65)	2.60 (0.60)	2.47 (0.67)	2.57 (0.58)
Prezenca e dhunës në familje nga prindërit dhe vëllezërit më të mëdhenj	2.61 (0.57)	2.54 (0.56)	2.31 (0.53)	2.61 (0.57)
Mbikëqyrja e familjes	2.52 (0.58)	2.52 (0.57)	2.41 (0.56)	2.49 (0.58)
Qëndrimi kritikues i prindërve ndaj fëmijëve	2.45 (0.57)	2.57 (0.56)	2.58 (0.58)	2.47 (0.56)
Frika ndaj prindërve	2.55 (0.56)	2.49 (0.55)	2.60 (0.51)	2.34 (0.63)
Interneti dhe lojërat e dhunshme	2.65 (0.56)	2.50 (0.60)	2.54 (0.56)	2.50 (0.53)

Komunikimi i rregullt shkollë-familje	2.52 (0.58)	2.54 (0.62)	2.41 (0.59)	2.54 (0.50)
Qëndrimi dënues i familjes kur nxënësi gabon	2.43 (0.58)	2.57 (0.63)	2.52 (0.65)	2.53 (0.58)

Tabela 21

Dallimet sipas kohës që kalojnë në internet

Faktorët	Koha e kaluar në internet	Mean Rank	Chi-Square (df 3)	Sig.
Marrëdhëniet jo të qëndrueshme në familje dhe gjendja ekonomike	Më pak se një orë	233.39	6.076	.108
	2-3 orë në ditë	265.08		
	Më shumë se 3 orë	240.63		
	Nuk e di	256.29		
Prezenca e dhunës në familje nga prindërit dhe vëllezërit më të mëdhenj	Më pak se një orë	265.53	19.513	.000
	2-3 orë në ditë	252.44		
	Më shumë se 3 orë	198.75		
	Nuk e di	269.23		
Mbikëqyrja e familjes	Më pak se një orë	253.54	3.087	.378
	2-3 orë në ditë	255.21		
	Më shumë se 3 orë	228.43		
	Nuk e di	250.56		
Qëndrimi kritikues i prindërve ndaj fëmijëve	Më pak se një orë	233.74	5.748	.125
	2-3 orë në ditë	263.42		

	Më shumë se 3 orë	257.92		
	Nuk e di	236.61		
Frika ndaj prindërve	Më pak se një orë	257.89	7.664	.053
	2-3 orë në ditë	243.63		
	Më shumë se 3 orë	267.65		
	Nuk e di	217.04		
Interneti dhe lojërat e dhunshme	Më pak se një orë	268.07	5.992	.112
	2-3 orë në ditë	236.87		
	Më shumë se 3 orë	247.89		
	Nuk e di	236.59		
Komunikimi i rregullt shkollë-familje	Më pak se një orë	250.02	3.060	.382
	2-3 orë në ditë	254.10		
	Më shumë se 3 orë	229.35		
	Nuk e di	260.16		
Qëndrimi ndëshkues i familjes kur nxënësi gabon	Më pak se një orë	232.54	4.831	.185
	2-3 orë në ditë	263.23		
	Më shumë se 3 orë	249.67		
	Nuk e di	250.81		

Rezultatet nga tabela 21 tregojnë që për faktorin: Prezenca e dhunës në familje nga prindërit dhe vëllezërit më të mëdhenj ($p = .000$) ekzistojnë dallime të vlefshme statistikore në nëngrupet që prezantojnë kohën e kaluar në internet. Për të përcaktuar se cilët prej grupeve dallojnë statistikisht mes tyre, u zhvillua analiza post hoc Tukey HSD, rezultatet e së cilës treguan që dallimet janë të vlefshme statistikisht në të gjitha nëngrupet, përveç në nëngrupin e parë, kur koha e kaluar në internet ishte më pak se një orë.

Po ashtu, dallime statistikisht të vlefshme ndërmjet nëngrupeve të përcaktuara, tregoi edhe faktori Frika ndaj prindërve ($p = .053$). Analiza post hoc Tukey HSD, tregoi që dallimet janë të vlefshme statistikisht, kryesisht në nëngrupet e skajshme (më pak se një orë / nuk e di).

Tabela 22- *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas kohës që kalojnë duke parë televizor– Pyetësi për nxënësit*, paraqet vlerat e mesatares aritmetike dhe devijimit standard për faktorët që ndikojnë në sjelljet e dhunshme tek nxënësit sipas kohës që kalojnë duke parë televizor. Siç shihet nga tabela, shumica e faktorëve kanë treguar vlera më të larta të mesatares aritmetike për nxënësit që qëndrojnë 2-3 orë në disa nga faktorët si dhe më shumë se tri orë dhe nuk e di . Nëse i referohemi faktorëve, ata kanë treguar vlera të përafërta ndërmjet tyre.

Tabela 22

Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas kohës që kalojnë duke parë televizor
- *Pyetësi për nxënësit*

Faktorët	Më pak se 1 orë	2-3 orë	Më shumë se 3 orë	Nuk e di
	MA (DS)	MA(DS)	MA (DS)	MA (DS)
Marrëdhëniet jo të qëndrueshme në familje dhe gjendja ekonomike	2.46 (0.67)	2.58 (0.61)	2.51 (0.57)	2.50 (0.66)
Prezenca e dhunës në familje nga prindërit dhe vëllezërit më të mëdhenj	2.58 (0.58)	2.51 (0.57)	2.47 (0.52)	2.56 (0.58)
Mbikëqyrja e familjes	2.52 (0.59)	2.50 (0.56)	2.47 (0.59)	2.45 (0.56)
Qëndrimi kritikues i prindërve ndaj	2.59	2.48	2.43	2.61

fëmijëve	(0.59)	(0.58)	(0.50)	(0.55)
Frika ndaj prindërve	2.50	2.56	2.50	2.38
	(0.56)	(0.56)	(0.52)	(0.60)
Interneti dhe lojërat e dhunshme	2.59	2.50	2.65	2.52
	(0.60)	(0.57)	(0.57)	(0.50)
Komunikimi i rregullt shkollë-familje	2.50	2.50	2.48	2.58
	(0.60)	(0.60)	(0.52)	(0.61)
Qëndrimi dënues i familjes kur nxënësi gabon	2.43	2.54	2.60	2.44
	(0.63)	(0.61)	(0.60)	(0.61)

Tabela 23

Dallimet sipas kohës që kalojnë duke parë televizor

Faktorët	Koha e kaluar duke parë televizor	Mean Rank	Chi-Square (df 3)	Sig.
Marrëdhëniet jo të qëndrueshme në familje dhe gjendja ekonomike	Më pak se një orë	238.28	3.102	.376
	2-3 orë në ditë	260.36		
	Më shumë se 3 orë	241.30		
	Nuk e di	246.07		
Prezenca e dhunës në familje nga prindërit dhe vëllezërit më të mëdhenj	Më pak se një orë	262.01	3.740	.291
	2-3 orë në ditë	245.89		
	Më shumë se 3 orë	230.40		
	Nuk e di	256.50		
Mbikëqyrja e familjes	Më pak se një orë	254.26	.887	.829

	2-3 orë në ditë	251.31		
	Më shumë se 3 orë	240.91		
	Nuk e di	241.65		
Qëndrimi kritikues i prindërve	Më pak se një orë	266.31	7.828	.050
ndaj fëmijëve	2-3 orë në ditë	240.55		
	Më shumë se 3 orë	226.92		
	Nuk e di	268.87		
Frika ndaj prindërve	Më pak se një orë	247.04	5.111	.164
	2-3 orë në ditë	261.33		
	Më shumë se 3 orë	243.01		
	Nuk e di	222.58		
Interneti dhe lojërat e dhunshme	Më pak se një orë	257.37	5.375	.146
	2-3 orë në ditë	237.59		
	Më shumë se 3 orë	270.65		
	Nuk e di	238.36		
Komunikimi i rregullt shkollë- familje	Më pak se një orë	244.83	.931	.818
	2-3 orë në ditë	250.40		
	Më shumë se 3 orë	243.29		
	Nuk e di	260.89		
Qëndrimi ndëshkues i familjes kur nxënësi gabon	Më pak se një orë	229.69	7.213	.065
	2-3 orë në ditë	254.90		
	Më shumë se 3 orë	273.31		
	Nuk e di	238.26		

Duke ju referuar tabelës së mësipërme (23) edhe pse analiza Kruskal-Wallis ka nxjerrë vlera të rëndësisë statistikore për faktorin Qëndrimi kritikues i prindërve ndaj fëmijëve ($p=.050$), analiza e mëtejme e post hoc Tukey HSD testit, nuk tregoi dallime të vlefshme statistikore ndërmjet nëngrupeve.

Tabela 24- *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas kohës që kalojnë me Shokë/Shoqe jashtë Mësimit – Pyetësori për Nxënës*, paraqet vlerat e mesatares aritmetike dhe devijimit standard për faktorët që ndikojnë në sjelljet e dhunshme tek nxënësit sipas kohës që kalojnë me shokë/shoqe jashtë mësimit. Siç shihet nga tabela, shumica e faktorëve kanë treguar vlera më të larta të mesatares aritmetike për nxënësit që kalojnë kohën me shokë/shoqe më shumë se tri orë. Nëse i referohemi faktorëve, ata kanë treguar vlera të përafërta ndërmjet tyre.

Tabela 24

Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas kohës që kalojnë me shokë/shoqe jashtë mësimit - Pyetësori për nxënësit

Faktorët	Më pak	2-3 orë	Më shumë se 3	Nuk e di
	se 1 orë		orë	
	MA (DS)	MA(DS)	MA (DS)	MA (DS)
Marrëdhëniet jo të qëndrueshme në familje dhe gjendja ekonomike	2.62 (0.61)	2.47 (0.64)	2.49 (0.61)	2.42 (0.66)
Prezenca e dhunës në familje nga prindërit dhe vëllezërit më të mëdhenj	2.60 (0.53)	2.51 (0.63)	2.46 (0.53)	2.46 (0.57)
Mbikëqyrja e familjes	2.49 (0.58)	2.46 (0.55)	2.57 (0.60)	2.51 (0.55)

Qëndrimi kritikues i prindërve ndaj fëmijëve	2.48 (0.58)	2.57 (0.56)	2.54 (0.50)	2.49 (0.59)
Frika ndaj prindërve	2.46 (0.57)	2.53 (0.53)	2.61 (0.57)	2.49 (0.57)
Interneti dhe lojërat e dhunshme	2.58 (0.56)	2.52 (0.58)	2.60 (0.62)	2.51 (0.55)
Komunikimi i rregullt shkollë-familje	2.53 (0.57)	2.52 (0.60)	2.43 (0.55)	2.51 (0.63)
Qëndrimi dënues i familjes kur nxënësi gabon	2.50 (0.60)	2.52 (0.64)	2.61 (0.52)	2.42 (0.66)

Tabela 25

Dallimet sipas kohës që kalojnë me shokë/shoqe jashtë mësim

Faktorët	Koha e kaluar me shokë/shoqe jashtë mësim	Mean Rank	Chi-Square (df 3)	Sig.
Marrëdhëniet jo të qëndrueshme në familje dhe gjendja ekonomike	Më pak se një orë	269.61	9.539	.023
	2-3 orë në ditë	237.04		
	Më shumë se 3 orë	238.39		
	Nuk e di	228.86		
Prezenca e dhunës në familje nga prindërit dhe vëllezërit më të mëdhenj	Më pak se një orë	265.54	6.632	.085
	2-3 orë në ditë	244.70		
	Më shumë se 3 orë	231.29		
	Nuk e di	231.62		

Mbikëqyrja e familjes	Më pak se një orë	248.94	2.053	.562
	2-3 orë në ditë	239.71		
	Më shumë se 3 orë	266.14		
	Nuk e di	250.44		
Qëndrimi kritikues i prindërve ndaj fëmijëve	Më pak se një orë	239.93	2.749	.432
	2-3 orë në ditë	262.16		
	Më shumë se 3 orë	253.51		
	Nuk e di	244.89		
Frika ndaj prindërve	Më pak se një orë	239.03	3.489	.322
	2-3 orë në ditë	253.68		
	Më shumë se 3 orë	270.39		
	Nuk e di	247.19		
Interneti dhe lojërat e dhunshme	Më pak se një orë	254.27	2.187	.534
	2-3 orë në ditë	242.92		
	Më shumë se 3 orë	261.29		
	Nuk e di	236.50		
Komunikimi i rregullt shkollë-familje	Më pak se një orë	252.43	1.366	.714
	2-3 orë në ditë	252.39		
	Më shumë se 3 orë	232.96		
	Nuk e di	248.48		
Qëndrimi ndëshkues i familjes kur nxënësi gabon	Më pak se një orë	247.96	4.930	.177
	2-3 orë në ditë	250.77		
	Më shumë se 3 orë	273.75		
	Nuk e di	228.13		

Analiza Kruskal-Wallis edhe në këtë rast (Tabela 25) ka nxjerrë vlera të rëndësishë statistikore për faktorin Marrëdhëniet jo të qëndrueshme në familje dhe gjendja ekonomike ($p=.023$). Megjithatë, analiza e mëtejme e post hoc Tukey HSD testit, nuk tregoi dallime të vlefshme statistikore ndërmjet nëngrupeve.

Tabela 26- *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas kohës që kalojnë me familje– Pyetësi për nxënësit*, paraqet vlerat e mesatares aritmetike dhe devijimit standard për faktorët që ndikojnë në sjelljet e dhunshme tek nxënësit sipas kohës që kalojnë në familje. Siç shihet nga tabela, shumica e faktorëve kanë treguar vlera më të larta të mesatares aritmetike për nxënësit që kalojnë kohën më pak se një orë në ditë dhe shumë prej tyre dy deri në tri orë në ditë.

Tabela 26

Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas kohës që kalojnë me familjen në ditë
- *Pyetësi për nxënësit*

Faktorët	Më pak se 1 orë	2-3 orë	Më shumë se 3 orë	Nuk e di
	MA (DS)	MA(DS)	MA (DS)	MA (DS)
Marrëdhëniet jo të qëndrueshme në familje dhe gjendja ekonomike	2.45 (0.56)	2.52 (0.62)	2.56 (0.62)	2.44 (0.68)
Prezenca e dhunës në familje nga prindërit dhe vëllezërit më të mëdhenj	2.45 (0.67)	2.50 (0.59)	2.53 (0.56)	2.59 (0.54)
Mbikëqyrja e familjes	2.55 (0.56)	2.44 (0.56)	2.53 (0.57)	2.38 (0.59)
Qëndrimi kritikues i prindërve ndaj fëmijëve	2.52 (0.51)	2.52 (0.56)	2.55 (0.57)	2.39 (0.58)

Frika ndaj prindërve	2.42 (0.50)	2.63 (0.55)	2.49 (0.57)	2.53 (0.55)
Interneti dhe lojërat e dhunshme	2.58 (0.61)	2.66 (0.48)	2.52 (0.58)	2.60 (0.58)
Komunikimi i rregullt shkollë-familje	2.58 (0.61)	2.61 (0.55)	2.47 (0.59)	2.53 (0.59)
Qëndrimi dënues i familjes kur nxënësi gabon	2.61 (0.50)	2.67 (0.54)	2.50 (0.64)	2.40 (0.60)

Tabela 27

Dallimet sipas kohës që kalojnë me familjen në ditë

Faktorët	Koha e kaluar me familjen në ditë	Mean Rank	Chi-Square (df 3)	Sig.
Marrëdhëniet jo të qëndrueshme në familje dhe gjendja ekonomike	Më pak se një orë	227.71	3.484	.323
	2-3 orë në ditë	245.98		
	Më shumë se 3 orë	256.27		
	Nuk e di	233.13		
Prezenca e dhunës në familje nga prindërit dhe vëllezërit më të mëdhenj	Më pak se një orë	233.33	1.449	.694
	2-3 orë në ditë	242.05		
	Më shumë se 3 orë	248.84		
	Nuk e di	260.64		
Mbikëqyrja e familjes	Më pak se një orë	263.38	6.413	.093
	2-3 orë në ditë	237.69		

	Më shumë se 3 orë	257.43		
	Nuk e di	221.55		
Qëndrimi kritikues i prindërve ndaj fëmijëve	Më pak se një orë	246.88	4.796	.187
	2-3 orë në ditë	250.82		
	Më shumë se 3 orë	256.15		
	Nuk e di	222.73		
Frika ndaj prindërve	Më pak se një orë	226.03	4.214	.239
	2-3 orë në ditë	274.54		
	Më shumë se 3 orë	244.81		
	Nuk e di	254.00		
Interneti dhe lojërat e dhunshme	Më pak se një orë	253.71	3.481	.323
	2-3 orë në ditë	272.02		
	Më shumë se 3 orë	241.82		
	Nuk e di	256.10		
Komunikimi i rregullt shkollë-familje	Më pak se një orë	260.89	3.347	.341
	2-3 orë në ditë	272.28		
	Më shumë se 3 orë	242.30		
	Nuk e di	251.45		
Qëndrimi ndëshkues i familjes kur nxënësi gabon	Më pak se një orë	270.21	8.042	.045
	2-3 orë në ditë	282.30		
	Më shumë se 3 orë	246.14		
	Nuk e di	226.76		

Rezultatet nga Tabela 27 tregojnë që për faktorin: Qëndrimi ndëshkues i familjes kur nxënësi gabon ($p = .045$) ekzistojnë dallime të vlefshme statistikore në nëngrupet që prezantojnë kohën e

kaluar në ditë me familjen. Për të përcaktuar se cilët prej grupeve dallojnë statistikisht mes tyre, u zhvillua analiza post hoc Tukey HSD, rezultatet e së cilës treguan që dallimet janë të vlefshme statistikisht vetëm në nëngrupet nuk e di dhe 2-3 orë në ditë. Për të gjitha nëngrupet e tjera, dallimet nuk kishin vlerë statistikore.

KAPITULLI V: ANALIZA 2

PREZANTIMI I ANALIZAVE TE PYETËSORIT PËR PRINDËRIT

Pyetësoni për prindër ka përmbajtur gjithsej 12 variable ,që kanë prezantuar karakteristikat e grupit të mostrës sonë, dhe 46 variable (items) përmes të cilave janë mbledhur perceptimet e prindërve mbi ndikimin e familjes në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek fëmijët e tyre, nxënës të klasave të teta dhe të nënta.

Me 46 variablet u zhvillua analiza faktoriale eksploruese sipas metodës së Komponentëve Kryesore dhe rotacionit (ortogonal) VARIMAX [meqenëse të dhënat tona janë intervale]. Vlerat e testit KMO and Bartlett's Test [Kaiser-Meyer-Olkin Measure of Sampling Adequacy = .859; dhe Bartlett's Test of Sphericity Sig= .000), na treguan që analiza faktoriale është valide dhe eksploruese.

Përmes procedurës faktoriale variablat manifeste janë kondensuar dhe si rrjedhim janë fituar 9 faktorë latentë. Në varësi të variableve që kanë përbërë secilin faktor, 9 faktorët/komponentët janë emëruar si:

- Ballafaqimi me situata të dhunshme
- Mendimi që ndëshkimi fizik është i nevojshëm
- Mbikëqyrja e dobët e familjes
- Ndëshkimi fizik si formë disiplinimi
- Mbikëqyrja ndaj fëmijëve
- Lojërat e dhunshme dhe interneti
- Qëndrimi kritikues ndaj fëmijëve
- Komunikimi me prindërit
- Atmosfera në familje

Duke pasur parasysh që tema e punimit është e lidhur drejtpërdrejtë me familjen dhe ndikimin e saj në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek nxënësit e klasave të teta dhe nënta, në analizat e mëtejme janë përfshirë vetëm faktorët, të cilët na mundësojnë që të trajtojmë këtë temë më tej.

Këta faktorë janë:

1. Mendimi që ndëshkimi fizik është i nevojshëm
2. Ndëshkimi fizik si formë disiplinimi
3. Mbikëqyrja ndaj fëmijëve
4. Lojërat e dhunshme dhe interneti
5. Qëndrimi kritikues ndaj fëmijëve
6. Komunikimi me prindërit
7. Atmosfera në familje

Tabelat në vazhdim paraqesin vlerat e mesatares aritmetike dhe të devijimit standard për secilin faktor sipas karakteristikave të prindërve pjesëmarrës në hulumtim.

Tabela 28- Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas vendbanimit– Pyetësori për prindërit, paraqet vlerat e mesatares aritmetike dhe devijimit standard për faktorët që ndikojnë në sjelljet e dhunshme tek nxënësit sipas vendbanimit. Siç shihet nga tabela, shumica e faktorëve kanë treguar vlera më të larta të mesatares aritmetike për nxënësit nga qyteti. Nëse i referohemi faktorëve, ata kanë treguar vlera të përafërta ndërmjet tyre.

Tabela 28

Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas vendbanimit– Pyetësori për prindërit

Faktorët	Fshat		Qytet	
	MA	DS	MA	DS
Mendimi që ndëshkimi fizik është i nevojshëm	2.54	0.59	2.49	0.55
Ndëshkimi fizik si formë disiplinimi	2.56	0.60	2.56	0.60
Mbikëqyrja ndaj fëmijëve	2.45	0.59	2.49	0.61
Lojërat e dhunshme dhe interneti	2.62	0.55	2.49	0.61
Qëndrimi kritikues ndaj fëmijëve	2.45	0.55	2.55	0.59
Komunikimi me prindërit	2.52	0.62	2.52	0.59
Atmosfera në familje	2.38	0.58	2.48	0.58

Tabela 29

Dallimet e faktorëve tek prindërit që jetojnë në fshat dhe qytet

Faktorët	Vendbanimi	Mean Rank	Mann-Whitney U	Sig.
Mendimi që ndëshkimi fizik është i nevojshëm	Fshat	187.37	15035.000	.425
	Qytet	179.42		
Ndëshkimi fizik si formë disiplinimi	Fshat	182.50	15721.000	1.000
	Qytet	182.50		
Mbikëqyrja ndaj fëmijëve	Fshat	178.85	15207.500	.546

	Qytet	184.80		
Lojërat e dhunshme dhe interneti	Fshat	194.68	14004.000	.045
	Qytet	174.80		
Qëndrimi kritikues ndaj fëmijëve	Fshat	174.39	14578.500	.184
	Qytet	187.63		
Komunikimi me prindërit	Fshat	183.20	15623.500	.910
	Qytet	182.06		
Atmosfera në familje	Fshat	170.84	14077.500	.050
	Qytet	189.87		

Testi Mann-Whitney U, (Tabela 29) tregoi vlera të rëndësishë statistikore në faktorin Lojërat e dhunshme dhe interneti ($p=.045$) në të cilin prindërit që banojnë në fshat treguan vlera më të larta se sa prindërit që banojnë në qytet. Edhe faktori Atmosfera në familje ($p=.050$) tregoi dallime ndërmjet prindërve që banojnë në fshat dhe në qytet, me vlera më të larta për prindërit që jetojnë në qytet.

Tabela 30-Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas numrit të anëtarëve të familjes– Pyetësi për prindërit, paraqet vlerat e mesatares aritmetike dhe të devijimit standard për faktorët që ndikojnë në sjelljet e dhunshme tek nxënësit sipas numrit të anëtarëve të familjes. Siç shihet nga tabela, shumica e faktorëve kanë treguar vlera të përafërta të mesatares aritmetike për të tre grupet me anëtarë të familjes, me një krahasim të vogël vlera më të larta të mesatares aritmetike ka treguar grupi i familjeve me tre anëtarë.

Tabela 30

Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas numrit të anëtarëve të familjes -

Pyetësori për prindërit

Faktorët	Deri në 3 anëtarë		4-6 Anëtarë		Mbi 6 Anëtarë	
	MA	DS	MA	DS	MA	DS
Mendimi që ndëshkimi fizik është i nevojshëm	2.54	0.52	2.52	0.57	2.49	0.56
Ndëshkimi fizik si formë disiplinimi	2.31	0.75	2.58	0.59	2.53	0.63
Mbikëqyrja ndaj fëmijëve	2.69	0.75	2.48	0.60	2.41	0.58
Lojërat e dhunshme dhe interneti	2.69	0.48	2.54	0.61	2.51	0.56
Qëndrimi kritikues ndaj fëmijëve	2.46	0.52	2.52	0.59	2.47	0.56
Komunikimi me prindërit	2.46	0.52	2.53	0.59	2.50	0.63
Atmosfera në familje	2.85	0.55	2.39	0.54	2.56	0.67

Tabela 31

Dallimet sipas prindërve për numrin e anëtarëve të familjes

Faktorët	Numri i anëtarëve të familjes	Mean Rank	Chi-Square (df 2)	Sig.
Mendimi që ndëshkimi fizik është i nevojshëm	3 anëtarë	186.50	.094	.954
	4-6 anëtarë	183.00		

	Më shumë se 6 anëtarë	179.76		
Ndëshkimi fizik si formë disiplinimi	3 anëtarë	151.73	1.909	.385
	4-6 anëtarë	185.23		
	Më shumë se 6 anëtarë	177.26		
Mbikëqyrja ndaj fëmijëve	3 anëtarë	209.96	2.018	.365
	4-6 anëtarë	183.67		
	Më shumë se 6 anëtarë	172.69		
Lojërat e dhunshme dhe interneti	3 anëtarë	205.42	1.018	.601
	4-6 anëtarë	182.71		
	Më shumë se 6 anëtarë	177.40		
Qëndrimi kritikues ndaj fëmijëve	3 anëtarë	177.04	.471	.790
	4-6 anëtarë	184.31		
	Më shumë se 6 anëtarë	176.25		
Komunikimi me prindërit	3 anëtarë	171.38	.516	.773
	4-6 anëtarë	184.33		
	Më shumë se 6 anëtarë	177.24		
Atmosfera në familje	3 anëtarë	249.88	10.706	.005
	4-6 anëtarë	175.71		
	Më shumë se 6 anëtarë	197.24		

Rezultatet e testit Kruskal Wallis, të paraqitura me vlerën e testit Chi-square për shkallë të lirisë 2 (Tabela 31) sipas vlerave të rëndësisë statistikore, tregojnë që në faktorin Atmosfera në familje ($p=.005$) ka dallime të vlefshme statistikisht në numrin e anëtarëve të familjes. Post hoc analiza Tukey HSD, tregoi që këto dallime janë ndërmjet nëngrupeve të familjeve me tre anëtarë me

familjet me 4-6 anëtarë. Nëngrupi për familjet me mbi 6 anëtarë, nuk kishte dallime statistikisht të rëndësishme me asnjë nga nëngrupet e tjera.

Tabela 32- *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas llojit të familjes– Pyetësi për prindërit*, paraqet vlerat e mesatares aritmetike dhe devijimit standard për faktorët që ndikojnë në sjelljet e dhunshme tek nxënësit sipas llojit të familjes. Siç shihet nga tabela, shumica e faktorëve kanë treguar vlera më të larta të mesatares aritmetike për familjet me prindër të ndarë.

Tabela 32

Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas llojit të familjes - Pyetësi për prindërit

Faktorët	Së bashku		Të ndarë	
	MA	DS	MA	DS
Mendimi që ndëshkimi fizik është i nevojshëm	2.53	0.56	2.21	0.63
Ndëshkimi fizik si formë disiplinimi	2.55	0.59	2.74	0.65
Mbikëqyrja ndaj fëmijëve	2.47	0.59	2.58	0.69
Lojërat e dhunshme dhe interneti	2.53	0.60	2.79	0.42
Qëndrimi kritikues ndaj fëmijëve	2.52	0.58	2.32	0.48
Komunikimi me prindërit	2.52	0.60	2.42	0.61
Atmosfera në familje	2.43	0.58	2.53	0.61

Tabela 33

Dallimet e faktorëve tek familjet që jetojnë së bashku dhe të ndarë, sipas prindërve

Faktorët	Familja jeton:	Mean Rank	Mann- Whitney U	Sig.
Mendimi që ndëshkimi fizik është i nevojshëm	Së bashku Të ndarë	184.94 138.21	2436.000	.032
Ndëshkimi fizik si formë disiplinimi	Së bashku Të ndarë	180.86 212.29	2711.500	.149
Mbikëqyrja ndaj fëmijëve	Së bashku Të ndarë	181.81 195.08	3038.500	.539
Lojërat e dhunshme dhe interneti	Së bashku Të ndarë	180.31 222.18	2523.500	.054
Qëndrimi kritikues ndaj fëmijëve	Së bashku Të ndarë	184.20 151.61	2690.500	.135
Komunikimi me prindërit	Së bashku Të ndarë	183.24 168.97	3020.500	.516
Atmosfera në familje	Së bashku Të ndarë	181.72 196.71	3007.500	.481

Siç shihet nga Tabela 33, analiza Mann-Whitney U, tregoi dallime të vlefshme statistikore në faktorin Mendimi që ndëshkimi fizik është i nevojshëm ($p=.032$). Vlerat më të larta janë në favor të familjeve që jetojnë së bashku. Po ashtu, edhe faktori Lojërat e dhunshme dhe interneti ($p=.054$), tregoi dallim statistikor ndërmjet familjeve që jetojnë të ndarë dhe familjeve që jetojnë të bashkuar. Familjet e ndara paraqitën vlerat më të larta.

Tabela 34- *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas punësimit– Pyetësi për prindërit*, paraqet vlerat e mesatares aritmetike dhe devijimit standard për faktorët që ndikojnë në sjelljet e dhunshme tek nxënësit sipas punësimit. Siç shihet nga tabela, shumica e faktorëve kanë treguar vlera të përafërta të mesatares aritmetike si për prindërit e punësuar ashtu edhe për ata të papunësuar.

Tabela 34

Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas punësimit - Pyetësi për prindërit

Faktorët	Punësimi			
	PO		JO	
	MA	DS	MA	DS
Mendimi që ndëshkimi fizik është i nevojshëm	2.57	0.56	2.38	0.56
Ndëshkimi fizik si formë disiplinimi	2.56	0.59	2.57	0.62
Mbikëqyrja ndaj fëmijëve	2.48	0.61	2.48	0.58
Lojërat e dhunshme dhe interneti	2.55	0.61	2.53	0.57
Qëndrimi kritikues ndaj fëmijëve	2.49	0.56	2.55	0.61
Komunikimi me prindërit	2.52	0.60	2.51	0.60
Atmosfera në familje	2.42	0.56	2.48	0.61

Tabela 35*Dallimet e faktorëve tek prindërit sipas punësimit*

Faktorët	Të punësuar	Mean Rank	Mann-Whitney U	Sig.
Mendimi që ndëshkimi fizik është i nevojshëm	Po	191.77	11853.500	.004
	Jo	161.90		
Ndëshkimi fizik si formë disiplinimi	Po	182.46	14171.500	.990
	Jo	182.59		
Mbikëqyrja ndaj fëmijëve	Po	182.05	14069.500	.890
	Jo	183.49		
Lojërat e dhunshme dhe interneti	Po	183.21	14003.000	.826
	Jo	180.92		
Qëndrimi kritikues ndaj fëmijëve	Po	180.57	13696.500	.553
	Jo	186.79		
Komunikimi me prindërit	Po	181.43	13913.000	.744
	Jo	184.88		
Atmosfera në familje	Po	180.32	13635.500	.493
	Jo	187.33		

Tabela e mësipërme (35) paraqet vlerat e analizës Mann-Whitney U, e cila tregoi që ka dallime janë të vlefshme statistikore në faktorin Mendimi që ndëshkimi fizik është i nevojshëm ($p=.004$).

Vlerat më të larta janë në favor të familjeve në të cilat prindërit janë të punësuar.

Tabela 36- *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas nivelit të arsimimit të nënës– Pyetësi për prindërit*, paraqet vlerat e mesatares aritmetike dhe devijimit standard për faktorët që ndikojnë në sjelljet e dhunshme tek nxënësit sipas nivelit të arsimimit të nënës. Siç

shihet nga tabela, shumica e faktorëve kanë treguar vlera të larta të mesatares aritmetike si për prindërit me nivel më të lartë të arsimimit.

Tabela 36

Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas kohës që nxënësit kalojnë duke parë televizor - Pyetësi për prindërit

Faktorët	Më pak se një orë		2-3 orë në ditë		Mbi 3 orë në ditë		Nuk e di	
	MA (DS)		MA (DS)		MA (DS)		MA (DS)	
Mendimi që ndëshkimi fizik është i nevojshëm	2.47	0.54	2.56	0.57	2.40	0.56	2.47	0.64
Ndëshkimi fizik si formë disiplinimi	2.48	0.59	2.55	0.59	2.76	0.61	2.47	0.74
Mbikëqyrja ndaj fëmijëve	2.45	0.62	2.49	0.58	2.38	0.59	2.80	0.68
Lojërat e dhunshme dhe interneti	2.57	0.54	2.53	0.59	2.58	0.63	2.40	0.83
Qëndrimi kritikues ndaj fëmijëve	2.60	0.63	2.51	0.57	2.35	0.48	2.60	0.51
Komunikimi me prindërit	2.46	0.71	2.55	0.56	2.45	0.57	2.73	0.46
Atmosfera në familje	2.45	0.56	2.42	0.58	2.49	0.63	2.47	0.52

Tabela 37*Dallimet sipas kohës që kalojnë duke parë televizor, sipas prindërve*

Faktorët	Koha e kaluar duke parë televizor	Mean Rank	Chi-Square (df 3)	Sig.
Mendimi që ndëshkimi fizik është i nevojshëm	Më pak se një orë	174.90	4.053	.256
	2-3 orë në ditë	190.59		
	Më shumë se 3 orë	165.40		
	Nuk e di	179.77		
Ndëshkimi fizik si formë disiplinimi	Më pak se një orë	169.78	8.824	.032
	2-3 orë në ditë	179.64		
	Më shumë se 3 orë	215.23		
	Nuk e di	177.07		
Mbikëqyrja ndaj fëmijëve	Më pak se një orë	176.40	6.600	.086
	2-3 orë në ditë	186.07		
	Më shumë se 3 orë	165.99		
	Nuk e di	230.43		
Lojërat e dhunshme dhe interneti	Më pak se një orë	186.96	.440	.932
	2-3 orë në ditë	180.71		
	Më shumë se 3 orë	184.31		
	Nuk e di	173.80		

Qëndrimi kritikues ndaj fëmijëve	Më pak se një orë	193.49	6.123	.106
	2-3 orë në ditë	183.26		
	Më shumë se 3 orë	156.78		
	Nuk e di	201.20		
Komunikimi me prindërit	Më pak se një orë	172.83	4.631	.201
	2-3 orë në ditë	187.34		
	Më shumë se 3 orë	170.38		
	Nuk e di	218.13		
Atmosfera në familje	Më pak se një orë	185.26	.788	.852
	2-3 orë në ditë	179.02		
	Më shumë se 3 orë	188.50		
	Nuk e di	191.70		

Duke ju referuar tabelës së mësipërme (37), analiza Kruskal-Wallis ka nxjerrë vlera të rëndësishë statistikore për faktorin Ndëshkimi fizik si formë disiplinimi ($p=.032$). Analiza e mëtejme e post hoc Tukey HSD testit, tregoi dallime të vlefshme statistikore ndërmjet nëngrupeve “më pak se një orë në ditë” me nëngrupin “më shumë se tre orë në ditë”, ku vlerat më të larta janë treguar nga nëngrupi i fundit. Nëngrupet e tjera nuk treguan rëndësi statistikore në dallimet ndërmjet tyre.

Tabela 38- Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas kohës që nxënësit kalojnë me shokë dhe shoqe jashtë mësimi– Pyetësi për prindërit, paraqet vlerat e mesatares aritmetike dhe të devijimit standard për faktorët që ndikojnë në sjelljet e dhunshme tek nxënësit sipas kohës që nxënësit kalojnë me shokë dhe shoqe jashtë mësimi. Siç shihet nga tabela, shumica e faktorëve kanë treguar vlera më të larta të mesatares aritmetike për nxënësit që qëndrojnë më shumë se tri orë dhe opinioni i prindërve se nuk e di.

Tabela 38

Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas kohës që nxënësit kalojnë me shokë dhe shoqe jashtë mësimit - Pyetësi për prindërit

Faktorët	Më pak se një orë		2-3 orë në ditë		Mbi 3 orë në ditë		Nuk e di	
	MA (DS)		MA (DS)		MA (DS)		MA (DS)	
Mendimi që ndëshkimi fizik është i nevojshëm	2.51	0.56	2.49	0.58	2.65	0.57	2.36	0.63
Ndëshkimi fizik si formë disiplinimi	2.55	0.61	2.66	0.58	2.35	0.65	2.57	0.51
Mbikëqyrja ndaj fëmijëve	2.42	0.58	2.56	0.59	2.74	0.69	2.64	0.63
Lojërat e dhunshme dhe interneti	2.56	0.55	2.51	0.68	2.57	0.79	2.43	0.51
Qëndrimi kritikues ndaj fëmijëve	2.51	0.58	2.53	0.55	2.43	0.59	2.57	0.76
Komunikimi me prindërit	2.50	0.60	2.48	0.64	2.70	0.47	2.71	0.47
Atmosfera në familje	2.43	0.58	2.38	0.56	2.70	0.63	2.57	0.51

Tabela 39

Dallimet sipas kohës që kalojnë me shokë/shoqe jashtë mësimi, sipas prindërve

Faktorët	Koha e kaluar me shokë /shoqe jashtë mësimi	Mean Rank	Chi- Square (df 3)	Sig.
Mendimi që ndëshkimi fizik është i nevojshëm	Më pak se një orë	182.64	3.980	.264
	2-3 orë në ditë	179.84		
	Më shumë se 3 orë	210.28		
	Nuk e di	148.89		
Ndëshkimi fizik si formë disiplinimi	Më pak se një orë	180.90	4.340	.227
	2-3 orë në ditë	196.70		
	Më shumë se 3 orë	152.33		
	Nuk e di	182.50		
Mbikëqyrja ndaj fëmijëve	Më pak se një orë	173.18	9.517	.023
	2-3 orë në ditë	196.62		
	Më shumë se 3 orë	220.24		
	Nuk e di	209.29		
Lojërat e dhunshme dhe interneti	Më pak se një orë	183.93	2.007	.571
	2-3 orë në ditë	176.79		
	Më shumë se 3 orë	199.85		
	Nuk e di	159.93		
Qëndrimi kritikues ndaj fëmijëve	Më pak se një orë	181.63	1.016	.797

	2-3 orë në ditë	187.13		
	Më shumë se 3 orë	168.54		
	Nuk e di	195.57		
Komunikimi me prindërit	Më pak se një orë	180.29	4.562	.207
	2-3 orë në ditë	175.08		
	Më shumë se 3 orë	211.65		
	Nuk e di	214.86		
Atmosfera në familje	Më pak se një orë	180.48	7.006	.072
	2-3 orë në ditë	172.06		
	Më shumë se 3 orë	222.67		
	Nuk e di	209.93		

Duke ju referuar tabelës së mësipërme (39), analiza Kruskal-Wallis ka nxjerrë vlera të rëndësishë statistikore për faktorin Mbikëqyrja ndaj fëmijëve ($p=.023$). Analiza e mëtejme e post hoc Tukey HSD testit, nuk tregoi dallime të vlefshme statistikore ndërmjet nëngrupeve.

Tabela 40- Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas kohës që nxënësit kalojnë me familjen në ditë– Pyetësori për nxënësit, paraqet vlerat e mesatares aritmetike dhe devijimit standard për faktorët që ndikojnë në sjelljet e dhunshme tek nxënësit sipas kohës që kalojnë në familje. Siç shihet nga tabela, shumica e faktorëve kanë treguar vlera më të larta grupi dy deri në tri orë në ditë dhe mbi tri orë në ditë e, pak nga faktorët kanë treguar edhe grupi më pak se një orë në ditë .

Tabela 40

Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas kohës që nxënësit kalojnë me familjen në ditë - Pyetësi për prindërit

Faktorët	Më pak se një orë		2-3 orë në ditë		Mbi 3 orë në ditë		Nuk e di	
	MA (DS)		MA (DS)		MA (DS)		MA (DS)	
Mendimi që ndëshkimi fizik është i nevojshëm	2.39	0.61	2.47	0.65	2.53	0.56	2.31	0.48
Ndëshkimi fizik si formë disiplinimi	2.28	0.57	2.71	0.73	2.56	0.58	2.54	0.66
Mbikëqyrja ndaj fëmijëve	3.06	0.64	2.74	0.64	2.41	0.56	2.46	0.66
Lojërat e dhunshme dhe interneti	2.50	0.62	2.47	0.65	2.57	0.58	2.31	0.75
Qëndrimi kritikues ndaj fëmijëve	2.17	0.51	2.42	0.59	2.53	0.58	2.77	0.44
Komunikimi me prindërit	2.56	0.70	2.53	0.65	2.51	0.59	2.69	0.48
Atmosfera në familje	2.78	0.65	2.63	0.63	2.39	0.56	2.46	0.52

Tabela 41*Dallimet sipas kohës që kalojnë nxënësit me familjen në ditë, sipas prindërve*

Faktorët	Koha e kaluar me shokë /shoqe jashtë mësimit	Mean Rank	Chi- Square (df 3)	Sig.
Mendimi që ndëshkimi fizik është i nevojshëm	Më pak se një orë	165.14	3.553	.314
	2-3 orë në ditë	173.18		
	Më shumë se 3 orë	186.37		
	Nuk e di	146.00		
Ndëshkimi fizik si formë disiplinimi	Më pak se një orë	137.36	6.397	.094
	2-3 orë në ditë	204.25		
	Më shumë se 3 orë	182.38		
	Nuk e di	184.08		
Mbikëqyrja ndaj fëmijëve	Më pak se një orë	265.94	25.634	.000
	2-3 orë në ditë	222.24		
	Më shumë se 3 orë	172.51		
	Nuk e di	177.58		
Lojërat e dhunshme dhe interneti	Më pak se një orë	177.47	2.272	.518
	2-3 orë në ditë	170.84		
	Më shumë se 3 orë	185.58		
	Nuk e di	153.54		
Qëndrimi kritikues ndaj fëmijëve	Më pak se një orë	120.69	12.641	.005
	2-3 orë në ditë	169.74		
	Më shumë se 3 orë	185.79		

	Nuk e di	230.73		
Komunikimi me prindërit	Më pak se një orë	188.17	1.365	.714
	2-3 orë në ditë	180.83		
	Më shumë se 3 orë	181.11		
	Nuk e di	211.08		
Atmosfera në familje	Më pak se një orë	234.50	12.215	.007
	2-3 orë në ditë	212.34		
	Më shumë se 3 orë	175.12		
	Nuk e di	190.81		

Analiza Kruskal-Wallis (Tabela 41) ka nxjerrë në pah vlera të rëndësishme statistikore për tre faktorë. Mbikëqyrja ndaj fëmijëve ($p=.000$) në analizën e mëtejme post hoc Tukey HSD testit, tregoi dallime të vlefshme statistikore ndërmjet gati të gjitha nëngrupeve. Po ashtu edhe faktori Qëndrimi kritikues ndaj fëmijëve ($p=.005$), pas analizës post hoc tregoi që dallimet ndërmjet nëngrupeve janë në pothuajse të gjitha nëngrupet me njëra-tjetrën.

Ndërkohë faktori Atmosfera në familje ($p=.007$), përmes post hoc analizës ofroi vlera statistikisht të vlefshme vetëm ndërmjet nëngrupeve “më pak se një orë në ditë” me nëngrupin “më shumë se 3 orë në ditë”. Nëngrupet e tjera nuk treguan dallime statistikisht të vlefshme.

KAPITULLI VI: ANALIZA 3

PREZANTIMI I ANALIZAVE TË PYETËSORIT PËR MËSIMDHËNËSIT

Pyetësi për mësimdhënësit ka përmbajtur gjithsej 4 variable, që kanë prezantuar karakteristikat e grupit të mostrës sonë dhe 40 variable (items), përmes të cilave janë mbledhur perceptimet e mësimdhënësve mbi ndikimin e familjes në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek nxënësit e klasave të teta dhe të nënta.

Me 40 variablet u zhvillua analiza faktoriale eksploruese sipas metodës së Komponentëve Kryesore dhe rotacionit (ortogonal) VARIMAX [meqenëse të dhënat tona janë intervale]. Vlerat e testit KMO and Bartlett's Test [Kaiser-Meyer-Olkin Measure of Sampling Adequacy = .567; dhe Bartlett's Test of Sphericity Sig= .000), na treguan që analiza faktoriale është valide dhe eksploruese.

Përmes procedurës faktoriale variablet manifeste janë kondensuar dhe si rrjedhim janë fituar 10 faktorë latentë. Në varësi të variableve që kanë përbërë secilin faktor, 10 faktorët/komponentët janë emëruar, si:

- Ballafaqimi me situata të dhunshme
- Mbikëqyrja e dobët e familjes
- Prezenca e dhunës në familje
- Gjendja ekonomike e familjes
- Lojërat e dhunshme dhe interneti

Duke pasur parasysh që tema e punimit është e lidhur drejtpërdrejtë me familjen dhe ndikimin e saj në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek nxënësit e klasave të teta dhe të nënta, në analizat e

mëtejme janë përfshirë vetëm faktorët të cilët na mundësojnë që të trajtojmë këtë temë më tej.

Këta faktorë janë:

1. Ballafaqimi me situata të dhunshme
2. Mbikëqyrja e dobët e familjes
3. Prezenca e dhunës në familje
4. Gjendja ekonomike e familjes
5. Lojërat e dhunshme dhe interneti

Tabelat në vazhdim paraqesin vlerat e mesatares aritmetike dhe të devijimit standard për secilin faktor sipas karakteristikave të prindërve pjesëmarrës në hulumtim.

Tabela 42-Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas arsimimit– Pyetësi për mësimdhënësit, paraqet vlerat e mesatares aritmetike dhe të devijimit standard për faktorët që ndikojnë në sjelljet e dhunshme tek nxënësit sipas opinionit të mësimdhënësve. Siç shihet nga tabela, shumica e faktorëve kanë treguar vlera më të larta të mesatares aritmetike për mësimdhënësit me nivel arsimimi të Shkollës së Lartë Pedagogjike.

Tabela 42

Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas nivelit të arsimimit – Pyetësi për mësimdhënësit

Faktorët	ShLP		Fakultet		Master	
	MA	SD	MA	SD	MA	SD
Ballafaqimi me situata të dhunshme	2.70	0.56	2.59	0.57	2.17	0.72
Mbikëqyrja e dobët e familjes	2.65	0.49	2.59	0.62	2.25	0.75

Prezenca e dhunës në familje	2.70	0.56	2.54	0.55	2.17	0.39
Gjendja ekonomike e familjes	2.39	0.66	2.50	0.58	2.42	0.79
Lojërat e dhunshme dhe interneti	2.39	0.58	2.54	0.55	2.42	0.79

Meqenëse në grupin tonë të mësimdhënësve, vetëm një prej tyre është me nivel arsimor Doktoraturë, të dhënat e tij nuk janë paraqitur më lart. Po ashtu, në mënyrë që të zhvillohet testi post hoc Tukey HSD, duhet që një grup t'i ketë të paktën dy raste. Për këtë arsye, niveli i arsimimit – doktoraturë, nuk është përfshirë as në analizat e mëtejme.

Tabela 43

Dallimet sipas nivelit të arsimimit të mësimdhënësve

Faktorët	Niveli i Arsimimit	Mean Rank	Chi-Square (df 2)	Sig.
Ballafaqimi me situata të dhunshme	ShLP	62.39	6.208	.045
	Fakultet	56.83		
	Magjistraturë	38.50		
Mbikëqyrja e dobët e familjes	ShLP	59.41	2.836	.242
	Fakultet	56.95		
	Magjistraturë	43.42		
Prezenca e dhunës në familje	ShLP	64.43	7.505	.023
	Fakultet	56.45		
	Magjistraturë	37.00		
Gjendja ekonomike e familjes	ShLP	52.61	.425	.809

	Fakultet	57.03		
	Magjistraturë	56.00		
Lojërat e dhunshme dhe interneti	ShLP	50.43	1.216	.544
	Fakultet	57.82		
	Magjistraturë	55.17		

Rezultatet nga analiza Kruskal-Wallis, të paraqitura në tabelën e mësipërme (43), tregojnë që për faktorin “Ballafaqimi me situata të dhunshme” ekzistojnë dallime të vlefshme statistikore në nëngrupet që prezantojnë nivelin e arsimimit të mësimdhënësve ($p = .045$). Po ashtu, kjo analizë ka nxjerrë vlera të rëndësisë statistikore edhe për faktorin “Prezenca e dhunës në familje” ($p = .023$). Për të përcaktuar se cilët prej grupeve dallojnë statistikisht mes tyre, u zhvillua analiza post hoc Tukey HSD, rezultatet e së cilës treguan që dallimet janë të vlefshme statistikisht për të dy faktorët, vetëm në grupin e mësimdhënësve me SHLP me mësimdhënësit me Magjistraturë.

KAPITULLI VII

Diskutimi

Mbështetur në informacionet e mbledhura nga nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit, ky kapitull ofron diskutimin e rezultateve për ndikimin e faktorëve familjarë në sjelljet e dhunshme tek nxënësit adoleshentë në shkollat e mesme të ulëta në Prishtinë, dallimet gjinore dhe krahasimet në vendet rurale-urbane në Prishtinë.

Në studim janë përdorur pyetësorët, ku vlerat për pyetësorin për nxënësit janë në nivele të larta si për vajzat, për djemtë, ashtu edhe për të gjithë nxënësit e përfshirë në hulumtim. Edhe vlerat e fituara nga pyetësorët për mësimdhënësit dhe prindërit, tregojnë që pyetësorët mund të konsiderohen mjaft të besueshëm në vlerësimin e dhunës dhe ndikimet në të tek nxënësit adoleshentë.

Opinionit i nxënësve mbi ndikimin e faktorëve familjarë për sjellje të dhunshme në shkollë

Në përputhje me pyetjen kërkimore dhe hipotezat e hulumtimit, për gjininë, moshën dhe vendbanimin u zhvillua testi i hi-katrorit. Vlerat e fituara përmes testit *chi-square*, $\chi^2(1) = .099$, $p = .754$, treguan që nuk ka dallime të vlefshme statistikore ndërmjet djemve dhe vajzave pjesëmarrës në hulumtim. Për moshën, vlerat e fituara të *chi-square*, $\chi^2(2) = 42.137$, $p = .000$, treguan dallime të vlefshme statistikore në numrin e nxënësve 13, 14 dhe 15 vjeçarë. Dallime të vlefshme statistikore kemi edhe për vendbanimin [$\chi^2(1) = 53.459$, $p = .000$].

Rezultatet e ofruara nga ky studim janë në përputhje me shumë hulumtime të tjera të zhvilluara në vende të ndryshme, përkundër disa të tjerëve që edhe nuk janë në përputhje me të dhënat e dala nga ato hulumtime. Rezultatet e hulumtimit tonë mund të jenë të një rëndësie të madhe mbi bazën shkencore, ngase ato rezultate flasin për ndikimin e faktorëve familjarë mbi edukimin e

fëmijëve dhe rëndësinë e familjes për sjellje sociale të fëmijëve. Studimet e kryera nga OBSH tregojnë mbi gjendjen reale nëpër vende të ndryshme të botës për dhunën dhe keqtrajtimin e fëmijëve në familje, e që një gjendje të tillë e tregojnë edhe të dhënat tona nga rajoni, që kanë kryer shumë organizata në nivel regjioni mbi dhunën që ushtrohet ndaj fëmijëve. Studimi i OBSH-së mbi dhunën ndaj fëmijëve raporton statistika me vlera të larta të ushtrimit të dhunës ndaj fëmijëve në botë.

Instituti Kombëtar i Drejtësisë në Shtetet e Bashkuara ka konstatuar se një fëmijë që është abuzuar në fëmijëri ka më shumë gjasa për 53%, se një fëmijë normal, të arrestohet. Hulumtimi i kryer nga Qendra e Trajtimin Multidisiplinor për Problemet e Keqtrajtimin të fëmijëve (2003), raporton, se 11% e fëmijëve kishin pasur ngacmime seksuale dhe 4% e tyre i kishin përjetuar ato në mjedisin familjar; 4% e fëmijëve pranuan përjetimin e dhunës seksuale. Pra të dhënat që dolën nga hulumtimi përkohë me ato të terrenit, ngase nxënësit raportuan për qëndrimin ndëshkues të familjes, kur nxënësi gabon, e shprehur me vlerën $p=.008$. Kjo tregon se në familje ende si mjet edukimi përdoren forma të dhunës fizike ndaj fëmijëve, derisa vlerat e dala tregojnë sinjifikancën për këtë si faktor i rëndësishëm. Sipas teorisë së dhunës në familje, familja shihet si një arenë ku sjellja e dhunshme mësohet dhe transmetohet nëpër breza, duke pasur cikle dhune brenda familjeve (INSTAT, 2013:61). Analiza faktoriale tregoi vlera sinjifikante për qëndrimin ndëshkues të familjes, kur nxënësi gabon e shprehur me vlerën $p=.008$, që doli nga opinioni i nxënësve.

Në nivelin ndërkombëtar ekzistojnë shumë hulumtime, nga të cilët faktorët familjarë shihen si të mundshëm që ndikojnë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme. Hulumtimi ynë përputhet me rezultatet e dala nga hulumtimi i kryer në Kenia. Ndër faktorët kryesorë të perceptuar në shtëpi që lidhen me familjen e që janë në interes edhe të temës sonë, dolën të dhëna që tregojnë harmoni në mes të faktorëve, si: lidhja e dobët në mes të prindërve dhe fëmijëve; mënyra e disiplinimit të

fëmijëve në shtëpi; prindërit e dhunshëm; ekspozimi ndaj filmave të dhunshme dhe niveli i ulët i mbikëqyrjes në shtëpi (O. Agak and Eric K. Kabuka.(2011), Perceived Home Factors Contributing to Violent Behaviour among Public Secondary School Students in Western Province, Kenia, JETERAPS, ISSN: 2141-6990, 30-40).

Sipas WHO (2001) është raportuar se 10-50 % e grave raportuan se kanë përjetuar dhunë fizike nga partnerët e tyre. Këto gjetje përkojnë edhe me të dhënat në regjion, siç është raporti nga INSTAT "Dhuna në familje në Shqipëri" (2013), ku gjetjet tregojnë se 57.7 e grave shqiptare kanë raportuar se janë dhunuar fizikisht dhe se në zonat rurale dhuna ishte më e theksuar.

Raporti i UNICEF " Dhuna ndaj fëmijëve në Shqipëri"(2006), sjell të dhëna për ushtrimin e dhunës ndaj fëmijëve, ku prindërit e shohin si mjet efektiv përdorimin e dhunës në disiplinimin e fëmijëve. Statistikat në nivel të regjionit lidhen me dhunën e ushtruar nga partnerët, këtë model e shprehin si opsion në raportin e lartpërmendur, sepse ata dhunën e konsiderojnë si mjet për zgjidhjen e problemeve. Gjatë edukimit në këtë mënyrë brutale, në psikikën e fëmijëve modelohen modele të dhunës për zgjidhjen e problemeve. Më vonë edhe këta fëmijë mund të kenë gjasa ta përdorin këtë mënyrë si mjet për zgjidhjen e problemeve. Farrington (1989), gjeti se stili i prindërve autoritarë, mbikëqyrja e dobët e prindërve, disiplina e ashpër ndaj fëmijëve ndikon për të pasur dhunë të mëvonshme tek fëmijët.

Nga hulumtimi Siguria në Shkolla (2007) i kryer në Prishtinë dolën të dhëna që janë në harmoni me gjetjet e punimit tonë, po në të njëjtin qytet vetëm se hulumtimi ynë është edhe krahasimtar rural-urban. Këto të dhëna të dala nga ky hulumtim tregojnë se faktorët familjarë dhe atmosfera, ku fëmija edukohet, mund të ndikojë në sjelljen e fëmijës, të cilët shfaqin sjellje të dhunshme në shkollë. Ata vetë janë të ekspozuar ndaj dhunës në shtëpi. Analizat e zhvilluara mund t'i japim përgjigje pyetjes sonë kërkimore, se faktorët familjarë dhe familja ndikojnë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek adoleshentët. Në literaturën e gjerë, gjejmë se edhe faktorët e tjerë

tregojnë shanse për ndikim në sjelljet e nxënësve adoleshentë, por që në fokus të temës sonë janë faktorët familjarë. Andaj rezultatet e hulumtimit tonë janë në harmoni me një mori studimesh të cekura më lart, ose edhe ato në nivel vendi, siç është Manuali për Parandalimin e Dukurive të Dhunshme nga MASHT (2013), që tregojnë të dhëna se fëmijët që janë rritur si dëshmitarë të dhunës në familje kanë mundësi të bëhen adoleshentë të dhunshëm.

Nëse i referohemi edhe hulumtimeve të tjera në vend mbi faktorët familjarë dhe rëndësinë e tyre në ndikimin e sjelljeve të fëmijës në shkollë, po ashtu UNICEF (2007), raporton të dhëna të dala nga terreni se atmosfera në shtëpi, marrëdhëniet në mes të anëtarëve në familje, mbikëqyrja e dobët e fëmijëve, dënimet e rënda ndaj fëmijës, konfliktet në mes të prindërve në fëmijërinë e hershme, niveli i ulët i besueshmërisë në mes të fëmijës dhe prindit si dhe faktori socio-ekonomik u treguan si faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme të fëmijëve. Nëse i referohemi studimeve të vendeve që na rrethojnë edhe ato flasin për një gjendje të përafërt të faktorëve familjarë dhe dhunës në familje. Thënë më me detaje pothuajse të gjitha vendet e Ballkanit, në dy deri tri dekadat e fundit kanë kaluar nëpër situata politike të rënda, duke përfshirë luftëra dhe tranzicione të shpejta e, të gjitha këto bëjnë që edhe shkalla e ekonomisë mund të mbetet e ulët, e cila ndikon në krijimin ose jo të marrëdhënieve të shëndosha në familje, pra edhe në ulje të dhunës në përgjithësi në shoqëri. Rezultatet e hulumtimeve të kryera në shkollë, në njëfarë mënyre, janë edhe pasqyra se si po zhvillohen shteti dhe shoqëria në tërësi. Save the Children (2007), nxori raporti me të dhëna që flasin për një shkallë të lartë të dhunës. Sipas tij, 27.7% e prindërve dhe mësuesve pajtohen që ndëshkimi fizik duhet të përdoret si mjet disiplinim. Zuna (2008), potencon se fëmijët kur të rriten modelojnë format e tyre të edukimit në fëmijëri, pra mund të bëhen abuzues në të ardhmen. Studime të shumta kanë raportuar se dhuna në familje ka një efekt determinues në sjelljet e fëmijës (Baldry, A.C., 2003).

Sipas Zaplluzha (2016), gjetjet treguan se opinioni ishte i përbashkët midis nxënësve dhe mësimitdhënësve për faktin, se dhuna në familje dhe familja e çorganizuar janë shkaktarë dhe shpjegojnë sjelljet e dhunshme të fëmijëve dhe adoleshentëve.

OBSH raporton se rreth një e treta e fëmijëve raportuan se kishin përjetuar dhunë fizike, ku meshkujt kanë dy ose tre herë më shumë gjasa sesa femrat të kenë qenë të dhunshëm. Sipas hulumtimit “Dhuna ndaj fëmijëve në Shqipëri”(2007) se 80% deri 98% e fëmijëve vuajnë nga ndëshkimi fizik në shtëpitë e tyre. Këto të dhëna tregojnë një gjendje jo të mirë të qasjes së edukimit ndaj fëmijëve, se format e edukimit janë të dhunshme. Ato janë në harmoni edhe me gjetjet e hulumtimit tonë mbi disiplinimin e fëmijëve adoleshentë.

Zhvillimi i shëndoshë në fëmijëri si dhe rrethimi i këtij zhvillimi nga situata normale, pa dhunë, mund të jetë një parakusht që fëmija të ketë sjellje sociale, kurse gjetje që janë në përputhje me hulumtimin tonë janë ato të Elliot,1994 se individët që janë ekspozuar ndaj dhunës në nivele të larta në mes të prindërve të tyre, ishin më të dhunshëm kur janë rritur. Se a modelojnë fëmijët nga prindërit këtë mënyrë sjelljeje është edhe hulumtimi i kryer në Amerikë (2000) e që tregon se adoleshentët priren të jenë depresivë nga imitimi i modeleve të prindërve në familje.

Qendra Kosovare për Studime Gjinore raporton se meshkujt janë ata që ushtrojnë më shumë dhunë. Në kontekst ndërkombëtar dhe vendor jepen hipoteza dhe prezantohen shumë gjetje nga hulumtimet, se gjinia mashkullore ushtron më shumë dhunë fizike sesa gjinia femërore (Myers, 2003). Nëse i referohemi rishikimit të literaturës, djemtë dhe vajzat e përfshira në sjellje të dhunshme janë impulsive, kanë aftësi të ulëta për të kontrolluar veten dhe janë një shkallë të lartë frustrimi (Baldry & Farrington, 2000). Gjithashtu, Craig dhe të tjerë (2009) ofruan dallime statistikisht të rëndësishme midis djemve dhe vajzave. Patterson De Baryshe dhe Ramsey(1989) dhe Patterson et al., (1992) kanë hulumtuar praktikat prindërore në familjet antisociale, ku djemtë kanë treguar sjellje të ngjashme me stilin e modelimit në fëmijërinë e hershme. Stela

Karaj (2014) gjeti në hulumtimin e saj se djemtë përfshihen më shumë se vajzat në sjellje devijante në klasë.

Raporti nga KIPRED (2013), thekson se ka një tendencë më të madhe të ushtrimit të dhunës ndaj gjinisë mashkullore, ku si rrjedhojë, gjinia mashkullore është tri herë më shumë objekt i dhunës sesa gjinia femërore. I njëjti studim tregon se vajzat në këtë moshë, për shkak të edukimit ende patriarkal në familje, janë më të tërhequra dhe më të prirura për të respektuar rregullat dhe përgjegjësitë shkollore, andaj ndaj tyre merren më pak veprime represive.

Sipas Giddens ka dallime në mes të meshkujve dhe femrave, për sa i përket përfshirjes në rastet e dhunës. Përfshirja e gjinia femërore është në shkallë më të vogël sesa ajo e gjinisë mashkullore (Giddens, 2007:146).

“Studimet e Campbellit dhe të Carlenit tregojnë se dhuna nuk është ekskluzivisht karakteristike e kriminalitetit të meshkujve, por që gratë janë shumë më pak të prirura se burrat për të marrë pjesë në krimin e dhunshëm.”(Giddens 2007:148).

Përfundimet e studimit tonë janë të ndryshme nga përfundimet e arritura në këto studime. Megjithatë, këto rezultate janë në përputhje me rezultatin e autorit Zaplluzha (2016), në të cilin nuk ka dallime në shkallën e viktimizimit kur gjinia trajtohet si një ndryshore. Në fakt, nëse merret parasysh fakti se Kosova është një vend në tranzicion dhe pritjet e sjelljes gjinore janë nën presion, për të ndryshuar rolet e tyre sociale, pritshmëri të tilla sociale janë sfiduese dhe të ofrojnë hapësirë për studime të mëtejshme. Meqë studimi është bërë në Kosovë, rezultatet e studimit tonë përforcojnë një gjetje të tillë dhe në të njëjtën kohë përforcojnë nevojën për studime më të gjera dhe më përfshirëse për të argumentuar gjetjet.

Nga analiza faktoriale dhe interpretimi që i është bërë të dhënave statistikore, doli se dallimet janë të vlefshme statistikisht vetëm në faktorët: Marrëdhëniet jo të qëndrueshme në familje dhe gjendja ekonomike, e prezantuar me vlerën $p=.0381$ dhe Qëndrimi ndëshkues i familjes, kur

nxënësi gabon me vlerë $p=.008$. Në të dy faktorët, janë femrat ato që kanë treguar vlera më të larta se sa meshkujt. Të gjithë faktorët e tjerë nuk kanë treguar ndryshime të vlefshme statistikore. Meqë nuk është gjetur apo treguar ndonjë dallim-ndryshim statistikor në mes të gjinisë femërore dhe mashkullore, atëherë hipoteza jonë që mund të ketë dallime në mes të gjinive bie edhe pse gjetje nga shumë hulumtime argumentohen nga nxënësit pjesëmarrës, që ka dallime në mes të gjinive krahas dhunës që ushtrojnë ndërsa tek ne nuk dolën dallime, meqë faktorët familjarë paskan ndikim të njëjtë tek dy gjinitë e meqë nuk dolën dallime në mes tyre.

Në ndryshoren e moshës së fëmijëve kemi tre mosha të paraqitura, si rrjedhim analiza më e përshtatshme për të parë dallimet ndërmjet tre grupeve është Kruskal Wallis Test. Rezultatet e testit Chi-square për shkallë të lirisë 2 sipas vlerave të rëndësisë statistikore, tregojnë që nuk ka dallime të vlefshme statistikisht ndërmjet nxënësve të moshave të ndryshme, sepse kjo moshë me të cilën është bërë hulumtimi, tregon për adoleshencën e hershme e që ndoshta nuk pritej që edhe te ketë ndryshime.

Opinionet e nxënësve, krahas faktorëve familjarë dhe analizës faktoriale, gjetën se dallimet janë të vlefshme statistikisht vetëm në faktorët: Prezenca e dhunës në familje nga prindërit dhe vëllezërit më të mëdhenj, e prezantuar me vlerën $p=.007$ dhe frika ndaj prindërve $p=.004$. Në të dy faktorët, janë prindërit që jetojnë së bashku ata që kanë treguar vlera sinjifikante. Të gjithë faktorët e tjerë nuk kanë treguar ndryshime të vlefshme statistikore. Nëse i analizojmë të dhënat demografike del që prindërit, të cilët jetojnë së bashku, ushtrojnë më shumë dhunë në familje. Po kështu edhe komunikimi i tyre nuk është adekuat, meqë u dha opinionin se frikësohen nga prindërit, ngase si mjet për disiplinim përdoren format e ashpra të dhunës ndaj fëmijës.

Nxënësit e anketuar dhe opinionin e tyre përkon me të dhëna të shumta por që dallimet janë të vlefshme statistikisht vetëm në faktorët: Mbikëqyrja e familjes, e prezantuar me vlerën $p=.016$ dhe Frika ndaj prindërve e shprehur me vlerën $p=.010$. Në të dy faktorët, janë treguar vlera

sinjifikante kur babai punon. Të gjithë faktorët e tjerë nuk kanë treguar ndryshime të vlefshme statistikore. Duke u mbështetur në hulumtimin e Kenias dhe të tjera, që rezultuan se faktori ekonomik është i një rëndësie të veçantë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek nxënësit, sepse ky faktor mund të jetë faktor stabiliteti për familjen dhe rrethanat e familjes, e këtu del që nëse babai punon fëmijët nuk mbikëqyren, ose edhe frikësohen nga prindërit.

Karakteristikë e familjes patriarkale është se babai është menaxheri dhe mbikëqyrësi i shtëpisë për nga hierarkia në familje. Të dhënat flasin për një harmoni të gjetjeve me hulumtimin e Kacollja (2015), se mënyrën e mbikëqyrjes së familjes, që tregon ende dominancë të babait si dhe frike ndaj prindërve e jo komunikim adekuat. Mungesa e mbikëqyrjes së familjes është një nga përcaktuesit e fortë të kriminalitetit (Farrington, 1995; Loeber & Stouthamer-Loeber, 1986, Olweus, 1980) dhe dhunës tek fëmijët. Kjo rezulton në atë se fëmijët duhet të mbikëqyren nga familja dhe të krijohen mënyra të ndryshme të komunikimit edhe pse për moshën e adoleshencës janë të papranueshme nga fëmijët dhe mund të jenë faktorë të mundshëm të shfaqjes së sjelljeve të dhunshme për të dy faktorët.

Të dhënat tregojnë se fëmijët ndihen më shumë të mbikëqyrur nga babai (patria) dhe frikohen nga ai. Rezultatet tregojnë që vetëm për faktorin e parë, marrëdhëniet jo të qëndrueshme në familje dhe gjendja ekonomike ekzistojnë dallime të vlefshme statistikore në nëngrupet që prezantojnë nivelin e arsimimit të nënës ($p = .009$). Për të përcaktuar se cilët prej grupeve dallojnë statistikisht mes tyre, u zhvillua analiza post hoc Tukey HSD, rezultatet e së cilës treguan që dallimet janë të vlefshme statistikisht vetëm në grupin e nënave me arsim fillor me ato me arsim të mesëm dhe ndërmjet nënave me arsim fillor dhe atyre me fakultet. Grupet e tjera nuk kishin dallime të vlefshme statistikore. Dallimet statistikore tregojnë se nënat me sa më pak arsimim që kanë, priren të kenë mundësinë të mos jenë të punësuar, e që faktori ekonomik në familje mund të ketë ndikim në krijimin e marrëdhënieve të qëndrueshme në familje. Po ashtu,

nga të dhënat del ose shihet si faktor i mundshëm ai ekonomik në dallimin në mes të nënave me arsim fillor të mesëm dhe me fakultet, ku dallimet mund të jenë ngase supozohet se sa me shumë që të jenë të arsimuar prindërit, aq më shumë dhuna mund të jetë në rënie, ngase mënyrat e edukimit të prindërve mund të kenë mendime për forma edukimi dhe mirëkuptimi pa dhunë.

Me vlera sinjifikante ishte edhe faktori: prezenca e dhunës në familje nga prindërit dhe vëllezërit më të mëdhenj ($p = .000$) ekzistojnë dallime të vlefshme statistikore në nëngrupet që prezantojnë kohën e kaluar në internet. Duke analizuar të dhënat shihet rëndësia e edukimit të fëmijës në familje e, që po thuajse të gjitha hulumtimet si në nivel regjioni ashtu edhe ndërkombëtar e shohin prezencën e dhunës në familje si shkaktar të mundshëm që adoleshentët të sillen dhunshëm. Edmond Dragoti thekson se në edukimin e fëmijëve në adoleshencë, përpos prindërve dhe familjes, adoleshentët krijojnë marrëdhënie edhe më shumë me bashkëmoshatarët e tyre. Në këtë fokus mund të jenë edhe vëllezërit edhe motrat, por në qoftë se ata e shohin si dhunë nga ata, atëherë këtu tregohet një ndërlidhje e ngushtë për nga hierarkia në familje, e kjo është tipar i familjes patriarkale për kontroll të më të vegjëleve.

Dallimet tregojnë se janë të rëndësishme, për sa i përket kohës së kaluar në internet, ku shumë hulumtime tregojnë se qëndrimi i gjatë në internet shkoqit lidhjet dhe komunikimin verbal, i cili është parakusht për sjellje sociale në mes të anëtarëve në familje. Sipas Anika Woolfook (2011), shumë hulumtime tregojnë se qëndrimi i gjatë në internet krijon mundësi për lojëra të dhunshme e ,që fëmijët edhe modelojnë apo frymëzohen emocionalisht për skena asociale. Këto lojëra të dhunshme mund të rrisin shanset për shfaqje të sjelljeve të dhunshme.

Për të përcaktuar se cilët prej grupeve dallojnë statistikisht mes tyre, u zhvillua analiza post hoc Tukey HSD, rezultatet e së cilës treguan që dallimet janë të vlefshme statistikisht në të gjitha nëngrupet, përveç në nëngrupin e parë kur koha e kaluar në internet ishte më pak se një orë. Dallimet kanë rëndësi sepse sa më pak që qëndron në internet fëmija gjasat për sjellje të

dhunshme janë më të vogla. Nga ana tjetër opinioni i nxënësve tregoi se prania e dhunës dhe vëllezërve më të mëdhenj, shihet si faktor rreziku që edhe këta të bëhen të dhunshëm. Po ashtu, dallime statistikisht të vlefshme ndërmjet nëngrupeve të përcaktuara tregoi edhe faktori Frika ndaj prindërve ($p = .053$). Nga variabellet demografike, siç është koha se sa qëndrojnë nxënësit në internet, mund të rezultojë në gjetje të rëndësishme, ngase dallimet ishin në mes të nxënësve që dhanë opinionin se qëndrojnë më pak se një orë në ditë por nuk e dinë se sa qëndrojnë. Analiza post hoc Tukey HSD, tregoi që dallimet janë të vlefshme statistikisht, kryesisht në nëngrupet e skajshme (më pak se një orë / nuk e di). Vlen për diskutim një gjetje e tillë, pasi mbikëqyrja e prindërve për kohën e kaluar në internet nga fëmijët po del që është e rëndësishme, përkundër qasjes se fëmijët po raportojnë se nëse mbikëqyren nga ata, koha e kaluar në internet del më pak se një orë. Ndërsa fëmijët që kanë frikë nga prindërit del që qëndrojnë më shumë dhe nuk mbikëqyren prej tyre.

Këtu mund të vërehet edhe një detaj i rëndësishëm, që është në harmoni me gjetjet e hulumtimit të Kacollja (2015), e cila raportoi se mënyra e komunikimit të prindërve dhe fëmijëve mund të jetë njëri ndër faktorët që paraqitet si shkaktare për shfaqje të sjelljeve të dhunshme në adoleshencë. Po ashtu, variablat e familjes, duke përfshirë cilësinë e marrëdhënieve fëmijë-prind, aftësitë prindërore si dhe komunikimin mes tyre, raportuan edhe gjetjet e dala nga studimi i kryer në Britaninë e Madhe, i cili është kryer me adoleshentë 10-16 vjeç. Këto të dhëna rezultuan në adoleshencë të dhunshme, ngase këta fëmijët kishin përjetuar dhunë në familje dhe, për rrjedhim, 59% e tyre kishin kryer vepra të dhunshme më vonë.

Analiza Kruskal-Wallis ka nxjerrë vlera të rëndësishme statistikore për faktorin Qëndrimi kritikues i prindërve ndaj fëmijëve ($p = .050$), analiza e mëtejme e post hoc Tukey HSD testit, nuk tregoi dallime të vlefshme statistikore ndërmjet nëngrupeve. Sinjifikanca e këtij faktori tregon se stilet e prindërimit gjatë edukimit kanë rëndësi, ngase edhe mënyra e komunikimit, në njëfarë mënyre

varet nga stili i prindërimit. Gjetjet tregojnë se në kulturën tonë ende përdoren format e ndëshkimit e kjo është në harmoni pothuajse me të gjitha hulumtimet, sepse disiplinimi i fëmijëve bëhet në forma të ashpra. Sipas Dorina Çorrit (Kacollja, 2015), 8.0% e të anketuarve kanë deklaruar se prindërit mendojnë që dhuna ka ndikim në edukimin e fëmijëve. Kurse se a është e rëndësishme mënyra se si komunikojmë dhe prindërimi, të dhënat nga ky hulumtim (Kacollja, 2015) tregojnë se 9.5% e të anketuarve përjetojnë dhunë në familje, për shkak të mosbindjes së tyre nda prindërve.

Analiza Kruskal-Wallis edhe në këtë rast ka nxjerrë vlera të rëndësishme statistikore për faktorin Marrëdhëniet jo të qëndrueshme në familje dhe gjendja ekonomike ($p=.023$). Megjithatë, analiza e mëtejme e post hoc Tukey HSD testit, nuk tregoi dallime të vlefshme statistikore ndërmjet nëngrupeve. Opinioni i të anketuarve pajtohet me atë se marrëdhëniet jo të qëndrueshme në familje dhe gjendja ekonomike shihen si faktorë të mundshëm në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme e që këto të dhëna janë në harmoni me të dhënat nga MASHT rreth faktorëve familjarë si dhe hulumtimet dhe teoritë e shumta që tregojnë të dhëna nga hulumtimet siç është edhe rasti i Kenias. Shkalla e lartë e papunësisë është shkaku kryesor që ndikon në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme të nxënësve në shkollë. Kjo rezulton edhe nga statistikat në Kosove dhe ato të hartuara nga USAID (2007). Raportohet se dhuna në familje vjen nga faktori ekonomik, deklaruar kjo nga gjetjet e Fondacionit të Iniciativës Qytetare.

Pothuajse të gjithë faktorët edhe të lart përshkruar, që dolën nga hulumtimi, kanë një përputhje të dhënash se fëmijët që abuzohen shihen si faktorë që edhe ata do të bëhen të dhunshëm, sepse modelojnë modele të sjelljes abuzive (Kosta,2007), pra, qëndrimin ndëshkues të familjes kur nxënësi gabon ($p =.045$). Ekzistojnë dallime të vlefshme statistikore në nëngrupet që prezantojnë kohën e kaluar në ditë me familjen. Për të përcaktuar se cilët prej grupeve dallojnë statistikisht mes tyre, u zhvillua analiza post hoc Tukey HSD, rezultatet e së cilës treguan që dallimet janë të vlefshme statistikisht vetëm në nëngrupet: nuk e di dhe 2-3 orë në ditë. Për të gjitha nëngrupet e

tjera, dallimet nuk kishin vlerë statistikore. Vlera statistikore kanë treguar grupet të cilat qëndrojnë apo ndajnë kohën më të madhe në familje, ka të ngjarë që ata të jenë më pak të prirur sipas opinionit të tyre për gabime, përkundër atyre që qëndrojnë jashtë familjes kohë më të gjatë. Ata mund të ndëshkohen më lehtë kur fëmija gabon.

7.3. Opinioni i mësimdhënësve rreth ndikimit të faktorëve familjarë dhe familjes në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme të nxënësve në shkollë

Sipas statistikave në Kosovë përgatitur nga UNICEF 2013/2014, krahasuar me gratë dhe vajzat e rajonit dhe nëpër botë, del që në Kosovë femrat kanë tolerancë mjaft të lartë ndaj dhunës fizike, duke lënë pas në mënyrë mjaft të ndjeshme Malin e Zi dhe Serbinë. Ekziston ky realitet edhe pse regjioni qëndron më mirë në krahasim me Kosovën, ku papunësia është shumë e madhe. Është parë e rëndësishme që të merren edhe opinione edhe nga mësimdhënësit rreth faktorëve familjarë, sepse edhe këta në mënyrë të tërthortë japin opinionin e tyre, ngase janë edhe vetë familjarë.

Edhe për pjesëmarrësit mësimdhënës në hulumtim, në përputhje me pyetjen kërkimore dhe hipotezat e hulumtimit për gjininë, moshën dhe vendbanimin u zhvillua testi i hi-katrorit. Vlerat e fituara përmes testit *chi-square*, treguan që ka dallime të vlefshme statistikore ndërmjet mësimdhënësve femra dhe meshkuj [$\chi^2(1)=11.571, p=.000$], si edhe për nivelin e shkollimit [$\chi^2(3)=114.643, p=.000$], dhe vendbanimin [$\chi^2(1)=11.571, p=.000$].

Rezultatet e paraqitura nga analiza Kruskal-Wallis, tregojnë që për faktorin “Ballafaqimi me situata të dhunshme” ekzistojnë dallime të vlefshme statistikore në nëngrupet që prezantojnë nivelin e arsimimit të mësimdhënësve ($p=.045$). Po ashtu, kjo analizë ka nxjerrë vlera të rëndësishme statistikore edhe për faktorin Prezenca e dhunës në familje ($p=.023$). Për të përcaktuar se cilët prej grupeve dallojnë statistakisht mes tyre, u zhvillua analiza post hoc Tukey HSD, rezultatet e së cilës treguan që dallimet janë të vlefshme statistakisht për të dy faktorët, vetëm në

grupin e mësimdhënësve me SHLP me mësimdhënësit me Magjistraturë. Në të dy faktorët, analiza e opinionit të mësimdhënësve, shihet se situatat e dhunshme dhe dhuna në familje mund të jenë shkaktarë të shfaqjes së sjelljeve të dhunshme. Rezultatet nuk treguan dallime statistikore të mësimdhënësit për Perceptimet në lidhje me gjininë e tyre. Ndërkohë që ka dallime në perceptimet e tyre për varësinë ndaj nivelit akademik, vetëm dy nga faktorët familjarë që kontribuojnë në sjelljen e dhunshme të fëmijëve. Rezultatet e tilla përcaktojnë nevojën për studime më të thella.

Studimi i kryer në Maqedoni (2008/2009) tregon se fëmijët përjetojnë dhunë nga njerëzit më të rritur e që edhe ky studim, mbi gjendjen në shkollat fillore, e sheh dhunën dhe modelet e dhunës në familje si shkaktarë të mundshëm të shfaqjes së sjelljeve të dhunshme. Nëse i analizojmë këta faktorë në kontekstin e vendit tonë, shihet se edhe këtu rezultojnë, se dhuna dhe ushtrues të dhunës janë njerëzit e afërt dhe djemtë janë më të rrezikuar nga dhuna fizike, kurse vajzat nga keqpërdorimi verbal (MASH-T-UNICEF, 2009-2018).

Rezultojnë dallime statistikisht të rëndësishme në mes të mësimdhënësve me shkollë të Lartë Pedagogjike dhe atyre me Magjistraturë. Në varësi të nivelit të arsimimit, shanset e edukimit për sjellje sociale janë më të mundshme dhe më të mira. Sipas Zaplluzha (2016), gjetjet treguan se në opinionin e mësimdhënësve faktorët si dhuna në familje dhe familja e çorganizuar, shihen si shkaktarë, të cilët ishin vlerësuar për të shpjeguar sjelljet e dhunshme. Këto gjetje janë në harmoni me të dhënat e punimit tonë.

7.4. Opinioni i prindërve rreth ndikimit të faktorëve familjarë dhe familjes në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme të nxënësve në shkollë

Në përputhje me pyetjen kërkimore dhe hipotezat e hulumtimit për gjininë, vendbanimin, numrin e anëtarëve të familjes, punësimin, u zhvillua testi i hi-katrorit. Vlerat e fituara përmes testit *chi-square*, në të gjitha rastet treguan që ka dallime të vlefshme statistikore ndërmjet nënave dhe baballarëve pjesëmarrës në hulumtim [$\chi^2(1) = 6.578, p = .010$]; prindërve që jetojnë në fshat dhe në qytet [$\chi^2(1) = 254.158, p = .000$]; ndërmjet familjeve me numër të ndryshëm të anëtarëve [$\chi^2(2) = 325.879, p = .000$]; ndërmjet prindërve të punësuar dhe jo të punësuar [$\chi^2(1) = 52.934, p = .000$]. Ka shumë studime, të cilat analizojnë lidhjen midis variablave familjare dhe sjelljes së dhunshme në shkollë dhe që kanë treguar se një mjedis negativ familjar, i karakterizuar nga problemet e komunikimit ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, është një rrezik i rëndësishëm, faktor për zhvillimin e problemeve të sjelljes në adoleshencë (Estevez, Musitu, & Herrero, 2005a).

Lidhur me komunikimin me prindërit, studime të tjera theksojnë se cilësia e komunikimit është e lidhur ngushtë me sjelljen e adoleshentëve dhe përshtatjen psikologjike (Liu, 2003); Në veçanti, komunikimi negativ dhe fyes me prindërit mund të çojë në keqpërdorime të fëmijët (Lambert & Cashwell, 2003). Një ndryshore tjetër është vetë-koncepti i familjes. Një koncept negativ i familjes, i cili, për më tepër, është i lidhur fort me një stil komunikimi negativ të prindërve dhe adoleshentëve (Musitu & Cava, 2001, Musitu & Garcia, 2004), është lidhur me dhunën në adoleshencë (Estevez, Herrero, Martinez, Musitu, 2006). Raportimi nga statistikat e INSTAT (2009), tregojnë gjetjet e rëndësishme, ku theksohet se 61,4% e fëmijëve raportuan se ishin dhunuar fizikisht nga babai, në krahasim me 39,8% e fëmijëve që ishin dhunuar nga nëna. Kishte disa ndryshime të theksuara ndërmjet djemve dhe vajzave, për sa i përket faktit se kush i abuzon ato në shtëpi. Raporti tregon se nga 634 fëmijë të anketuar, në mënyrë të theksuar djemtë

(52,0%) kishin më shumë gjasa sesa vajzat (38,2%) që të dhunoheshin fizikisht nga babai. Sipas hulumtimit “Dhuna ndaj fëmijëve në Shqipëri” (INSTAT 2009) baballarët me arsimim të mesëm ose të ulët kanë më shumë gjasa të jenë të dhunshëm në familje. Përmes analizës faktoriale, nga opinioni i prindërve dolën faktorët që mund të kenë ndikim në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme, të cilat treguan vlerën sinjifikante e, që këtu mund të gjejnë harmoni me të dhënat dhe opinionin edhe të nxënësve me prindërit e tyre, sepse atmosfera në familje dhe ndëshkimi fizik shihen si faktorë të mundshëm të shfaqjes së sjelljeve të dhunshme. Shihet se opinion i fëmijëve është real, ngase format e disiplinimit të tyre edhe nga prindërit pranohen si mjet edukimi. Këto të dhëna përkojnë me hulumtimet në nivel vendi apo edhe regjioni. Nëse i referohemi gjetjeve nga MASHT dhe UNICEF (2007-2009), rreth dhunës ndaj fëmijëve në Kosovë shihet, se këto të dhëna tregojnë se kanë harmoni dhe se dhuna në familje ndikon në sjelljet e fëmijëve të tyre (OSBE, 2013).

Testi Mann-Whitney U, tregoi vlera të rëndësisë statistikore në faktorin Lojërat e dhunshme dhe interneti ($p=.045$) në të cilin prindërit që banojnë në fshat treguan vlera më të larta se sa prindërit që banojnë në qytet. Janë paraqitur vlera të rëndësishme sinjifikante nga prindërit, se lojërat e dhunshme dhe interneti ndikojnë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme, e që edhe këto të dhëna përkojnë me opinionin e fëmijëve të tyre, të cilët e paraqitën si të rëndësishme kohën që kalojnë në internet. Kjo lidhet me faktin se sa më shumë kohë që kalojnë fëmijët në internet, aq më e madhe është mundësia që të mos mbikëqyren dhe, për rrjedhim, ata mund të kenë qasje në lojëra të dhunshme, nga të cilat mund edhe të ndikohen. Zhvillimi i teknologjisë së shpejtë dhe trendi i adoleshentëve tanë për të përdorur teknologjinë në disa mënyra dhe për shumë qëllime, shpesh jo të lidhura ngushtë me përgatitjen e programeve të tyre shkollore ose, ndjekjen e programeve që ofrojnë modele të sjelljes shoqërisht të pranueshme, duke bërë që edhe pse përdorimi i internetit është treguar me një ndikim të rëndësishëm në sjelljen e dhunshme të adoleshentëve, ky ndikim nuk duhet të varet nga vendi ku jetojnë apo mosha e nxënësve. Në

mënyrë të pashmangshme, rezultate të tilla kërkojnë programe parandaluese për sjelljen e dhunshme të nxënësve, që tashmë kanë provuar deri në atë masë që edhe të rinjtë e tyre të sigurojnë përmirësimin e situatës (Ting, 2009).” Edhe faktori Atmosfera në familje ($p=.050$) tregoi dallime ndërmjet prindërve që banojnë në fshat dhe atyre në qytet, me vlera më të larta për prindërit që jetojnë në qytet. Rezultatet e testit Kruskal Wallis, të paraqitura me vlerën e testit Chi-square për shkallë të lirisë 2, sipas vlerave të rëndësisë statistikore, tregojnë që në faktorin Atmosfera në familje ($p=.005$) ka dallime të vlefshme statistikisht në numrin e anëtarëve të familjes. Post hoc analiza Tukey HSD, tregoi që këto dallime janë ndërmjet nëngrupeve të familjeve me tre anëtarë me familjet dhe atyre me 4-6 anëtarë. Nëngrupi për familjet me mbi 6 anëtarë, nuk kishte dallime statistikisht të rëndësishme me asnjë nga nëngrupet e tjera. Këto të dhëna sinjifikante dhe dallimet e rëndësishme statistikore tregojnë se sa më shumë anëtarë që ka në familje, aq më e madhe është mundësia e dhunës. Këtu po flasim për rrethanat, ku faktori ekonomik doli si vlerë sinjifikante për mundësinë e rritjes së sjelljeve të dhunshme. Po ashtu edhe dhuna nga vëllezërit më të mëdhenj është tipar i familjes patriarkale, ku udhëheq gjinia mashkullore. Nëse i referohemi po thuajse të gjithë faktorëve në përgjithësi, duke i analizuar që të tri opinionet e grupeve të pjesëmarrëseve, del që në përgjithësi në familjet kosovare ende mbizotëron familja patriarkale. Mbështetja në faktorët ekonomikë është një mundësi më shumë që në familje të barten ndeshje idesh dhe kundërthëniesh, që bien deri tek dhuna në familje.

Analiza Mann-Whitney U, tregoi dallime të vlefshme statistikore në faktorin Mendimi që ndëshkimi fizik është i nevojshëm ($p=.032$). Vlerat më të larta janë në favor të familjeve që jetojnë së bashku.

Vlerat e analizës Mann-Whitney U, treguan që ka dallime të vlefshme statistikore në faktorin Mendimi që ndëshkimi fizik është i nevojshëm ($p=.004$). Vlerat më të larta janë në favor të familjeve në të cilat prindërit janë të punësuar. Nëse i referohemi literaturës së gjerë, e cila tregon

për kulturën e familjeve në përgjithësi, mund të themi se në familjet shqiptare, pothuajse për breza të tërë ndëshkimi fizik është përdorur si mjet edukimi, por e veçanta e variabëlët demografik të punësimit del se prindërit e punësuar e shohin si mjet disiplinimi përdorimin e dhunës. Opinion e morëm edhe nga fëmijët e tyre.

Te koha e kaluar duke parë televizionin, analiza Kruskal-Wallis ka nxjerrë vlera të rëndësishë statistikore për faktorin Ndëshkimi fizik si formë disiplinimi ($p=.032$). Analiza e mëtejme e post hoc Tukey HSD testit, tregoi dallime të vlefshme statistikore ndërmjet nëngrupeve “më pak se një orë në ditë” me nëngrupin “më shumë se tre orë në ditë”, ku vlerat më të larta janë treguar nga nëngrupi i fundit. Nëngrupet e tjera nuk treguan rëndësi statistikore në dallimet ndërmjet tyre. Është e rëndësishme të analizohen këto gjetje, ngase koha e qëndrimit të gjatë në televizor më shumë se tri orë në ditë, duke e krahasuar me atë me një orë në ditë, tregon se prindërit e shohin si mundësi për rritje të dukurive negative nga televizori ose si modelim për sjellje të papërshtatshme. Këto gjetje, për mundësinë e shfaqjes së sjelljeve të dhunshme, përkohë me hulumtime edhe në nivel botëror (Anika Woolfolk, 2011) që mediat dhe televizioni mund të rrisin sjelljet e dhunshme tek fëmijët.

Pothuajse të gjithë faktorët, të cilët dolën sinjifikant nga opinioni i prindërve, kanë lidhje me opinionin e fëmijëve të tyre, gjë që flet për opinione të mbështetura në bindje reale të tyre, ngase edhe tek fëmijët u gjetën se Atmosfera në familje ($p=.007$), Mbikëqyrja ndaj fëmijëve ($p=.000$) si dhe faktori se Qëndrimi kritikues ndaj fëmijëve ($p=.005$) mund të ndikojnë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme. Mirëpo këtu u gjetën edhe dallime të vlefshme statistikore ngase koha sa me e gjatë që qëndrojnë fëmijët në internet, televizor ose larg familjes krijon mundësinë që prindërit e tyre t’i kritikojnë, kur dihet që në këtë moshë fëmijët, sidomos adoleshentët nuk e pranojnë kritikën, ngase ndryshimet në zhvillimin e tyre janë në kulminacion. Po ashtu, në këtë periudhë fëmijët nuk dëshirojnë të mbikëqyren nga prindërit. Prindërit e tyre e dhanë si opinion

të rëndësishëm që, në qoftë se nuk mbikëqyren, fëmijët mund të kalojnë në situata dhunë, ngaqë mund të ndikojë që edhe atmosfera në familje mund të ndërrojë dhe të ketë ndikim edhe tek ata.

Këto të dhëna nuk kanë bërë ndonjë zbulim të ri, meqë faktorët familjarë, dhuna në familje, marrëdhëniet në mes të prindërve përfliten, dhe janë studiuar me të vërtetë si të mundshëm që mund të ndikojnë në sjelljen e fëmijëve (Hulumtimi në Kenia, 2011) dhe në nivel rajoni (Studim mbi gjendjen initiale me dhunën në shkollat fillore në Maqedoni 2008-2009), të cilat tregojnë se atmosfera në familje, mbikëqyrja e fëmijëve, qëndrimi i prindërve me fëmijët ndikojnë tek fëmijët dhe sjelljet e tyre në shkollë dhe shoqëri.

Ky studim jep mjaft të dhëna të rëndësishme për faktorët familjarë dhe familjen për ndikimin që kanë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme, kurse për studime të mëtutjeshme mbeten edhe shumë çështje, për të cilat propozojmë që të vazhdohen edhe nga studiues të tjerë.

KAPITULLI VIII

PËRMBLEDHJE DHE REKOMANDIME

Të dhënat tona treguan mbi gjendjen dhe sjelljet e dhunshme të nxënësve në shkollë, të cilat u mbledhën përmes pyetësorëve të realizuar me pjesëmarrësit në hulumtim. Nga opinionet e nxënësve, prindërve dhe mësimdhënësve u mbledhën opinione të cilat na ndihmuan që të nxirren shkaktarët dhe ndikimi i faktorëve të sjelljeve të dhunshme të nxënësve në shkollë. Ky studim dha mjaft argumente mbi edukimin e fëmijëve-adoleshentëve në familje dhe shkollë si dhe për ndikimin e faktorëve familjarë në sjelljet e nxënësve në shkollë.

Nga të dhënat e terrenit dolën se faktorët familjarë dhe familja luajnë rol të rëndësishëm në edukimin e fëmijëve për sjellje sociale. Këtu në fokus ishin faktorë të shumtë, nga të cilët mund të veçojmë: Dhuna në familje, stili i prindërimit, familja patriarkale, marrëdhëniet e prindërve në mes veti, por edhe me fëmijët, frika nga prindërit, atmosfera në shtëpi, dhuna fizike si mjet disiplinimi, mbikëqyrja e fëmijëve dhe baza ekonomike, lojërat e dhunshme e shumë faktorë të tjerë që rrjedhin nga familja e, të cilët treguan vlera signifkante.

Gjetjet nga shumë hulumtime dhe praktika citohen si faktorë të mundshëm që ndikojnë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme. Faktorëve familjarë që dolën signifkante për hulumtimin tonë, janë të tillë edhe në nivel botëror. Nga literatura e qëmtuar konstatuam se faktorëve familjarë i kushtohet vëmendje e veçantë në nivel botëror dhe me modesti dhe kënaqësi pohojmë se gjetjet tona të paraqitura në këtë studim përkojnë me gjetjet në nivel botëror.

Nga ana tjetër, nuk mund të mos pohojmë se këto të dhëna janë të hidhura por të domosdoshme për t'i diskutuar, sepse familja me misionin e saj është e shenjtë dhe mundohet që sa më mirë brez pas brezi t'i edukojë fëmijët se si të sillen në shoqëri, por që shpesh herë familjet i përshtaten i socio-kulturës të vendit.

Në të gjitha vendet e botës, për mos funksionim të marrëdhënieve mes fëmijëve dhe familjes mund të fajësohet shoqëria dhe shteti, sidomos në rastet kur nuk zbatohen politika të drejta sociale. Pikërisht te kushtet dhe mundësitë e ofruara fillon edhe mirëqenia e familjeve ose e kundërta e saj.

Gjetjet e këtij hulumtimi sjellin me vete edhe implikimet e tyre praktike, prandaj më poshtë po rendisim disa rekomandime:

Rekomandime për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

- Të hartojë programe të veçanta për ngritjen e vetëdijes shoqërore për edukimin e drejtë të fëmijëve;
- Të hapjen në nivel vendi të këshillimoreve në çdo qytet për konsulta familjare për edukimin e fëmijëve dhe organizimin e familjes (Këshillimoret të udhëhiqen nga pedagogë, psikologë dhe sociologë);
- Në tekstet mësimore-shkollore të futen tema me përmbajtje edukative për parandalimin e sjelljeve të dhunshme të nxënësve;
- Të hartohen programe dhe të përgatiten libra mbi të drejtat dhe liritë e fëmijëve, për t'i futur ato si lëndë shkollore;
- Të organizojë trajnime specifike për aftësitë e komunikimit dhe qasjet bashkëpunuese për udhëheqësit e shkollave, mësimdhënësit dhe prindërit. Përvoja e mirë mund të gjendet në studimet e shumta që kanë sugjeruar ose pasqyruar përfitimet e trajnimeve të tilla (Carter, 2003; Mueller, Singer and Draper, 2008);
- Të organizojë trajnime të vazhdueshme për mësimdhënësit e shkollave, prindërit dhe nxënësit, për përhapjen e programeve parandaluese të sjelljeve të dhunshme në shkolla nga të gjithë aktorët;
- Të bashkëpunojë me shkollat, DKA-të, policinë, qendrat sociale për përcjelljen e rasteve

të dhunës nga nxënësit;

- Të e zbatojë e përhapë programin e SMIA-së për futjen e të dhënave nga udhëheqësit e shkollave, duke i pasqyruar shifrat nëpër shkolla;
- Të hartojë doracakë dhe vetë raportime me njohuri për përkrahjen e viktimave të dhunës në familje si dhe doracakë për prindërit e rinj dhe detyrat prindërore për edukimin e drejtë të fëmijëve.

Rekomandime për Drejtoritë Komunale të Arsimit

- Të organizojë takime të rregullta me udhëheqësit e shkollave për ta njohur gjendjen mbi dhunën në shkolla;
- Të organizojë trajnime për mësuesdhënësit për parandalimin e dhunës në shkolla;
- Të organizojë trajnime me anëtarë të këshillave të prindërve, me qëllim të parandalimit të dhunës.

Rekomandime për Shkollat

- Të punojnë për të siguruar bashkëpunimin e stafit udhëheqës dhe mësues të shkollës, me qëllim të identifikimit të nxënësve me sjellje të dhunshme;
- Evidentimi i shkaqeve dhe faktorëve pse nxënësit shfaqin sjellje të dhunshme si dhe trajtimi i tyre i drejtë me qëllim të evitimit të sjelljeve të dhunshme;
- Të ngulmojnë për të realizim një bashkëpunim të mirëfilltë të shkollës me familjen;
- Të planifikojnë dhe realizojnë takime të rregullta me prindërit;
- Të organizojnë tryeza për dhunën në mes të bashkëmoshatarëve, me qëllim të vetë raportimit të nxënësve për sjelljet e dhunshme.

Rekomandime për Familjen-Prindërit

- T'i ofrojnë përkujdesje prindërore fëmijëve;
- Përmes dashurisë së prindërve dhe marrëdhënieve të mira të arrihet mirëkuptimi në familje;
- Mbikëqyrje dhe përkujdesje ndaj fëmijëve;
- Edukimi dhe komunikimi me fëmijët, duke u mbështetur në vlera demokratike gjithnjë duke ia njohur dhe kuptuar ndryshimet që ndodhin tek fëmijë gjatë zhvillimit të tyre;
- Të mos e përdorin ndëshkimin fizik si mjet disiplinimi;
- Ngritja e vetëdijes së prindërve për edukimin e fëmijëve të tyre pa dhunë;
- Ngritja e vetëdijes së prindërve për përcjellje të vazhdueshme të fëmijëve.

Në bazë të përfundimeve që kemi nxjerrë, rekomandimi ynë i përgjithshëm është:

- Të bëhen hulumtime më të thelluara e që përfshijnë edhe variable të tjerë, si faktorët personalë dhe shoqërorë, që janë të nevojshëm për ta zbardhur më shumë e më gjerë këtë tematikë me interes të madh për familjen, shkollën por dhe shoqërinë në përgjithësi.

LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA

- Acosta, O. M., Albus, K.E., Reynolds, M.W., Spriggs, D., & Weist, M.D. (2001). *Assessing the status of research on violence related problems among youth*. Journal of Clinical Child Psychology, 30, 152–160.
- Anderson, C. A., & Bushman, B. J. (2001). *Effects of violent video games on aggressive behavior, aggressive cognition, aggressive physiological arousal, and prosocial behavior: A meta-analytic review of the scientific literature*. Psychological Science, 12, 353- 359.
- Anderson, C. A., & Bushman, B. J. (2002a). *The effects of media violence on society*. Science, 295, 2377-2378.
- Anderson, C. A., & Bushman, B. J. (2002b). *Human aggression*. Annual Review of Psychology, 53, 27-51.
- Achenbach TM. (1991) *Manual for the child behavior checklist/4-18 and 1991 profile*. University of Vermont Department of Psychiatry, Burlington.
- Adams, G. R., (Summer, 1977), “*Personal Identity Formation: A Synthesis of Cognitive and Ego Psychology*”, Adolescence, 12.
- Adatto CP. (1991), *Late adolescence to early adulthood*. U: Greenspan S, Pollock G, ur. The Course of Life. International Universities Press, 357-75.
- Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2005.
- Bandura A. 1977. *Social Learning Theory*. New York: Prentice Hall
- Baldry, A. C., & Farrington, D. P. (2006). *Individual risk factors for school violence*. In A. Serrano (Ed.), *Acoso y violencia en la escuela* (pp. 107-133).
- BENSON, M., FOX, G. L., (2004), *When Violence Hits Home: How Economics and Neighbourhood Play a Role*, in National Institute of Justice -Research in Brief, September 2004, 1-6.
- Berger, K (1990) *The developing Person, Through Childhood and Adolescence*, New York, Worth Publishers.

- Beveridge, S., (2005) *Children families and school, Developing partnership for inclusive education*, New York
- Bllaca, S, (2016) *IMPACT OF INTERNET AND VIOLENT GAMES ON VIOLENT BEHAVIOR AMONG STUDENTS: DIFFERENCES IN SEX, AGE AND RESIDENCE*, *European Journal of Psychological Research* Vol. 3 No. 1, 2016 ISSN 2057-4794 Progressive Academic Publishing, UK Page 52 www.idpublications.org –Revista
- Boeree, George, (2004) *Teoritë e personalitetit nga Frojdi deri në ditët tona*, Plejad, Tiranë.
- Brada, Riza, (2012) *Pedagogjia*, Universiteti AAB-RIINVEST, Prishtinë
- Centers for Disease Control and Prevention, National Center for Injury Prevention and Control (producer). web-based Injury Statistics Query and Reporting System (WISQARS) [Online]. (2004). Available online from: URL: <http://www.cdc.gov/ncipc/wisqars/default.htm>.
- Centers for Disease Control and Prevention. (2008). *Domestic Violence Prevention Enhancement and Leadership through Alliances (DELTA): Purpose of the program*. Retrieved from <http://www.cdc.gov/ViolencePrevention/DELTA/index.html>
- Craig, W. M., Pepler, D., & Atlas, R. (2000). *Observations of bullying in the playground and in the classroom*. *School Psychology International*, 21, 22–36.
<http://dx.doi.org/10.1177/0143034300211002>
- Centers for Disease Control and Prevention, National Center for Injury Prevention and Control (producer). Web-based Injury Statistics Query and Reporting System (WISQARS)[Online]. (2004). Available online from: URL: <http://www.cdc.gov/ncipc/wisqars/default.htm>.
- Centers for Disease Control and Prevention. (2008). *Domestic Violence Prevention Enhancement and Leadership through Alliances (DELTA): Purpose of the program*. Retrieved from <http://www.cdc.gov/ViolencePrevention/DELTA/index.html>
- Connell, C. M., Cook, E. C., Aklin, W. M., Vanderploeg, J. J., & Brex, R. A. (2011). *Risk and*

protective factors associated with patterns of antisocial behavior among nonmetropolitan adolescents. Aggressive Behavior, 37, 98 – 106.

Dolto Fransuazë, (2003) *Adoleshenti*, Uegen, Tiranë.

Dolto, Francoise, (2013) *Fjalë për Adoleshentët*, Ombra gvg, Tiranë.

Dekovic, M., Janssens, J. M., and van As, N. M. (2003). *Family predictors of antisocial behavior in adolescence. Family Process, 42, 223-235.*

Demiri, Nora, (2007) *Fëmijët flasin-Rreziku dhe mbrojtja në lidhje me trafikimin në Europën Juglindore*, Save the Children, DZG.

Doracak për krijimin e mjediseve të sigurta jo të dhunshme e humane në shoqëri dhe në shkollë, KEC dhe UNICEF, Prishtinë, 2009.

Dragoti, Edmond, (2005) *Adoleshenti*, Tiranë.

Dragoti, Edmond, (1999) *Psikologji Sociale*, Libri Universitar, Tiranë.

Dushku, Qazim, (2011) *Mos i vrisni fëmijët*, Uegen, Tiranë.

Elliott, D. (1994). *Serious violent offenders: Onset, developmental course, and termination. American Society of Criminology 1993 presidential address. Criminology, 32, 1–21.*

Elliott, D., Hamburg, B., & Williams, K. (1998). *Violence in American schools*. Cambridge: Cambridge University Press.

Espelage, D. L., & Swearer, S. M. (2003). *Research on school bullying and victimization: What have we learned and where do we go from here? School Psychology Review, 32, 365–383.*

Estévez, E., Musitu, G., & Herrero, J. (2005a). *The influence of violent behavior and victimization at school on psychological distress: the role of parents and teachers. Adolescence, 40, 183-195.*

Estévez, E., Herrero, J., Martínez, B., & Musitu, G. (2006). *Aggressive and non-aggressive rejected students: an analysis of their differences. Psychology in the Schools, 43, 387 400.*

- FELIX, E. D.; MCMAHON, S. D., (2007), *The Role of Gender in Peer Victimization Among Youth: A Study of Incidence, Interrelations, and Social Cognitive Correlates*, in Journal of School Violence, 6(3), 27-44.
- FUCHS, M., (1995a), *Waffenbesitz bei Kindern und Jugendlichen*, in ALEMANN, H. v., Ed., Lebenschancen und Lebensrisiken in der neuen Bundesrepublik. Opladen: Leske + Budrich, 103-120.
- Farrington, D. P. (1989). *Early predictors of adolescent aggression and adult violence*. Violence and Victims, 4, 79–100.
- Farrington, D. (1995). *Development of offending and antisocial behavior*. Journal of Child Psychology and Psychiatry, 36, 929–963.
- Foshee, V. A. (1996). *Gender differences in adolescent dating abuse prevalence, types and injuries*. Health Education Research, 11, 275-286.
- Forumi i Iniciativës Qytetare, (2007) *Siguria në shkollë-Sfidë për Komunitetin* (2007), Prishtinë.
- Furlong, M., & Morrison, G. (2000). *The school in school violence: Definitions and facts*. Journal of Emotional and Behavioral Disorders, 8, 71–81.
- Farrell, A.D., Meyer, A.L., Kung, E.M., & Sullivan, T.N. (2001). *Development and evaluation of school- based prevention programs*. Journal of Clinical Child Psychology, 30, 207-220.
- Garbarino, J., Kostelny, K., & Dubrow, N. (1991). *What children can tell us about living in danger*. American Psychologist, 46, 376–383.
- Gershoff, E. T. (2002). *Corporal punishment by parents and associated child behaviors and experiences: A meta-analytic and theoretical review*. Psychological Bulletin, 128, 539– 579.
- Gërxhaliu, Selvetë., Hookes, Begicevic, Sikka, (2006) *Reagimi ndaj rasteve të dhunës në familje*, Unicef , Prishtinë.

- Haëkins, J.D., Herrenkohl, T.I., Farrington, D.P., Brewer, D., Catalano, R.F., Harachi, T.W., and Cothorn, L. (2000). *Predictors of Youth Violence*. Washington, US: Office of Juvenile Justice and Delinquency Prevention.
- Hadfield, J. A. (1974) *Childhood and Adolescence*, Penguin Books-Harmondsworth, Middlesex.
- Hall GS., (1904), *Adolescence, Its psychology and its relation to psychology, anthropology, sociology, sex, crime, religion and education*, Appleton, New York.
- Hall, G.S. (1904) *Psychology, An Introduction*, Belmont, Wordsworthy.
- Haskovic, Mujo, (2006) *Psikologji*, AAB Press, Sarajevë / Prishtinë.
- Hoxha, dr. Mit'hat & Dushku, dr. Qazim & Lleshi Xhevahir, (2010) *Psikologjia*, Uegen, Tiranë.
- İçli, T. G. dhe Çoban, S. (2012). *A Study on the Effects of Family and Delinquent Peers on Juvenile Delinquency in Turkey. Advances in Applied Sociology* 2(1), 66-72.
- Instituti Albanologjik i Prishtinës, *Fjalor i psikologjisë*, Prishtinë, 1987, fq.65.
- Juniku, dr. Neki, (1997), *Modifikimi i Sjelljes në Shkollë*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Kosovës, Prishtinë.
- Juniku, dr. Neki, (2012) *Nocione themelore psikologjike*, Alpha, Prishtinë.
- Juniku, dr. Neki, (2015) *Kaptina nga Psikologjia*, Artini, Prishtinë.
- Karaj, Stela, (2014) *Konstruksionet sociologjike të sjelljes devijante të nxënësve në klasë dhe ndikimi i saj në stresin professional të mësuesve*, Universiteti i Tiranës, Tiranë.
- Karatzias, Athanasios, Power, Kevin G., & Swanson, Vivien (2002). *Bullying and victimisation in Scottish secondary schools: Same or separate entities?. Aggressive Behavior*, 28(1), 45-61.
- KAZA, N, (2006) *Adoloshenca stina e shpërthimeve*, Tiranë.
- Kokollari, Tomor. H (2012) *Psikologji praktike rreth marrdhënieve ndërmjet njerëzve*, OMSCA-1, Tiranë.
- Krasniqi, I & Zuna. A. (2012). *Një shkollë pa dhunë.* "Libri Shkollorë", Prishtinë.

- Krug, E.; Dahlberg, L.L.; Mercy, J.A.; Zwi, A.B.; Lozano, R., eds. (2002). *World Report on Violence and Health*. Geneva: World Health Organization.
- LUEDTKE, J., (2008), Gewalt und männliches Dominanzverhalten bei Schülern, in BAUR, N., LUEDTKE, J., Eds., *Die soziale Konstruktion von Männlichkeit. Hegemoniale und marginalisierte Männlichkeiten in Deutschland*. Leverkusen: Verlag Barbara Budrich, 167-182.
- Lala, Sadik, (2010) *Fjalor i Psikologjisë*, Albas,Tiranë.
- Lambert, S. F., & Cashwell, C. S. (2003). *Preteens talking to parents: perceived communication and school-based aggression*. *The Family Journal: Counseling and Therapy for Couples and Families*, 11, 1-7.
- Liu, Y. (2003). *Parent-child interaction and children's depression: the relationship between parent-child interaction and children's depressive symptoms in Taiwan*. *Journal of Adolescence*, 26, 447-457.
- Maguin, E., Hawkins, J.D., Catalano, R.F., Hill, K., Abbott, R., and Herrenkohl, T. (1995). *Risk factors measured at three ages for violence at age 17-18*. Paper presented at the American Society of Criminology, Boston.
- MANSEL, J., (2001), *Familiale Erziehung und Geälterfahrungen. Hintergründe und Folgen der Viktimisierung*, in *Zeitschrift für Familienforschung*, 13(3), 27-51.
- Macavinta, C & Andrea,V., P. (2005) *Respekti për vajzat adoloshente*, Max,Tiranë.
- MASHT, (2014) *Doracak për parandalimin e dukurive negative në shkolla të mesme të larta*, Prishtinë.
- MASHT, (2013) *Statistikat e Arsimit në Kosovë 2012/2013*
- Mikush, Anica, (2007) *Frika në shkollë-Frika nga Shkolla*, Ferizaj.
- Mikush, Anica, (2008) *Trajnimi i mësuesve në vendet me konflikte të armatosura*, Qendra për Përparimin e Edukimit dhe Arsimit (QPEA), Ferizaj.

- Miller, Bonnie, (2005) *Komunikimi me fëmijët*, Opea, Ferizaj.
- Miron G. Amy & Miron D. Charles, (2002) *Si të flasim me adoleshentët për dashuri dhe seksin*, Max, Tiranë.
- Montesori, Maria, (2009) *Zbulimi i fëmijës*, Plejad, Tiranë.
- Morris, CH.G., Albert A. Maisto, (2008) *Psikologjia –Shkenca e proceseve mendore dhe e sjelljes njerëzore*, Qendra për Arsim Demokratik, Tiranë.
- Musitu, G. & García, F. (2004). *Consecuencias de la socialización familiar en la cultura española*. Psicothema, 16, 288-293.
- Musitu, G. & Cava, M. J. (2001). *La familia y la educación*. Barcelona: Octaedro.
- Musitu, G. & García, F. (2004). *Consecuencias de la socialización familiar en la cultura española*. Psicothema, 16, 288-293.
- Mustafa, Armen, (2015) *Mos më mbyll derën jam vetëm një fëmijë*, Tiranë.
- Myers, David.,G (2003) *Socialpsikologjia*, Eugen, Tiranë.
- Nansel, T. R., Overpeck, M., Pilla, R. S., Ruan, W. J., Simons-Morton, B., & Scheidt, P. (2001). *Bullying behaviors among US youth: Prevalence and association with psychosocial adjustment*. JAMA: Journal of the American Medical Association, 285, 2094–2100.
[http://dx.doi.org/ 10.1001/jama.285.16.2094](http://dx.doi.org/10.1001/jama.285.16.2094)
- Nushi. P, *Fjalori i psikologjisë*, Prishtinë, 1987.
- Nushi, Pajazit (2004) *Intelegjenca dhe masa e zhvillimit të saj ndër Shqiptarët e moshës madhore*, Akademia e Shkencave, Prishtinë.
- Nye, F. I. (1958). *Family relationships and delinquent behavior*. Neë York: Wiley.
- Osmani, Shefik (1983) *Fjalor i Psikologjisë*, Tiranë, 1983.
- Orhani, dr. Zenel, (2011) *Psikologjia e Emocionave*, Vllamasi, Tiranë.
- O’Moore, Mona, & Kirkham, Colin (2001). *Self-esteem and its relationship to bullying behavior*. Aggressive Behavior, 27(4), 269-283.

- Osher, D., Bear, G., Sprague, J., & Doyle, W. (January-February, 2010). *How we can improve school discipline*. Educational Researcher, 39 (1), 48-58.
- Osher, D. & Kendziora, K. (2010). *Building Conditions for Learning and Healthy Adolescent Development: Strategic Approaches* in B. Doll, W. Pfohl, & J. Yoon (Eds.)
Handbook of Youth Prevention Science. New York: Routledge.
- Olweus, D. (1980). *Familial and temperamental determinants of aggressive behavior in adolescent boys; A causal analysis*. Developmental Psychology, 16, 644–660.
- Orpinas, P., Murray, N., & Kelder, S. (1999). *Parental influences on students' aggressive behavior*.
Pellegrini, A., & Long, J. D. (2002). *A longitudinal study of bullying, dominance, and victimization during the transition from primary school through secondary school*.
British Journal of Developmental Psychology, 20, 259-280. doi:
10.1348/026151002166442 *European Journal of Psychological Research* Vol. 3 No. 1,
2016 ISSN 2057-4794 Progressive Academic Publishing, UK Page 52
www.idpublications.org behaviors and weapon carrying. Health Education & Behavior,
26, 774-787.
- Palo, R. & Drobot, L. (2010) *The impact of family influence on the career choice of adolescent*,
Procedia Social and Behavioral Sciences 2-3407-
- Palaghia, Carmen (2013) *Social Cohesion's Disturbing Factors Violence and Terrorism in school*.
Revista de Economie Social, Vol.III, Nr.3,44-56
- Patterson, G. R., DeBaryshe, B., & Ramsey, E. (1989). *A developmental perspective on anti-social behavior*. American Psychologist, 44, 329–335
- Patterson, G., Reid, J., & Dishion, T. (1992). *Antisocial boys*. Eugene, OR: Castalia.
- Potera, I., Mehmeti, S., Gojani, H., Shala, L., (2012). *Dhuna verbale ndaj nxënësve*
“Instituti Pedagogjik i Kosovës”: Prishtinë.
- Qendra Kosovare për Studime Gjinore, (2012) *Prania e dhunës në marrdhëniet e adoleshentëve*.

- Raport i Zhvillimit Njerëzor, (2006) *Një gjeneratë e re për një Kosovë të re*, Rezniqi, Prishtinë.
- Rohner, R. P., & Veneziano, R. A. (2001). *The importance of father love: history and contemporary evidence*. *Review of General Psychology*, 5, 382-405.
- Salihu, Labinot, *Dokument Veprimi për dhunën dhe sigurinë në shkollat publike të Komunës së Prishtinës 2015-2018*, Usaid.
- Salihu, Linda, Dr. Naser Zabeli, Dr. Demë Hoti, (2006) *Të drejtat e fëmijës dhe etika e mësimdhënësit*, Kec, Prishtinë.
- Smith, P.K. (2003) *Violence in Schools: The Respons in Europe*, published by Routledge Palmer, New York.
- Strauss, M. A. Gellies, R. T., & Sentiments, S. K. (1980). *Behind Closed Doors. Violence in the American Family* Garden City. New York: New York Inc.
- Syla, Vlora, (2014) *Bashkëpunimi shkollë familje nëparandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë-Universiteti i Tiranës*, Tiranë.
- Schneider, H. J. (1987) *Kriminologie*. Berlin, New York: Walter De Gruyter.
- Shaffer, D., Kipp, K., Wood, E., Willoughby, T., (2010) *Developmental Psychology childhood and Adolescence*, Nelson, Canada.
- Shehu, E & Gramo, Anxhela (2005) *Dhuna me bazë gjinore*.
- Shkurti, Jeta .T , *Psikologjia shkollë e zbatuar*, Dituria.
- Tamo, Adem, (2007) *Këshillimi dhe Psikoterapia*, Pegi, Tiranë.
- Tamo, A & Karaj, TH. (2005). *Dhuna kundër fëmijëve në Shqipëri*. Tiranë: Qendra e zhvillimeve humane.
- UNICEF, (2012) *Braktisja e fshehtë në klasat e arsimit bazë: Përvoja të suksesshme nga Kukësi, Korça dhe Gjirokastra*, Tiranë.
- Vasta, R., Haith., M.M., Miller, S.A. (2007) *Psikologjia e fëmijës-Shkenca moderne*, Uegen, Tiranë.
- Vrojtimit Kombëtar me Bazë Popullatën (2013), Shqipëri.

- West, D. J., & Farrington, D. P. (1977). *The delinquent way of life*. Neë York: Crane, Russak & Co.
- Wissink, I.B., Dekovic, M., and Meijer, A.M. (2006). Parenting *Behaviour, Quality of the Parent-Adolescent Relationship, and Adolescent Functioning in Four Ethnic Groups*. The Journal of Early Adolescence, 26, 133-159.
- World Report on Violence and Health, Etienne G.Krug, Linda L.Dahlberg, James A.Mercy, Anthony B.Zëi and Rafael Lozano, World Health Organization, Geneva, 2002, f.29.
- Woolfolk, Anita, (2011) *Psikologji edukimi*, Qendra për Arsim Demokratik, Tiranë.
- Zabeli, Naser, (2008) *Strategjitë Psiko-Pedagogjike për reduktimin e sjelljes së papërshtatshme në klasë*, Libri shkollor, Prishtinë.
- Zaplluzha, Sh, (2016) *Viktimizimi i adoloshentëve dhe shkaqet e pasigurisë tek nxënësit e shkollave të mesme në Prizren sipas raportimeve të nxënësve dhe mësimeve të UET*, Tiranë.
- Zuna, A. (2008). *Dhuna në familje nën thjerrën pedagogjike*. Prishtinë: “Libri shkollor”. Prishtinë.
- Zuna-Deva, A & bashkëautorët (2009). *Partneriteti shkollë-familje-komunitet, sfida vijanoze*. “Libri shkollorë” Prishtinë

SHTOJCA

Pyetësor për nxënës

Të dashur nxënës,

Pyetësori i mëposhtëm shërben për të evidentuar mendimet tuaja lidhur me identifikimin e faktorëve, pse nxënësit shfaqin sjellje të dhunshme në shkollë.

Ju jeni zgjedhur si një person i përshtatshëm për plotësimin e këtij pyetësori.

Ju lutem plotësoni pyetësorin në mënyrë sa më të sigurtë. Informacioni që ju do të jepni do të mbetet plotësisht anonim. Ky pyetësor do të shfrytëzohet për mbrojtjen e temës së doktoraturës në Tiranë.

1) Gjinia: (rretho) M F

2) Mosha (rretho): a) 13 vjeç, b) 14 vjeç c) 15 vjeç

3) Familja juaj jeton (rretho) : a) Fshat b) Qytet

4) Banoni në : (rretho)

a) Qendër të qytetit b) Periferi

5) Numri i anëtarëve në familje: a) 3 anëtarë, b) 4-6 anëtarë, c) Më shumë se 6 anëtarë

6) Prindërit jetojnë: (rretho) a) Së bashku b) Të ndarë

7) A janë të punësuar prindërit:

Babai PO JO

Nëna Po JO

8) Të ardhurat në familjen tuaj në muaj:

a) Të shkëlqyeshme, b) Të mira, c) Të mjaftueshme, d) Të vështira

9) Shkollimi i prindërve: (kualifikimi – rretho)

Babai: a) Shkollë Filllore, b) Mesme c) ShLP, d) Fakultet, e) Magjistraturë f) Doktoraturë

Nëna: a) Shkollë Filllore, b) Mesme c) ShLP, d) Fakultet, e) Magjistraturë f) Doktoraturë

10) Sa nxënës jeni në klasë? (rretho):

a) Deri 25 nxënës b) Prej 25-30 nxënës c) Mbi 30 nxënës

11) Sa kohë kaloni në ditë në: Internet?

a) Më pak se një orë b) 2-3 orë në ditë c) Më shumë se 3 në ditë d) Nuk e di

12) Sa kohë kaloni duke shikuar TV?

a) Më pak se një orë b) 2-3 orë në ditë c) Më shumë se 3 në ditë d) Nuk e di

13) Sa kohë kaloni me shokë dhe shoqe jashtë mësimi?

a) Më pak se një orë b) 2-3 orë në ditë c) Më shumë se 3 në ditë d) Nuk e di

14) Sa kohë kaloni me familjen në ditë?

a) Më pak se një orë b) 2-3 orë në ditë c) Më shumë se 3 në ditë d) Nuk e di

14) Sa nxënës të shkëlqyer ka klasa juaj? _____

15) Sa nxënës të dobët ka klasa juaj? _____

Sa jeni dakord me pohimet e mëposhtme	Pajtohem plotësisht	Pajtohem	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem	Nuk pajtohem fare
1. Në shkollë shkoj me dëshirën më të madhe					
2. Shpesh ndihem i kërcënuar në shkollë nga nxënësit e tjerë					
3. Shpesh nxënësit më kanë shtyrë, dhënë shuplaka, pickuar ose edhe shqelmuar					
4. Shpesh në shkollë nxënësit më kanë marrë sendet e mia					
5. Shpesh nxënësit në shkollë m'i kanë grisur librat dhe fletoret					
6. Shpesh nxënësit më kanë dhënë komplimente seksuale					
7. Shpesh shokët janë më të dhunshëm fizikisht se shoqet					
8. Shoqet shpesh më ngacmojnë me fjalë fyese					
9. Mësimdhënësit shpesh sillen padrejtësisht me mua					
10. Shpesh mësimdhënësit më thonë fjalë fyese					
11. Shpesh mësimdhënësit me tërheqin veshin ose më rrahin					
12. Në shkollë nuk di kujt t'i drejtohem për padrejtësitë					

13. Drejtori ushtron dhunë mbi nxënësit					
14. Rojet(sigurimi) ushtrojnë dhunë mbi nxënësit					
15. Nga e kaluara kujtoj se edhe mësuesja më ka goditur ose dënuar					
16. Shpesh bëhem nervoz dhe humb gjakftohësinë					
17. Përballem shpesh me shokët për shkak të paqartësive					
18. Shpeshherë jam ndier keq për gjendjen ekonomike të familjes					
19 . Nëse në shkollë më akuzojnë për diçka,nga prindërit kam përkrahje					
20. Nëse në shkollë më akuzojnë për diçka,nuk guxoj t'i tregoj familjes					
21. Nëse në shkollë më akuzojnë për diçka, e fsheh nga ata sepse mund të më dënojnë					
22. Ndiem më lirë të shpreh brengat e mia me shokët dhe shoqet se me familjarët e mi					
23. Familja më ndërhyr maksimalisht në punët e mia					
24 . Më duhet t'ju jap llogari çdo ditë familjes					
25 Shpesh ndihem i pakënaqur me familjen					
26. Familja konsultohet çdo javë me mësimdhënësit e mi					
27. Familja më dënon nëse sillem keq në shkollë					
28. Familja më mbikëqyrin në çdo kohë					
29. Shpesh zihem me prindërit sepse nuk mi plotësojnë nevojat e mia					
30. Babait ia kam frikën më shumë					
31. Nënës ia kam frikën më shumë					
32. Motra shpesh më ofendon dhe më thërret me nofka					
33. Vëllai më lehtë më qëllon sesa motra					
34. Zakonisht vëllezërit godasin motrat e tyre					
35. Zakonisht motrat i fyejnë vëllezërit					
36. Prindërit më kritikojnë se po qëndroj në internet shumë					
37. Prindërit më kritikojnë se po shikoj filma shumë					
38. Prindërit e mi më ndërhyjnë edhe në shoqëri se me cilin- cilën të shoqërohem					

Sa mendoni se shprehjet e mëposhtme janë shkaktarë për shfaqjen e dhunës në shkollë.

Shprehni mendimin tuaj me X në shkallën e mëposhtme:

Sa jeni dakord me pohimet e më poshtme	Aspak nuk ndikon	Pak ndikon	Ndonjëherë ndikon	Ndikon mesatarisht	Shumë ndikon	Gjithmonë ndikon
1. Familja e çorganizuar						
2. Mbikëqyrja e dobët e familjes						
3. Liria e tepërt e prindërve						
4. Mënyra e edukimit të fëmijës						
5. Paaftësia për t'i përmbushur detyrat prindërore						
6. Marrëdhëniet e dobëta prindër-fëmijë						
7. Prindërit abuzivë						
8. Gjendja ekonomike e dobët e familjes						
9. Fëmijët e abuzuar ,abuzojnë të tjerët						
10. Mësimdhënësit e pasjellshëm						
11. Drejtorët e rreptë						
12. Kur shkolla nuk ka rregulla të caktuara						
13. Shokët dhe shoqet me sjellje të dhunshme						
14. Mësimdhënësit e dhunshëm						
15. Jo kontroll i mirë ndaj tyre në shkollë						
16. Interneti shans për sjellje të dhunshme						
17. Lojërat e dhunshme kompjuterike						
18. Numri i madh i nxënësve në klasa						
19 .Lagjja ku jeton						
20. Menaxhimi i dobët i shkollës						

Pyetësor për prindër

Të nderuar prindër,

Pyetësi i mëposhtëm shërben për të evidentuar mendimet tuaja lidhur me identifikimin e faktorëve, pse nxënësit shfaqin sjellje të dhunshme në shkollë.

Ju jeni zgjedhur si një person i përshtatshëm për plotësimin e këtij pyetësi.

Ju lutem plotësoni pyetësin në mënyrë sa më të sinqertë. Informacioni që ju do të jepni do të mbetet plotësisht anonim. Ky pyetësor do të shfrytëzohet për mbrojtjen e temës së doktoraturës në Tiranë.

1) Gjinia: (rretho) M F

2) Moshë: _____

3) Familja juaj jeton (rretho) : a) Fshat b) Qytet

4) Banoni në : (rretho) a) Qendër të qytetit b) Periferi

5) Numri i anëtarëve në familje: a) 3 anëtarë, b) 4-6 anëtarë, c) Më shumë se 6 anëtarë

6) Jetoni me bashkëshortin-ten: (rretho) a) Së bashku b) Të ndarë

7) A jeni të punësuar? Po Jo

8) A është i punësuar bashkëshorti-ja? Po Jo

9) Të ardhurat në familje në muaj:

a) Të shkëlqyeshme, b) Të mira, c) Të mjaftueshme, d) Të vështira

10) Shkollimi i juaj: (kualifikimi – rretho)

a) Shkollë Filllore, b) Mesme c) ShLP, d) Fakultet, e) Magjistraturë f) Doktoraturë

11) Shkollimi i bashkëshortit-tes tuaj: a) Shkollë Filllore, b) Mesme c) ShLP, d) Fakultet, e) Magjistraturë f) Doktoraturë

10) Sa kohë në ditë kalon fëmija juaj në internet?

a) Më pak se një orë b) 2-3 orë në ditë c) Më shumë se 3 në ditë d) Nuk e di

11) Sa kohë në ditë kalon fëmija juaj duke shikuar TV?

a) Më pak se një orë b) 2-3 orë në ditë c) Më shumë se 3 në ditë d) Nuk e di

12) Sa kohë fëmija juaj kalon me shokë dhe shoqe jashtë mësimi?

a) Më pak se një orë b) 2-3 orë në ditë c) Më shumë se 3 në ditë d) Nuk e di

14) Sa kohë fëmija juaj kalon me familjen në ditë?

a) Më pak se një orë b) 2-3 orë në ditë c) Më shumë se 3 në ditë d) Nuk e di

Sa jeni dakord me pohimet e mëposhtme	Pajtohem plotësisht	Pajtohem	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem	Nuk pajtohem fare
1. Në familjen time mbretëron atmosferë e këndshme					
2. Në familjen time vendosim së bashku me bashkëshortin-en time					
3. Fjalën kryesore në familje e kam unë					
4. Fëmijët e mi më lehtë brengat e tyre i shprehin me nënën					
5. Fëmijët e mi më lehtë brengat e tyre i shprehin me babain					
6. Prindërit kanë të drejtë të qëllojnë fëmijën e tyre					
7. Ai që e qëllon fëmijën, i do të					

mirën atij/asaj					
8. Fëmija po nuk u frikësua, nuk edukohet dot					
9. Nëse nuk e godet fëmijën, ai do të dal duarsh					
10 . Nëse fëmijës i flet dhe nuk të bindet,atëherë duhet goditur					
11. Një fëmijë i mirë,i bindet gjithmonë prindit të tij					
12. Fëmija mund të qëllohet por vetëm më ndonjë shuplakë të lehtë					
13. Fëmijët nuk kuptojnë me fjalë, prandaj duhet qëlluar					
14. Ndëshkimi fizik (të qëlluarit, rrahja) është mënyrë e mirë disiplinimi					
15. Druri të bën njeri					
16. Nënës i lejohet më shumë se babait të godas fëmijën					
17. Djalin mund ta qëllosh po nuk t'u bind					
18. Vajzën nuk duhet goditur sepse është e brishtë dhe mund të lëndohet					
19. Në ditët e sotme ka më shumë grindje ndërmjet motrave dhe					

vëllezërve					
20. Unë si prind e qortoj fëmijën nëse ka qenë i dhunshëm me fëmijët e tjerë					
21. Fëmija ballafaqohet dhe i kalon vështirësitë vetë pa u konsultuar me ne si prindër					
22. Fëmijën e mbikëqyri në çdo kohë					
23 .Shpesh zihem me fëmijën sepse nuk e dëgjon fjalën time					
24. Unë e kritikoj fëmijën tim nëse qëndron në internet shumë					
25. Unë e kritikoj fëmijën tim nëse shikon filma shumë					
26. Unë ia përcaktoj fëmijës se me kënd të shoqërohet					

Sa mendoni se shprehjet e mëposhtme janë shkaktarë për shfaqjen e dhunës në shkollë.

Shprehni mendimin tuaj me X në shkallën e mëposhtme:

Sa jeni dakord me pohimet e mëposhtme	Aspak nuk ndikon	Pak ndikon	Ndonjëherë ndikon	Ndikon mesatarisht	Shumë ndikon	Gjithmonë ndikon
1. Familja e çorganizuar						
2. Mbikëqyrja e dobët e familjes						
3. Liria e tepërt e prindërve						
4. Mënyra e edukimit të fëmijës						
5. Paaftësia për t'i përmbushur detyrat prindërore						

6. Marrëdhëniet e dobëta prindër-fëmijë						
7. Prindërit abuzivë						
8. Gjendja ekonomike e dobët e familjes						
9. Fëmijët e abuzuar ,abuzojnë të tjerët						
10. Mësimdhënësit e pasjellshëm						
11. Drejtorët e rreptë						
12. Kur shkolla nuk ka rregulla të caktuara						
13. Shokët dhe shoqet me sjellje të dhunshme						
14. Mësimdhënësit e dhunshëm						
15. Jo kontroll i mirë ndaj tyre në shkollë						
16. Interneti shans për sjellje të dhunshme						
17. Lojërat e dhunshme kompjuterike						
18. Numri i madh i nxënësve në klasa						
19. .Lagjja ku jeton						
20. Menaxhimi i dobët i shkollës						

Pyetësor për mësime dhënësit

Të nderuar mësime dhënësit,

Pyetësori i mëposhtëm shërben për të evidentuar mendimet tuaja lidhur me identifikimin e faktorëve pse nxënësit shfaqin sjellje të dhunshme në shkollë. Ju jeni zgjedhur si një person i përshtatshëm për plotësimin e këtij pyetësori.

Ju lutem plotësoni pyetësorin në mënyrë sa më të sinqertë. Informacioni që ju do të jepni do të ngelet plotësisht anonim. Ky pyetësor do të shfrytëzohet për mbrojtjen e temës së doktoraturës në Tiranë

1) Gjinia: (rretho) M F
2) Mosha: _____
3) Vendi: (rretho) a). Fshat b). Qytet
4) Shkollimi: (kualifikimi juaj – rretho) a). ShLP b). Fakultet c). Specializim profesional d). Magjistraturë e). Doktoraturë
5) Sa nxënës ka shkollë juaj? _____

Sa jeni dakord me pohimet e mëposhtme	Pajtohem plotësisht	Pajtohem	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem	Nuk pajtohem fare
1. Në shkollën time mbretëron atmosferë e këndshme pune-					

mësimi					
2. Raportet në mes të mësimdhënësve dhe nxënësve janë të shkëlqyera					
3. Në ditët e sotme , nxënësit nuk i respektojnë mësimdhënësit e tyre					
4. Nxënësit nuk frikësohen nga askush në shkollë					
5. Mungesa e pedagogut dhe psikologut në shkollë ka ndikuar në rritjen e sjelljeve të dhunshme tek nxënësit					
6. Në shkollën tonë mbretëron tolerancë e tepruar ndaj nxënësve					
7. Fëmijët e dhunshëm vinë të tillë nga familja					
8. Sjellje të dhunshme zakonisht shfaqin ata nxënës që e kanë të dhunshme edhe familjen					
9. Stili prindëror i edukimit ka rëndësi që këta fëmijë shfaqin sjellje të dhunshme					
10. Fëmijët duhet të frikësohen nga ndëshkimi fizik sepse zvogëlohen sjelljet e dhunshme në shkollë					
11. Në të shumtën e rasteve ndëshkimi fizik , në qoftë se bëhet në mënyrë korrekte, ka efekte					

pozitive në edukimin e nxënësve					
12. Njoh mësimdhënës që ushtrojnë dhunë ndaj nxënësve në shkollë					
13. Shumica e problemeve me nxënësit mund të zgjidhen duke biseduar					
14. Nxënësit duhet të ndëshkohen nëse sillen dhunshëm me të tjerët					
15. Nxënësi duhet të ndëshkohet nëse i ngacmon të tjerët					
16. Nxënësit duhet të ndëshkohen nëse i kanë thyer rregullat e shkollës					
17. Nxënësi duhet të ndëshkohet nëse ikën nga ora mësimore					
18. Nxënësi duhet të ndëshkohet nëse nuk e dëgjon mësimdhënësin					
19. Nxënësi duhet të ndëshkohet nëse nuk e dëgjon drejtorin					
20. Nxënësi duhet të ndëshkohet nëse nuk e dëgjon kujdestarin e ditës					

Sa mendoni se shprehjet e mëposhtme janë shkaktarë për shfaqjen e dhunës në shkollë?

Shprehni mendimin tuaj me X në shkallën e mëposhtme:

Sa jeni dakord me pohimet e mëposhtme	Aspak nuk ndikon	Pak ndikon	Ndonjëherë ndikon	Ndikon mesatarisht	Shumë ndikon	Gjithmonë ndikon
1. Familja e çorganizuar						
2. Mbikëqyrja e dobët e familjes						
3. Liria e tepërt e fëmijëve nga prindërit						
4. Mënyra e edukimit të fëmijës						
5. Paaftësia për t'i përmbushur detyrat prindërore						
6. Marrëdhëniet e dobëta prindër-fëmijë						
7. Prindërit abuzivë						
8. Gjendja ekonomike e dobët e familjes						
9. Fëmijët e abuzuar, abuzojnë të tjerët						
10. Mësimdhënësit e pasjellshëm						
11. Drejtorët e rreptë						
12. Mos respektimi i rregullave të caktuara në shkollë						
13. Shokët dhe shoqet me sjellje të dhunshme						
14. Mësimdhënësit e dhunshëm						
15. Jo kontroll i mirë i nxënësve ndaj sjelljes në shkollë						
16. Interneti shans për sjellje të dhunshme						
17. Lojërat e dhunshme kompjuterike						
18. Numri i madh i nxënësve në klasa						
19. Lagjja ku jeton						
20. Menaxhimi i dobët i shkollës						

Pyetësi për nxënësit

Tabela 1- *Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas vendbanimit– Pyetësi për nxënësit*, paraqet vlerat e mesatares aritmetike dhe të devijimit standard për faktorët që ndikojnë në sjelljet e dhunshme tek nxënësit sipas vendbanimit. Siç shihet nga tabela, shumica e faktorëve kanë treguar vlera të përafërta të mesatares aritmetike si për nxënësit nga fshati ashtu edhe ato nga qyteti. Nëse i referohemi faktorëve, ata kanë treguar vlera të përafërta ndërmjet tyre.

Tabela 1

Mesatarja dhe devijimi standard për faktorët ndikues sipas vendbanimit– Pyetësi për nxënësit

Faktorët	Fshat		Qytet	
	MA	DS	MA	DS
